


854-32

M 27



TREGIM  
PER TY

Eglantina Mandia

891.983-32

M 27

S

EGLANTINA MANDIA

$$\begin{array}{r}
 75 \\
 56 \\
 \hline
 19
 \end{array}
 \qquad
 \begin{array}{r}
 27 \\
 29 \\
 \hline
 56
 \end{array}$$

# TREGIM PER TY

(T r e g i m e)

~~50963~~  
2030

BIBLIOTEKA E SHTETIT  
GJIRORI ASRTP

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## CILA ËSHTË KOMUNISTE

Katerina rrëshqiti mbi çimenton e ftohtë e të lagur. U përpoq të mos i zgjonte vajzat. Mezi arriti në vendin e saj.

— Erdhe, Rina? — pyeti Iliriana.

Katerina iu shtri pranë, e lodhur, mori frymë e lehtësuar.

— Nuk po fle?...

— Të prisja ty... Ç'donin që të rrëmbyen nga rrjeshti?...

— Shkumëzojnë nga zemërimi. Sidomos ai vam-piri plak.

Katerina nuk tha asgjë, nuk tregoi si kishte që-ndruar pranë drejtorit të kampit, që e quanin «vampiri plak», nuk tha as sa kohë e kishte pritur atë çast, duke bërë ç'ishte e mundur të ruante zemrën e saj dhe të vajzave të tjera të barakës që të mos dobësoheshin, të mos jepeshin. Çasti kishte ardhur! Ajo e shikonte drejt në sy vampirir plak. Donte t'i kujtonte se edhe pse i kishin rrrethuar me tela me gjemba, edhe pse u kishin vënë në vend të emrit nga një numër, prapë-serapë ata ishin njerëz, njerëz të fortë, gjersa e bënин edhe atë të dridhej.

Katerina e kishte vështruar me ngulm, e heshtur; ajo i dinte të gjitha, ndërsa ai e kërcënonte se do ta vriste po të mos tregonte rrugën nga kishin kaluar të arratisurit. «Ah!» mendonte Katerina «edhe njëmijë jetë sikur të më falin, s'do të nxjerrin asnje fjalë nga unë».

Katerina bënte pjesë në organizatën e fshehtë të kampit; ishte një nga udhëheqëset, ajo e dinte prej kohësh pregatitjen e arratisjes. Duhej që të shpëtonin sa më parë dhe sa më shumë që të ishte e mundur. Disfatat e njëpasnjëshme i tërbonin nazistët. Ata kishin në dorë vetëm të internuarit e kampeve. Mbi ta do të hakmerreshin. Organizata komuniste e kampit mendonte t'i armatoste të gjithë në një farë mënyre. Ata duhej të qëndronin deri në fund për të ruajtur të fshehtën e arratisjes. Duhej të vigjelonin në çdo çast, që të mos i zhduknin tashti, në prakun e fitores. Plani pësoi ndryshime kohët e fundit. Shokët organizuan arratisjen e të dënuarve me vdekje. E dinin që këta ishin grapi i parë i të dënuarve me vdekje, pastaj do të fillonte asgjësimi në masë. Varkat e çetave partizane u afroan pranë portit të vjetër. Shokët kaluan në-për rrugën e nëndheshme. Kanalin e kishin hapur banorët e lashtë.

Le t'i rrethonin sa të donin hekurat ose telat me gjemba e me korent, le t'i ndiqnin me qen ose me uj-qër të llojit më të përsosur që kishin SS-të, prapëse-prapë shokët shpëtuan, ata hipën ndër varkat dhe kaluan në bregun tjeter te të tyret. Kanali ishte ende i pazbuluar. Dhe sa do të tërboheshin nazistët! Sikur edhe gjithë kampin të përmbysnin, nuk do të gjenin goftë edhe një mundësi të kapnin fijen e lëmshit. Si të mos ishte krenare Katerina!

Iliriana e shtyu dyshekun prej kashte pranë Katerinës.

Katerina lëvizi dorën në ajër, si për të shoqëruar mendimin e saj: «S'ka rëndësi asgjë më shumë se kjo fitore». I erdhi keq që do të ndahej nga Iliriana. Donte t'ja thoshte... po nuk i pëlqenin as ndarjet, as lotët. E dinte që nuk do të jetonte më shumë se deri në mëngjez. Do të hapej dera e barakës e nazistët e tërbuar do të pyesnin:

«Cila është komuniste këtu?»

Katerina do të ngrihej në këmbë. Vërtet ajo ishte

e lodhur, shumë e lodhur, po do të buzëqeshte, duke i shtrënguar dorën Ilirianës. Kështu do të ishte më mirë. Përse ta shqetësonë menjëherë? Dhe do të thoshte me ballin lart:

— Unë jam komuniste!

Sa do të dëshéronte që vajzat të mos tronditeshin, sa do të kishte dëshirë të dëgjonte këngën, që asaj i pëlqente shumë. Le të mbushte kënga boshllëkun e barakës së errët, pastaj le të dilte e lirë dhe të bashkohej me murmuritjen e përjetshme të valëve. Dhe valët le t'ja këndonin të shkujdesura brezave që do të vinin...

Katerina e mori me mend si flinin vajzat të përqafuara, sikur donin të mbronin njëra-tjetrën nga kërcënimi. Një vit të tërë ajo ishte ngritur më shpejt se të gjitha. I vërente me radhë, përpiquej të dinte çdo mendim, çdo dëshirë, çdo luhatje të tyre. Ato e pyesnin Katerinën për çdo gjë. I besonin. Ajo mendonte «Ti duhej t'i kishe bërë të gjitha luftëtare, Katerinë! Të gjitha! A thua e ke kryer detyrën tënde? Në qoftë se bien një palë, të ngrihen të tjerët. Ku janë të tjerët e tu, Katerinë? Ku janë? Ti e di, shoqe e dashur, se s'mund të ikësh e qetë duke thënë vetëm: «unë jam komuniste». Të gjithë duhet të luftojnë për komunizmin ashtu si ti, ndryshe nuk mund të vijë fitorja.

«Fitorja! Nganjëherë të duket sikur ajo është në prak, mjafton të zgjatësh dorën. Sa e kam dëshëruar ditën e fitores! Sa e kam pritur! Asnjë re. Dritë kudo. Edhe në natyrë, edhe në ballin e njerëzve.»

Katerina pëershkoi e malluar fytyrën e Ilirianës me dorën e ashpër nga puna e rëndë e kampit. Megjithëse vazhdimisht e zënë, e shqetësuar për jetën e të gjitha vajzave të barakës së saj, ajo kishte vënë re, si me çudi, lulëzimin e nëntëmbëdhjetë pranverave te Iliriana, që bënte kontrast me çdo gjë që i rrëthonte. Ajo e ndjente Ilirianën fare pranë. Nuk mund të besonte se kjo ishte hera e fundit që rrinte me të. E

përfytyroi një çast fytyrën e saj të rrrethuar nga kacurrelat, që i binin mbi ballë. I kërkoi në errësirë flokët dhe i përkëdheli. E kishte marrë malli për sytë e kthjellët të Ilirianës.

Iliriana e pushtoi; mbështeti kokën mbi supin e saj. Lotët si pikat e shiut lagnin Katerinën.

— Ç'ka ndodhur?

— Pandeha se nuk do të të shihja më!

— Dhe për këtë qan?

— Nga gjëzimi. Ti je prapë këtu pranë meje!

Katerina e shtrëngoi Ilirianën të mbytur në lot, në krahët e saj, me një dridhje të lehtë. Ajo bënte të gjitha përpjekjet të mbahej ende e fortë. Ndjente Ilirianën në errësirën e barakës me zemrën e ngrohtë nga dashuria njerëzore, kurse, përjashta, ulërimën e cakajve SS.

A e mban mend ç'thoshte Agroni? I plotfuqishëm është ai që mund vetëveten. Rina, të ka marrë malli për të?

— Natyrisht! Një vëlla të vetëm kam!

— Gjatë gjithë kësaj mbrëmjeje, gjatë kësaj kohe që numëroja çdo sekondë që më dukej e gjatë sa një muaj, unë e qortova veten, që të kam fshehur ndjenjat e mia për Agronin.

— Po unë i kam ditur edhe pse nuk më ke thënë asgjë. A nuk përpiqeshe çdo ditë të **fisnim diçka për Agronin?**

— **Nuk e di pse mendoj se në këtë aksion të madh** është e pamundur të mos marrë pjesë edhe ai. Agroni ka thithur po këtë ajër, ka menduar për ty e, ndoshta, edhe për mua. Dridhem nga gjëzimi.

«A është e mundur në këto çaste të flasësh për këto gjëra?» tha me vete Katerina. Po ajo nuk donte të numëronte sekondat, që fluturonin pareshtur. Të maste kohën deri në mëngjez?!

— E gjithë kjo ndodhi atë ditë — vazhdoi Iliriana. — E mban mend? Atë ditë kur Agroni kishte shkruar një vjershë për partinë. Sa e bukur ishte ajo

ditë! Dielli lëvizte ngadalë duke zbritur prapa ca re-ve, që ngjanin me krahët e një shpendi gjigant të përflakur. Deti i qetë pasqyronte të gjitha ngjyrat e ylberit. Rrija e mbështetur në pezulin e dritares suaj, dëgjoja zërin e Agronit që recitonte vjershën, ndjeja erën e luleve të pjeshkës, ndiqja rrymën e ujit me një shkëlqim floriri, kërkoja me sy peshqit, që kérce-nin mbi sipërfaqe. Ishte e pamundur të besoja se në atë natë do të kryenim një aksion që do të tro-ndiste gjithë qytetin. Çdo gjë ishte e madhërishme e paqësore. Disku i zjarrtë rrëshqiste prapa reve. Hu-mbi në një çast. Të gjitha ngjyrat mbi sipërfaqe u zbehën. Atëhere unë kuptova, duke e përqafuar me një vështrim ftyrën e frysme dashuroja. Po të largohej nga dhoma, të gjitha ngjy-rat, që shkëlqenin në shpirtin tim, do të zbeheshin me-njëherë. Dhe e mora me mend që ai duhej të ishte në udhëheqje të gjithshkaje të rrezikshme dhe mund ta humbisja për gjithmonë! Sikur të mos ishim në ank-thin e pritjes së aksionit, unë do të vrapoja drejt jush dhe do t'i shfaqja vëllait tënd, nëpërmjet lotve, ndje-njat e mia. Le të ishte ai udhëheqësi dhe mësuesi ynë, ndërsa unë ende një nxënëse e vogël fillestare në shkollën e madhe të luftës. Ç'rëndësi kishte kjo? Unë e dashu-roja!..

Ipiriana e shtrëngoi Katerinën. Ajo lëvizi pak, se-pse ju lëndua plaga nga një e therur e fortë në shpa-tullën e djegur.

«Cudi» mendoi Katerina, «Agroni kishte qenë fare pranë. Ai ishte komisar i asaj brigade që tërhoqi shokët e kampit. Çfarë kishte menduar duke iu afruar portit të vjetër dhe telave me gjemba? Besnikérinë e pakufishme të së motrës ndaj idealit të tyre, apo sytë e kthjellët të Ilirianës?» Katerina nuk dintë ç'të thoshte. Do t'i vinte keq apo do gëzohej në qoftë se ai men-donte vetëm për sytë e mëdhenj e të thellë si det... Katerina për vete do të duronte lodhjen, urinë, këtë boshllék, që i krijohej sapo Ipiriana ndërpriste tregi-

min e saj. Vetëm sa ta shihte edhe një herë Agronin para atij mëngjezi. Vetëm një herë.

Vërtet? Po a mendonte Agroni për Ilirianën? A do të kishte mundësi ai të dashuronte një njeri të vetëm, kur ideali i tyre kishte përpire çdo mendim e çdo ndjenjë?

«Ç'janë këto mendime?» thoshte me vete Katerina.

Kur e dëgjonte Ilirianën, i vinte çudi si mund të flitej në ato çaste për dashuri. Dhe për këtë i dukej pak e pakuptueshme, por megjithatë e afërt dhe e dashur. Ajo fliste për Agronin! A mund të mos ishte e afërt?

Katerina mbylli sytë. Përfytyroi si do të kthehej Iliriana në shtëpinë e tyre, në lagjen e kalasë. Hëna e ngrënë do të rrëshqiste gjithnjë mbi rrugicat e mbi rrjetat e peshkatarëve, mbi qiparizet e kishës së vjetër, mbi sipërfaqen e lëmuar të detit me një ndriçim të pruar. Iliriana do të sillte gëzimin, dashurinë, lumtérinë, ajo do ta mbushte shtëpinë e tyre. Atë nuse do ta priste gjithë lagjja e peshkatarëve, si një dhuratë të çmuar pas kësaj lufte të gjatë.

Katerina shtrëngoi dorën e hollë të Ilirianës dhe mendonte: «A do të bëhet luftëtare e vërtetë Iliriana? A mund të qëndrojë ballë për ballë vdekjes pa i pulitur sytë? Apo di vetëm të cicërojë?»

— Sa herë më ke folur ti për të ardhmen! Për atë të ardhme, kur njerëzit do të jenë Njerëz me «Nj» të madhe, siç thua ti. Sa të besoj, Rina! E sotmja jonë ngjan me një ditë të vrejtur me shi. E ardhmja do të jetë si qelli i kthjellët pas një rrebeshi. E ke parë ndonjëherë bregun, malet, qellin sa të kthjellët dhe transparentë janë pas rrebeshevë? E ardhmja do të jetë e bukur. Po unë dua të jem e singertë. Do të më dukej e ftohtë po të më mungonte dashuria e Agronit. A e di që i them atij para se të fle gjithnjë «Natën e mirë, i dashur?»

— Ajo... ditë... e ardhmja!... — tha ngadale Katerina.

Nuk deshte të kujtonte se nuk i përkiste më asaj dite. Kishte bindje që nazistët nuk do të gjenin kanalin. Shokët e lajmëruan: «I zhdukën gjurmët». Ajo s'deshi të kujtonte as njëshkolonën e gjatë, as si do t'i kthenin me duart lart nga telat me gjemba. Këto skena i kishte parë kaq herë.

— Do të vijë ajo ditë... shumë shpejt... Po përpara se të vijë, ne do të luftojmë.

— Çdo ditë luftojmë. Luftojnë jeta me vdekjen. Nuk është mjaft kjo?

— Po, po. Kjo është një luftë e vërtetë, e madhe dhe e vështirë! Ne u kemi treguar atyre, që kanë rënë në grackën e qytetit tonë, se çdo rrugë, çdo mur, çdo shtyllë bile edhe ky port i vjetër është një roje, një kështjellë mbrojtëse kundër tyre.

Na kanë rrethuar nga të gjitha anët? Mirëpo shokët tanë e kapërcyen rrezikun. Ata janë të lirë.

Katerina u mbajt pas dërrasave që përdornin përtë fjetur.

Ato ishin të lagështa, të rrëshqisnin nga duart. Ndjente një dobësi të madhe. Po këtë dobësi nuk deshi ta pranonte as vetë, dhe jo më t'ja pohonte Ilirianës. Ndofta e kishte nga ajo plagë që i hapi ai i mallëkuar me dorezën e revolverit? Apo nga hekuri i skuqur në shpatull? Pandehnin se, duke përdorur të gjitha llojet e torturave të mesjetës, mund ta mposhtnin njeriun. Si nuk e dinin ata «zotërinj të kulturuar të Evropës», që asnjë fuqi nuk mund të mposhtë krenarinë e së vërtetës dhe të së drejtës?

C'kishte ndodhur në atë çast, kur vampiri plak, me sytë e zgurdulluar kërcënonte me dorezën e revolverit të gjithë ata përtë cilët dyshonte se ishin komunistë? Asgjë. Katerina e vështronë drejt në sy, duke shtrënguarnofullat nga dhëmbja sikur të donte t'i thoshte:

«Jeta ime vlejti diçka. Bjerë, egërsirë! C'mund të bësh tjetër ti? Po dije mirë. Kjo histori s'mbaron me kaq! Nuk është e lehtë të shkelësh mbi ndjenjat e shenjta të një populli».

- Pse hesht, Rina? A èndërron ti ndonjëherë?
- Po.
- Çfarë?
- Lirinë.

«Unë e di» — mendonte Katerina. «E di. Dashuria ime èshtë më e madhe. Ajo më bën të shkoj ballëhapur, apo të trokasë dera e barakës. Po unë nuk do t'i them asgjë Iliranës. Ajo do ta shikojë vetë kur të zbardhë pakëz drita. Dashuria e njeriut për të ardhmen, lumtërinë e njerëzimit, èshtë një ndjenjë e pakrahasueshme me asgjë.»

— Nganjëherë mendoj se nuk e meritoj Agronin! Si thua ti, Rina? — tha Iliriana.

- Përse?
- Dua të jem si ti... E fortë... e papërkulur.
- Po ti ashtu je! Të gjithë ne jemi të fortë, Iliranë, të gjithë luftëtarë!

— A e ke parë pranverën? E ke vënë re, kur ka-përcejmë telat e kampit? Atje ku hapim llögore ka lulëzuar një kumbull. Era i shkund petalet e holla dhe i shpërndan pranë dheut të zi e të shkriftë. Unë nuk duroj dot kur shkelin mbi to qizmet e lustruara të këtyre kanibalëve. Ato janë shumë të dobëta e të pa-fuqishme. Kurse këta egërsira duan të na fusin në shpirt mendimin se e tërëjeta èshtë mbuluar nga një guaskë e murme dhe çdo gjë èshtë nën pushtetin e saj të gurtë; edhe lulet edhe njerëzit.

Katerina e mori me mend vështrimin e syve të Iliranës.

— Kot e kanë... — pëshpëriti me zërin që po i shuhej. — Kot fare... Së shpejti do të vinë tanët. Dhe këta do të dridhen. Ku do të futen? A e di kush e udhëheq aksionin? Agroni... ynë...

Zëri i Katerinës humbi fare. Ajo betohej me vete, se do të qëndronte deri në mëngjbez. Jo. Nuk ishte koha për një dobësi të tillë. Ç'ishte kjo marrëzi? Ta linin forcat pikërisht tashti? Ajo do të ngrihej në këmbë. Sikur të kishte aqë forcë sa të ngrihej edhe një

herë në këmbë! Të ecte vetë deri te dera e barakës. I vinte rëndë për dobësinë e saj. Filloi të dridhej. Dridhej pa pushim. Përse kishte aq ftohtë? Sikur të kishin një jorgan!

Rrezet e para të dritës depërtuan nëpër të çarat e barakës; ato hynë si të drojtura në errsirën e zymtë, duke sjellë me vete diçka të hollë, të bardhë, delicate, si vesa e mëngjezit.

Iliriana zgjati dorën drejt Katerinës. Pëshpëriti:

«Shiko, Rina». Deshi t'i tregonte Katerinës rrëzen e dritës. Tjetra nuk u përgjegj. Iliriana u ngrit dhe e shikoi e habitur. Katerina ishte zverdhur. Një curril i hollë gjaku i ishte tharë mbi tëmthat. E kishin mbuluar djersë të ftohta.

Iliriana mbeti një copë herë në gjunjë, duke mos i besuar vetes. Si kishte pasur durim Rina t'i dëgjonte të gjitha të fshehtat e zemrës së Ilirianës duke pasur këtë dhimbje? Ajo ishte shumë e lodhur. E kishin torturuar pa mëshirë. Iliriana, e tronditur, ishte pushtuar nga një mendim i vetëm.

«Ajo është komuniste. Ja çdo të thotë të jesh komuniste».

— Katerinë! Katerinë!

Vajzat e tjera të barakës u zgjuan nga klithma e Ilirianës. Ato e rrëthuan Katerinën. Iliriana nxitoi të griste një copë nga këmisha e saj e pastër dhe i lidhi ballin. Katerina hapi sytë. Ajo i pa me radhë. I erdhi keq që u zgjuan aq shpejt atë mëngjez. Atëhere i lindi mendimi:

«Sa më shumë besim te njerëzit, Katerinë, aqë më shumë luftëtarë».

Iliriana, e ngrirë si një statujë e gurtë, pëshpëriste me vete: «Ajo është komuniste».

Katerina e kapi e para, ndofta instiktivisht përplasjen e këmbëve të ushtarëve SS. Pastaj alarmin. Ajo e dinte se ishin rrjeshtuar ata me vështrimin e etur për gjak. Po kjo do të thoshte që nuk kishin zbuluar asgjë deri në mëngjez.

«Duan tē hakmerren mbi këto vajza tē reja tē pambrojtura? Jo!», tha ajo, si pér t'i mbrojtur.

Ato e shikonin Katerinën drejt nē sy. E dinin pérse kishte ardhur ai mëngjez me tē kërcitura këmbësh e tē lehura qensh. Kjo nuk ishte gjë e re! Arratisja ishte e njohur pér tē gjithë tē internuarit dhe nuk mund tē mos ngjallnin shqetësim tē pérplasurat e dyerve nē barakat. Cila do tē ishte preja e tyre pér atë ditë?...

Katerina u ngrit përgjysmë.

— Mos u shqetësoni. Kërkojnë komunistët. Duan tē na flakin nē fytyrë disfatat e tyre. Po shokët tanë shpëtuan shëndoshë e mirë. Dhe tē tjerë do tē kapërcejnë nē atë rrugë. Dhe tē tjerë. Më dëgjoni?...

Në barakë sundoi pér një çast një heshtje e rëndë. Vajzat rrinin pranë e pranë.

E besonin Katerinën.

Ajo iu lut Ilirianës ta ndihmonte tē ngrihej nē këmbë. Tjetra e ngriti nē mënyrë tē pavetëdijshme. Vajzat e rrethuan Katerinën. Ato donin tē qëndronin pranë saj, si Anteu pranë tokës dhe ta ndjenin veten tē paprekshme.

Dera u pérplas me furi. Në prak u dukën dy hije tē gjata e kërcënonjëse si vdekja. Një zë i vrazhdë kumboi tej e tej barakës së errët dhe jehona e tij u kthye përsëri.

— Cila éshtë komuniste?

Vajzat u shtrënguan pas Katerinës. Nuk donin ta linin tē largohej dhe sa më shumë e mbanin atë pranë, aqë më shumë ndjenin dëshirën pér tē thënë: «Ne tē gjitha jemi komuniste». Katerina lëvizi. Donte tē shkëputej dhe tē dilte nē ballë. Ja, tashti mund tē ecte vetë!

Po ato nuk patën kohë tē merrnin veten nga habia. Përballë dy hijeve tē zeza u duk silueta e ëmbël dhe delikate e Ilirianës.

— Ne tē gjitha jemi komuniste — thirri ajo me

sytë që i shkëlqenin si ndër ethe. Dëgjoni! Ne të gjitha jemi komuniste.

Heshtje dhe urrejtje. Masivi i trupave të shtrënguara, që mbronte Katerinën, si të ishte një njeri, filloi të ecë përpara!

## TREGIM PËR TY

Përse nxítonte Leksi atë ditë? Për të parë kurmin e gruas që s'po i plakej? Apo për sytë e pafajshëm të vajzës që qëndiste në gjergjef? Sa shumë i pëlqente kur e shikonte duke qëndisur ajo! Kérruste kokën, varte pakëz buzët e njoma e përpjhej e tëra nga ngjyrat, lulet, zogjtë. Ngrinte sytë e shikonte ngultas. Një i kuq i lehtë i ngjitej mbi mollëza sa herë pyeste përdicka të re. Qeshte me një tingull të hollë, gazmor, që mbushte gjithë shtëpinë e tyre të vogël.

Pazari gumézhinte. Leksi, me sytë gjysmë të mbyllur nga dielli i fortë, vështronte turmën me rroba shajaku, dëgjonte tellallin me zérin e ngjirur, britmat e çertexhinjve, që shisnin cikérrima.

Eci edhe pak. Qëndroi te dera e Kol Nallbanit. Koli, i djersitur, e vështroi me dyshim.

— Po çuni ku qenka? — pyeti Leksi. Koli ngriti supet.

«Kolit do t'i thyhet kurrizi, vetëm në punë, dhe ec e dëgjoje sonte», mendoi Leksi.

Para se të hyjë në shtëpinë e tij, Koli e ka bërë zakon të qëndrojë patjetër në sofatin prej guri të derës së Leksit. Kështu janë mësuar ata që në fëmijni. Kanë lindur të ndarë nga një mur. Aty janë rritur dhe tashti po plaken. Ata sapo i kanë kaluar të pesëdhjetat. Leksi e dinte që Koli do të rrinte mbi sofat më i lodhur, më i kërrusur e do të pëshpériste:

«Ruaju nga femrat, Leks vëlla. Femra të turpëron. I shkrep në kokë dhe ikën e bijë e botës. Ka dalë moda e maleve, Leks vëlla! Zot na ruaj, se ç'kërkojnë çupërlinat maleve! Një djall e merr vesh këtë punë. Zaten këtu ka gisht ai i mallëkuari. U prish dynaja, Leks vëllai...».

Leksi shkundi supet. Çapiti përpara duke thënë me vete:

«Çupa ime qëndis me gjergjef. Ajo i ka duart flori. Çupën time mezi e sheh rrezja e diellit. Asaj, edhe sikur t'i hapësh derën e ta shtysh përpara, do të pulisë sytë e bukur dhe do të rrijë prapë aty. Lëre Kolin. Ai më mirë të shohë Tomin e tij. Nuk është në rregull çuni: i ka marrë koka erë. Më parë bridhte natën, tashti paska filluar edhe ditën».

Leksi e kishte dashur çunin e madh të Kolit, Tomin, sepse ai kishte lindur në një ditë me çupën e tij.

Duke shtyrë sehirxhinctë, Leksi hyri në dyqanin e Rakos. Shikoi me bisht të syrit si kapardisej i zoti i mallit, cirakët e panumërt, që lëvrinin për tu shërbyer njerëzve, prej të cilëve më të shumtët dilnin pa blerë gjë. Doli andej duke mbajtur në dorë një copë të kaltër e të shkëlqyer. Papritur Leksin e mbërtheu trishtimi. Copa i kujtonte që e bija do të ikte një ditë nga shtëpia. Ai e shtrëngoi aq fort copën e hollë, të kaltër, sa ajo thuajse humbi në duart e tij të fuqishme.

«Punë e madhe në e bleva këtë. Kjo nuk do të thotë asgjë. Çupa nuk martohet vetë. Nuk është zakoni».

Para ca ditësh, ajo kishte dalë në prakun e derës me leshra të prera, pothuaj si djalë. Leksit as i shkoi ndër mend ta qortonte. As i kujtoi fjalët e Kolit: «Se ç'ngatërojnë ata të dy, Tomi dhe Dita. Shiko mos përzihet çupa me ato leshprerat. Pa Tomi fundi, djalë është». Ja, kjo ishte e çuditshme. Leksit po i fshikëllonin fjalët e Kolit tani. Nuk ishte Dita e tij nga ato që u shkrep në kokë të ikin maleve. Ajo vërtet i

lexonte Leksit ca fletushka, që sekush i hidhte nëpër dyer ose shkonte me Tomin gjer në fshat te një miku i tyre, po kjo nuk donte të thoshte asgjë. Tomi ishte vëllai i saj. Ata ishin rritur bashkë. Jo, Leksi nuk mund të dyshonte kurrë që edhe çupa e tij të përzuhej në të tilla punë të ngatërruara. Nuk ishin për të ato! Dita ishte krahu i tij. Gjilpëra ishte vërtet e holle, po ajo i mbante më shumë gjallë, se puna e tij me hekurin.

Padashur ai shpejtoi hapin duke shtrënguar fort në duar copën e kaltër. Nxítonte të arrinte sa më parë në shtëpi. Nuk e dinte as vetë Leksi përsë pati dëshirë që çupa e tij të ishte përsëri e vogël, të ngjitej mbi sofatin e oborrit, t'i hidhej në qafë dhe ta pyeste si dikur: «Kur do të dalë ylberi që ta kapércej e të bëhem shok me Tomin?»

Leksi shkonte me nxitim në rrugicën me kalldrëm. Ai i njihet mirë gurët, bojërat dhe madhësitë e tyre. Mezi priste të kapércente prakun e të shikonë Ditën me buzë në gaz. Çupa do të merrte legenin dhe ibrikun nga dhoma përdhese; Leksi do të ulej në minderin e hajatit dhe ajo do t'i shtinte të lante duart. Lumtëria më e madhe e Leksit ishte të shtrihej në qoshen e sobës, të vështronë veshët e pjergullës që vareshin dhe me sy gjysmë të mbyllur të ndiqte lëvizjet e çupës, që vërtitej nëpër shtëpi. Leksit i bëhej sikur ishte pikërisht ajo, çupëza e tij, që mbushte shtëpinë me një erë dehëse, me erën e jargavanëve në maj.

Nuk kish kapërcyer akoma prakun e shtëpisë, kur u drodh nga gjëmimet. Të dukej sikur kishte krisur pushka aty në lagjen e tyre të varfër e të pluhurosur. Ai pa se si vraponin njerëzit të fshiheshin prapa avllive sikur t'i përpinte dheu.

Leksi hyri në oborr. Një forcë e pakundërshtueshme e shtyntë përparë. Sa herë dëgjoheshin gjëmimet e shurdhëra të luftës, ushtarë të patrullës vraponin nëpër lagjet e varfëra. «Çupa ime... Çupa ime e

vogël mos është përjashta?». Te dera e oborrit pa të shoqen me kokë zbuluar. Shamia e bardhë me temina i kishte rënë mbi supe. Aleksit iu prenë gjunjët. Gruaja ktheu kokën nga ai me fytyrë të përlotur, me buzët të dredhura. Nuk guxonte të shihte Leksin në sy. Leksi e pyeti:

- Ku është Dita?
- ...!
- Ku është çupa, moj?
- Iku...
- Ku?
- Me Tomin e Kolit atje në male...

Leksi ju turr me forcën e tij të hekurt, për ta dërmuar, për ta zhdukur, për ta shtypur si një plesht. Ajo nuk vlide asgjë, deri sa nuk kishte qenë e zo-nja të ruante një copë foshnjë.

\* \* \*

Gjithë atë natë të dridhshme gjëmimet nuk puhuan. Krismat herë vinin afër e drejtosheshin në oborr dhe herë vinin të mbytura si gjëmime. Njerëzit trembeshin mos armiqtë suleshin mbi ta, e i shpinin për t'i pushkatuar ose në kampet e vdekjes. Leksi ishte mbërthyer në karrigën, ku rrinte çupa e tij. Nuk lëvizte nga vendi sikur të ishte prej guri.

Përse, përse kishte bërë këtë ajo? Ç'do të thoshte bota? Prapë i therën fjalët e Kolit për vajzat e maleve...

«Ma punoi prapa krahëve. Hodhi këtë turp mbi flokët e mi të bardhë. O perëndi, si mund ta durosh ti këtë? Gratë e fisit tim kanë qenë të varfëra, po kurë nuk na kanë turpëruar».

«Ah Tomi, Tomi. Të kisha si djalin tim!» Leksi ungritet. Nuk e mbante vendi. I vinte inat me Kolin, që ishte struktur prapa mureve të shtëpisë së tij gati në të rrëzuar. Atij i vinte t'i binte me grushte murit të Kolit, që kishte lëshuar bark.

2030

50963.

LIOTEKA E SHTETIT  
NACIONALE

«Ah! Përse nuk vjen zotëri Koli të më flasë për çupat, që shkojnë maleve? E dinte ai qerratai!... Më kishte thënë kushedi sa herë. Po unë nuk e besoja».

Leksi u kthye nga e shoqja. Ajo ishte e heshtur dhe e lodhur.

— Po ti e dije që çupa...

— Jo... Ku ta dija unë?!

«O perëndi! c'të keqe kam bërë që më hodhe këtë gjëmë mbi kokë?»

— Përse e uruara nuk pyeti një herë?!

— Ajo e dinte që nuk e linim.

— E përse shkoi atje? Përse?

— Të luftojë!

— Lufta nuk është për çiliminjtë, aq më tepër për çupat.

Leksi e dinte mirë që lufta ishte punë burrash. Atij vetë nuk i kishte shkuar kurrë ndër mend të linte kudhrën e të shkonte të luftonte. I kishte parë të tjerët si luftonin. Mbretëritë vinin e shkonin, kurse ai gjithnjë atje kishte ndejtur, pranë kudhrës. Edhe në rininë e tij edhe tashti. E dinte që ca njerëz e kishin në gjak të turreshin pas dyfekut.

«Ptu, ai maskarai Tomi, ma mori çupën në qafë! Sikur ta kisha këtu atë çunak shtrembaluq, sikur të më dilte parasysh! Paskam rritur gjarpërin në gji! Si kështu, more pizeveng, po ajo është motra jote! Nderi i saj është edhe nderi yt». Leksi dridhej i tëri kur thoshte fjalën «nderi».

C'të bënte?

«Si? Të shkoj i qetë në dyqan, në atë rrugë që kam kaluar gjithnjë dhe ta di që çupën time e kërcënon rreziku? Tomi, Tomi! Ne të quajtëm Tomor që të ishe i fortë si mali ynë, kurse ti më more në qafë, më përmbyse shtëpinë... Kushedi ç'përralla i ke treguar çupës... Ajo i besonte. Jo, nuk do ta lë vetëm».

— Po ti, moj, përse nuk e ruajte çupën tonë?

— Si ta ruaja?

— Ta kycje derën, moj. Të më lajmëroje. Unë nuk e lija atë, nuk e lija.

— Po ç'do t'i bëje?

— Më mirë e vrisja me duart e mia.

Leksi u drodh nga tmerri dhe nuk i besoi fjalët që tha.

Si t'ja bënte? Ai e ndjente veten ngushtë. Nuk ishte në gjendje të thoshte se ç'do të bënte. Të shkonte kokulur në rrugicën me kalldrëm? Të mos kishte guxim të përshëndetej me fqinjët? Të mos shihte dot njëri me sy vetëm sepse një çunak si Tomi i kishte mashtruar? Jo! Ai nuk do ta linte më, do ta gjente, do ta sillte në shtëpi.

Ishte akoma mugëtirë kur Leksi brofi në këmbë.

— Ma bëj hallall, grua. Do të shkoj.

— Të paktën prit sa të agojë. Tani s'lejohet qarkullimi.

— Nuk më gjen gjë mua, jo.

\* \* \*

Dy ditë e dy net në marshim.

Asnjeri nuk kishte ditur gjë ngajeta e tij, asnjeri nuk kishte ditur çfarë mendonte Leksi. Ai kishte qenë më i heshtur se gurët e varreve. Gjatë atyre muajve që ishte vërtitur fshatrave atë e kish rrëmbyer vetëm një dëshirë: të gjente çupën. Kishte ecur rrugë më rrugë, bazë më bazë, me një èndërr, që e shihte pothuaj me sy hapur. Do ta gjente patjetër. Ajo nuk do të përmbahej, po ta shihte të atin aq të dobësuar dhe të plakur, ajo do ti hidhej në qafë dhe plaku do të ndjente rrëzë veshit frymën e saj të ngrohtë. Çupa do të ulte kokën e do t'i thoshte: «Më fal, baba... Unë e bëra këtë». Po Leksi nuk ishte më i zemëruar! Gjatë gjithë atyre muajve të vështirë ai kishte pasur vetëm një dëshirë: ta gjente patjetër. Kishte pasur një mall, një mall që i errësonte sytë e çdo gjë e shikonte si nëpër mjegull...

Në kohët më të mira, para se të fillonte dimri dhe gjermani t'i ndiqte këmba-këmbës partizanët, këta e shpjegonin heshtjen e tij të zyntë me humbjen e vajzës së vetme. Bile ata nuk ishin quditur aspak kur ai ishte shfaqur midis tyre disa ditë pas vrasjes së saj. Ata i vështronin me dhimbje flokët e tij të bardhë dhe heshtjen e tij. Në fillim shokët e quanin «babai i Dritës», po atij kur dëgjonte emrin e së bijës, zyntësia i bëhej aq e thellë dhe brenga mbi tiparet e tij aq e skalitur sa ata filluan ta thërrisin: «Xha Leksi». Partizanët mburreshin që në mes të tyre kishin këtë plak, hakmarrjen vetë të ngritur në këmbë. Ata e kujtonin gjithnjë shoqen e tyre me flokët e zez, me sytë e thellë dhe me zërin e kthjellët. I mbanin mend akoma këngët, që këndonte ajo, me vështrimin e ngulur në hapësirë, me një buzëqeshje të ëmbël e të butë.

Që nga çasti kur Leksi mori vesh vrasjen e së bijës, mbeti pothuaj krejt i mpirë. Kur luftonte, i dukej se duhej të vriste patjetër atë të huaj të mallëkuar, që kishte këputur fillin e jetës së saj. Mendimi i Leksit lëvizte ngadalë i përgjumur prapa maskës së akullt të fytyrës së tij. Të gjitha i shihte. Po thellë nuk mund të besonte, se mund të ishte i vërtetë mendimi që kurre nuk do ta takonte më bijën e tij të dashur.

Dy ditë e dy net në marshim.

Përpara tij ecte Tomi. Leksit i therte në zemër për njollat e gjakut që mbeteshin mbi dëborë. Donte të ulej, të hiqte një copë nga kapota e tij dhe të lidhte këmbët e gjakosura të Tomit. Vështronte si i habitur këpucët e rënda gati pa shoje.

«Po ajo... a ka lënë njolla të tilla gjaku mbi dëborë?» Leksi nuk kishte guxuar të pyeste ku ndodhi ngjarja, ai nuk i afrohej Tomit. Po ja që ata ecnin ato dy ditë pranë e pranë. Leksi ishte si një hije e heshtur.

Ecnin.

Tomi mbante vigun e një partizaneje të plagosur. Ajo ishte moshatare me çupën e tij. Nuk e dinte as

vetë sepse i dukej që kjo do të kishte qenë patjetër shoqja e çupës së tij; megjithëse nuk e kishte pyetur për këtë. S'donte ta pyeste. I ndjente të gjitha.

Ecnin.

Leksi kishte përbledhur të gjitha forcat për të mos u ndarë nga shokët. Kur po ngjitnin një të përpjetë, komisari iu afrua Leksit dhe e pyeti: «U lodhe?». Ai ktheu vetëm kokën dhe vazhdoi rrugën pas gjurmave të përgjakura që linte Tomi mbi dëborë.

Kasollja, ku qëndruan, ishte e vjetër dhe e ftohtë. Po ata u futën në atë kasolle si në një pallat të vërtetë. Kasollet e braktisura të staneve verore ishin shpesh e vëtmja strehë e partizanëve, e vëtmja shpresë në këto shkrepë të ngrira. Tomi la në qoshe të ksolles vigun. Leksi e mbështolli vajzën me kapotën e tij. Partizanët kishin pasur vetëm një kapotë të re. Këtë ja kishin dhënë Leksit, si më plakut. Ky mblo-dhi ca shkarpa dhe ndezi zjarrin. Djemtë e shikonin të heshtur. Ata rrinin pranë e pranë, të rraskapitur e të ngrirë dhe bisedonin për ngjarjet e ditës. Nga shprehja e ngurtë e fytyrës, nga lëvizjet e ngathhta të Leksit nuk mund të kuptoje asgjë. Herë mbas here Leksi përkulej mbi partizanen e plagosur dhe dëgjonte frymëmarrjen e lehtë e të ngadalshme, pastaj shikonte me bisht të syrit komisarin. Ai nuk donte ta ndanin nga partizanja, as nuk donte ta linte në ndonjë bazë. Nuk besonte që mund ta shpëtonte njeri tjetër përvëç atij. Leksi e dinte. Me të çarë rrëthimin e dëborës, të ujqërve dhe të gjermanëve, do ta vendosnin vajzën në ndonjë bazë. Ai e dinte që do të ndahej nga ajo, megjithëse nuk donte ta besonte. Zgjati dorën e madhe dhe të ashpër dhe preku me gishtërinj flokët e hollë e të butë të vajzës. Leksi u drodh dhe e largoi dorën. «Edhe Dita ime i kishte të butë flokët». Ktheu kokën nga shokët. Ata kishin rënë të flinin të dërmuar. Atë nuk e zinte gjumi, kishte shumë kohë që gjumi ishte mërguar prej tij. Flaka e zjarrit u binte djemve në fytyrat e ashpra dhe të

dobëta. Tomi bënte roje te dera e kasolles. Leksit iu kujtua koha kur Tomi ishte i vogël luante në oborrin e shtëpisë së tij me Ditën, kur rrrokullisej mbi barin e gjelbër. Çupa hipte mbi sofat dhe fëmijët e Kolit e dëgjonin, ndërsa ajo u tregonte përrallën e vajzës së vogël, që kishte kapërcyer ylberin dhe ishte bërë djalë. Atij iu kujtua kur këndonin ata të dy: çupa me flokë të shpupurisur, me zërin e ngrohtë e të ëmbël dhe me vështrimin e ngulur në hapësirë dhe Tomi me zërin e plotë e tingëllues. Ai dhe Koli i shikonin të mallëngjyer...

Leksi u ngrit ngadalë duke u lëkundur. Me Tomin thua jse nuk kishte folur fare. Dhe ky i shmanej Leksit, sikur të ishte fajtor për diçka: Tomi e dinte që në fëmini se ç'ishte vajza me flokët e zez për Leksin. Edhe babai i tij, Koli, thoshte gjithnjë: «Lëre Leksin, është matufepsur pas çupës».

Leksi i nguli një vështrim fytyrës së tretur e të parruar të djalit. I vinte rëndë kur kujtonte dëshirën që kishte pasur atë ditë për t'ja këputur kokën me duart e tij të hekurta. Leksi i bëri shenjë. Tomi u afrua i lodhur, me sytë përdhe.

— Të dhëmbin shumë? — e pyeti ai.

— Jo! Duroj akoma.

— Hiqi këpucët!

Tomi u ul dhe u bind si atëhere kur ishte i vogël.

Leksi ja pastroi plagën me ujin e ngrohtë dhe ja lidhi shpejt e shpejt. Tomi diç deshi të thoshte. Po ishte kaq i kapitur, sa e zuri gjumi menjëherë. Një buzëqeshje e ëmbël, e ngrohtë ishte nderë mbi tiparet e mprehta të djalit, ndërsa Leksi përpinqej të gjente, të merrte me mend se si ja kishte marrë nga shtëpia çupëzën, që qëndiste pëllumbë mbi gjergjef. Po përsë të lodhej? Tashti ai e dinte se çfarë i kishte thënë. E dinte. Edhe vetë ai dëgjonte si i çuditur fjalët e komisarit. Ato binin mbi kokën e tij si uji i pastër i një burimi në një tokë të shkretë e të zhuritur.

Leksi i përfshiu me vështrimin e tij të lodhur të

gjithë ata që flinin në kasolle. I vështronte me kujdes. Bile nganjëherë sikur i numëronte. Edhe çupat flinin të rraskapitura pranë e pranë. Leksi u ngrit, se pse i erdhi rëndë nga vetja për ato që kishte menduar dikur.

Ja si qenkish puna! Ishte endur një jetë të tërë, nga dera e kovaçanës, nëpër rrugicën me kaldrëm, me gurët që u njilte të gjitha madhësitë dhe ngjyrat. As që kishte dashur të mendonte përsë i linin këta të rinj vatrat e tyre dhe shkelnin me këmbë të përgjakura në dëborë. Ja ku ishin gjurmët. Ato do të mbeshteshin atje derisa të binte dëborë e re ose derisa të shkrinte dëbora dhe të vinte pranvera.

Leksi u përkul mbi trupin e vajzës, dëgjoi frymë-marrjen e lehtë, ndjeu ngrohtësinë e jetës së re mbi faqen e tij të ngrirë e të parruar. Një ndjenjë e vakët e pushtoi gjithë qënjen e tij. Ai e ndjeu veten çuditërisht të lehtë!

Dy ditë e dy net shkeli pas gjurmëve të partizanes së plagosur dhe të Tomit. As që e dinte ku kish lindur ajo. Kush ishte? Nga duart e bardha e të holla dukej që do të ishte shkollare. Por për këtë nuk ishte i sigurt. Edhe Dita e tij kish pasur duar të bardha, megjithëse nuk ishte shkollare.

Dita e tij! Zokthi i vogël. Ai e kish mbërthyer mirë në kafaz. Po ajo kishte flakur tej qëndizmat, lule jargavanin, sofatin e gurtë dhe kish fluturuar përashta.

Leksi doli te dera e kasolles. Kishte akoma ndjesinë e frymës së ngrohtë. Një shkëndijë e lehtë gëzimi shkrepi mbi ballin e tij të vrenjtur.

Kur, papritur, ai dalloi yllin e mëngjezit. Nga të gjithë yjet e panumurt Leksi dinte vetëm emrin e një ylli, atë të mëngjezit. Këtë e dinte që në fëmini. Ai e pa edhe një herë atë yll, që quhej Afërditë dhe iu kujtua ajo kohë, kur priste, nën pjegullën e shtëpisë së tij, gruan t'i sillte në jetë një fëmijë. Në oborrin e

heshtur, me erën e barit të posakositur, ai kishte pasur vetëm një shoqërues: atë yll të largët që e njihet që në fëmijni dhe ja dinte emrin. Sapo dëgjoi klithmën e parë të fëmijës, Leksi vendosi se, po të ishte çupë, do ta quante Afërditë.

Leksi e shikonte me dhimbje yllin e mëngjezit. Ç'kohë ishte kur plumbi i huaj këputi fillin e jetës së saj? A ndritshonte ky yll aq shumë, si atë ditë kur lindi ajo?

Aleksi donte të besonte që ajo e pat përshëndetur atë, babanë, që ajo i kishte kërkuar të falur. Po përsë, përsë t'i kërkonte falje? Për ç'faj? As ai vetë nuk e dinte. Nuk e zinte gjumi Leksin. Gjithë natën ai u kujdesua për partizanët, që flinin, për çupën e plagosur dhe e mbajti zjarrin ndezur deri sa një dritëz e dobët mezi mbi shkrepë.

Leksi pa se si lëvizën disa nga djemtë. Po atij i vinte keq t'i zgjonte. Ishte akoma shpejt e rruga që do të bënin shumë e gjatë! Ujët që kishte vënë Leksi mbi zjarr në një kusi të vjetër bakri ishte ngrohur dhe nxirrte avull. Ai e dinte që, përveç ujit, ata s'kishtin asgjë tjetër.

«Tashti është ngritur edhe ajo». Leksi u çudit me vete. Kaq kohë nuk e kishte kujtar gruan. Po ja që po i bëhej se po e vështronse se si po hapte sytë, si falej përpara ikonës, si i mbante lotët me zor duke parë krevatin bosh të çupës. Ai e ndiqte me mendje kur ajo ecte duke u lëkundur në hajatin e errët. Bile iu duk sikur dëgjoi që shkeli mbi plloçat e prishura. «Ujët ka ngrirë mbi grykën e pusit. Ajo do të përkulet. Do të mbushë kovën me ujë dhe do të vërë çajin. Gjithë jetën e ka bërë këtë punë. Gjithë jetën».

Rrezet e pjerrëta të diellit ranë mbi kasollen e ngrirë të malit. Djemtë u zgjuan nga gjumi dhe u gëzuan për ujin e ngrohtë. Tomi u ngrit i fundit. Plagët e këmbëve i ndjente më mirë. Iu afrua Leksit dhe, duke vështruar majat e këpucëve, i pëshpëriti:

— Falem nderit, xha Leks!

Njëshkolona nisi marshimin. Dielli thyente rrezet mbi bardhësinë e dëborës. Tomi ecte përpëra Leksit duke shtrënguar vigun. Leksi e ndihmonte të mbabin partizanen e vogël. Çudi si nuk ndjente lodhje! Do të dëshëronte të shpëtonte nga syri i komisarit. Po ai e arriti dhe i tha:

— Shoku Leksi. Kjo nuk është punë për ju. Ja lini një më të riu.

— ...!

— Në bazën e parë do ta dorëzojmë.

Ai e kuptoi që ishte fjala për partizanen e vogël. Deshi të thoshte: «Nuk lodhem deri sa të gjejmë një spital partizan». Po nuk tha asgjë.

Rrezet e pjerrëta të diellit thyhen mbi dëborë. Tomi filloj i pari të këndojë. Këndonte lehtë. Atë ndofta nuk e dëgjontë asnjeri përveç Leksit dhe partizanes së vogël.

«Padrejtësia do të zhduket.

Nga pallatet përgjithmonë...»

Leksi u shkund i tronditur nga timbri i njohur i zërit të Tomit. Veshi i kërkonte edhe zërin tjetër. Sikur të ishte edhe ai zëri tjetër! Zëri i çupës së tij!

Si ishte e mundur të kishte jetuar gjithë jetën, gjersa i ishin thinjur flokët, me mugëtirën e dyqanit të tij? kishte qenë i verbër? Leksit i vinte turp që nuk e kish ditur këtë me kohë. I dhimbte zemra kur mendonte me çfarë çmimi e mësoi të vërtetën. Fytyrën e kish të ngrysur, lotët të ngrirë nga thëllimi i atij mëngjezi. Po sa mi-rë që asnjeri nuk e vinte re! Ai përfshiu me një vështrim të ngrrohtë e të dhëmshur të gjithë rrjeshtin e gjatë të njëshkolonës. Nuk kishte fuqi që ta ndante nga ata! Djemtë ecnin duke kënduar. Ata nuk shihnin fare rrëpirën e thepisur, vdekjen dhe gjermanin, që u rrinin si cekan mbi kokë.

## QIELLI I KTHJELLËT

Zhgaravis me majën e thikës së hollë prej argjëndi faqen e ndritur të bankës. Sytë e mendjes lexojnë kudo një inicial: Bashkimin e vijave të holla, që krijojnë germen «K».

Auditori është i madh. Ne rrimë në bankën e fundit të mbrojtur nga një barikatë e tërë shokësh.

Më parë as më shkonte ndër mend që mund të zbatimet duke krijuar kombinacione të ngatërruara me këto vija... I zgjas pak këmbët e K-së. Pastaj i pres në mes. Zbuloj se atje mund të përmblidhet fillimi i emrit tim. Bile dy herë me radhë e përsëris dhe qesh me vete. Shpresë, shoqja e bangës, më jep një të shityrë me bërryl:

- Ç'ke?
- Profesori!
- Ç'po bëj?
- Dëgjo leksionin! Kujdes!

Në vend që të dëgjoj, ndjek lëvizjet e gishterinjve të dorës së majtë në xhepin e palltos, që përkëdhelin pareshtur një zarf të lëmuar, shkruar pa kujdes. Interesant! Kujtimi nuk lustron asgjë. I bie shkurt. Sytë e kaltër, njëri më i vogël se tjetri, lëvizjet nervore të duarve të gjata nuk e fshehin dot ash-përsinë e tij. S'e përcaktoj dot se kur jemi njojur. Më duket sikur kemi gjithë jetën. Më parë, ai ishte një student thatanik me flokë të prerë shkurt, të ngritur

përpjetë si gjëmba, veshur me gozhup shoferësh. Vinte shpesh në rrugicën tonë të ca të njohur.

Atëhere isha fëmijë. Nuk mendoja për asgjë të tillë.

Majrat e gishtrinjve lexojnë si të verbërit rrjeshtat e pusullës.

«Mira! Të djelën do të vij të të marr. Do të vish?

«Të shkoj? Të shkoj?»

Kjo pyetje më mundon, që kur kam marrë letrën.

Një ndjenjë e rrëmbyer, që nuk e përcaktoj dot me emrin e saj të vërtetë më gjallëron.

Të thuash të drejtën, kokën e kam të fortë.

Ajo më urdhëron të dëgjoj leksionin dhe të harrroj këtë përpëlitje. Po zemra? Zemra nuk do që të bindet.

Bangën e kemi pranë drifores. Bisqet e gjelbër të mimozave sapo kanë nxjerrë profilin e tyre të ëmbël, delikat. I vë re një copë herë.

Zgjas dorën të hap xhamin. Shpresat më bie sëri me bërryl. Kësaj radhe më dhëmbin brinjët. «Kujdes!»

Shikoj me keqardhje prapa xhamit.

Marr pjesë e tëra në lexicin e heshtur të gishtërinjve. Unë s'e kisha menduar kështu jetën time: Një dhomë në mes të barangave të tjera të një kantieri, dhe një emër që e pëshpëris cdo çast. Ndjej si përtërihem nga një forcë e re, e thellë, e fshehtë, përkëdhelëse.

Po Kujtimi përse më dashuron pikërisht mua? Apo pasi të kalojnë disa vjet, do të dashurojë një vajzë tjetër? Pastaj do të ankohet për një gabim të pandreqshëm të kohës së rinisë!

Nxjerr zarfin dhe lexoj letrën përsëri.

«Sa më ka marrë malli Mira, më dëgjon?»

Zhgaravis papushim vijat e holla të inicialit «K». Thika më dridhet në duar. Është i vetmi kujtim që kam nga shtëpia ime.

Kësaj radhe gërma «K» del fare e qartë mbi si-

përfaqen e zezë të bangës. Trembem. Ato vijëza të holla flasin me gjuhën e tyre të ngatëruar.

\* \* \*

...Nëna ime ishte e sëmurë. Babanë, të dyja e donim shumë.

Ajo dergjej në shtrat prej kohësh. I rrija pranë. Nëna thoshte:

— Pa shih mos ka nevojë për gjë babai!

Dëgjoja çik-çakun e maqinës në dhomën e punës së babait. Kujtohesha. Në atë orë ajo e kishte pasur zakon t'i shpinte çajin. Ngrihesha me gotën në dorë. Nëna më falënderonte me sy. Ishte e dobët. Gjysmë e paralizuar. Nuk ankohej kurrë. Dukej që nuk kishte frikë nga asgjë.

E shikoja si i ndizej një shkëndijë në sytë e shuar kur kthehesha nga dhoma.

— Ishte i gëzuar? — pyeste.

Diçka murmurisja.

— Mira; Duhet ta duash babanë. Ai ka nevojë që ta duan.

— Mama, po unë e dua shumë!

— Ta duash gjithnjë... Gjithnjë. Në çdo rrethanë qoftë. Jeta është e gjatë dhe ka shumë të papritura. Po ti s'do të ndahesh asnjëherë nga ai, sido që të jetë!

E shikoja e habitur. Atëhere nuk kuptoja asgjë.

Ndjeja një dhimbje të madhe. Përse ma përsë-riste këtë gjithnjë?

Ndodhët dhe kështu. Megjithëse isha duke marrë maturën, ulesha pranë babait, dhe ai më lëmonte flokët.

— Tashti jam e qetë, — pëshpëriste nëna kur na shihte.

Sic duket ajo kishte vetëm këtë dëshirë. Të lidheshim sa më shumë, që të mos e ndjenim boshllëkun që mund të krijohej nga mosqënia e saj.

Ngjarjet u rrukullisën shpejt. Aq shpejt, sa mezi i i kujtoj. Gëzimi i fundit i nënës qe zgjedhja e fakultetit që do të ndiqja unë. Më çudiste këmbëngulja e saj. Dukej sikur harronte dhimbjen dhe orët e numëruara.

Babai ishte për kiminë.

— Kimia të than shpirtin, — thoshte ajo me dëshpërim.

— Kimisë i takon e ardhmja — ngulte këmbë ai.

— Ndërtuese! Ndërtuesve u takon e ardhmja — përsëriste ajo...

Ishte e vëtmja herë që nuk mendoja njësoj me babanë. As më shkonte ndër mend të zgjidhja kiminë, me ato formula të ngatërruara si hieroglife. Më përkëdhelej sedra kur mendoja për ndërtuesit, për veprat e tyre që janë dëshmitare të të gjithë brezave.

Fitoi nëna.

Ajo shkëlqente e tëra atë ditë, kur mora rrugën e universitetit me një blok shënimesh. Po s'kaluan as dy muaj dhe unë mbeta vetëm.

Nuk më besohej se do të ndaheshim përgjithnjë dhe nuk do ta shihja më kurre.

Vetëm pasi e humba, e kuptova mirë këtë gjë.

Dëshpërimi, sedra dhe krenaria më mbanin në këmbë. Shkoja në fakultet. Shkruaja leksionet, që na diktonin. Mësoja çdo ditë dhe përgjigjesha në çdo seminar. Nuk doja që të më quanin të mjerë.

Më merrte malli për nënën. Kur dilja në rrugë, kërkoja me sy ndonjë grua që të ngjante me të, po asnjëra nuk i ngjante asaj.

Babai më mbante gjithnjë pranë. Rrinim në dhomën e punës. Më mësonte të shkruaja me maqinë.

Babai më diktonte. Doja të isha e denjë për besimin e tij. Të hyja thellë në gërshetimin e veprave të tij. Nganjëherë pyesja padashur:

— Vërtet?

Një nënqeshje e lehtë kalonte mbi tiparet e tij të zymta dhe të rënda.

Mendoja: «Ēshtë i dëshpëruar». Si nuk e kisha vënë re më parë? Si nuk kisha turp që prisja të më ngushëllonte? Isha kredhur në dëshpërimin tim, sikur të isha epiqendra e botës. Shikoja me zemër të dredhur flokët e tij të qethur e të thinjur para kohe. Ai nuk ishte as pesëdhjetë vjeç! Sa do të dëshëroja të ishte si më parë! Dhe sa më tepër depërtoja nëpër ato brazda të thella që kishte lënë jeta mbi fytyrën e tim eti, aq më shumë kuptoja se nuk mund të ishte më si më parë.

Vija re se diçka e brente çdo ditë e më shumë. E shtypte. Nuk më shikonte më drejt në sy. Midis nesh qëndronte pezull një hije, që na ndante.

Njëherë babai ndërpree leximin.

— Pushojmë pak Mira?

— Si të duash.

— Unë u lodha.

Dhe vërtet! Ai e mbante kokën ndërmjet duarve dhe mendonte.

— Ç'mendon, babi?

Ai ngriti kokën, që i rëndonte nga një mendim i dhimbshëm. Më shikoi i hutuar, sikur të vinte nga një udhëtim i largët.

— Asgjë, Mira! Ashtu kot.

Po nuk thoshte të vërtetën.

Isha mbështetur në shpinën e karriges. Ndiqja me vëmendje lëvizjet e ngathëta e si të përgjumura të tim eti. Ai hapi perdet e dritates dhe e nguli vështrimin në qiellin e kaltër. Pastaj, befas, u kthyte nga unë dhe më shtrëngoi me duart e tij të fuqishme. Ndjeva të dridhurën e lehtë të muskujve dhe përpjekjen për të larguar mendimin që po e brente.

— O babi! — thashë fare papritur. — Më copëtovë.

Ai qeshi. E shikoja e mallëngjyer. Kisha kohë që nuk e kisha parë ashtu.

— Shejtan çupë!

— Babi ne ju themi «xhaxho» atyre që kanë flo-kë kaq të thinjura.

— **Epo** mirë.

— Nuk dua të të thonë edhe ty «xhaxho».

— Jo, — tha ai, unë nuk jam «xhaxha». Dëgjo Mira! Dua të bisedoj seriozisht me ty...

Unë s'po mblidhja veten nga habia. Ç'thotë kësh-tu babai? Se do të martohet me një grua tjetër! Dhe unë duhet të jem e arësyeshme?

Duhet ta kuptoj atë! Po çfarë të kuptoj?

Dhimbja më hutoi. Po jo aq shumë sa të mos ndjeja që isha e tepërt. E tepërt në shtëpinë time.

Përse donte ta bënte këtë gjë? Përse? Ne ishim aq mirë të dy! Unë e doja aq shumë!

Të nesërmen mora, shpejt, ç'munda. S'pata ko-hë as të mallëgjehem. Ika me rrëmbim. Bile nuk mbaj mend se ç'shkrojta në një copë letër.

Nxitaja. As unë nuk e dija se për ku. Për një gjë isha e sigurt: Në shtëpi nuk do të kthehesha më! Më vinte të qaja. Të ulërija me të madhe. Po s'qaja dot.

Dita ishte e kthjellët. Lulet e bardha të bajameve kishin buluar mbi degët e zhveshura. Natyra kishte qëndisur këtë kontrast: delikatesën e petaleve me drurët ngjyrë dheu të plasaritur, e të ashpër.

Shpresa dhe Petriti që i takova rrugës, s'mu nda-në asnjë çast. Nuk ishte koha që të më qortonin. Ata vetëm heshtnin, megjithëse kishin dëshirë të më përmblidhnin dhe të më jepnin një dush të mirë.

U rrropatëm deri në dekanat. Kërkuam një vend në konvikt! Dikush më shoqëroi. Cili? S'më kujtohet. Vetëm mbaj mend Shpresën që më tërhiqte për dore për në dhomën e saj.

Rashë me gjithë rroba, e këputur, në vendin që më kishin caktuar. Pashë vajzat e tjera që hynë në dhomë. Shoqe të fakultetit tim. Vajzat heshtnin. Sa mirë dinë të heshtin në të tilla raste vajzat e konvik-teve!

Isha e sëmurë. Nuk e mbaj mend sa vazhdoi kllapia.

Mira, bija ime!

Mjergulla, që më vishte sytë m'u shpërnda ngadalë. *Pashë Shpresën*, Petritin. Babai, rrinte buzë krevatit, me *tipare* të tendosura. Muskujt e fytyrëe i lëviznin lehtë. *Buza e hollë* i dridhej papushim. Vështrimi ishte lutës, *i mallëngjyer*. M'u mblohd një lëmsh në grykë. Isha gati t'i rrëmbeja dorën. T'ja puthja. Pikërisht atë dorë të djathtë, që e adhuroja aq shumë kur shkruante. Doja të thërrisja:

«Nuk do të iki më! Merr cilën, të duash në shtëpi!»

Po një ndjenjë tjetër, e egër, një ndjenjë kryeneçe më shtynte të thosha të kundërtën.

— Je munduar kot, — thashë me një zë të mëkur, si të huaj.

— Bija ime!

U ngrita me rrëmbim. Ndjenja e hakmarrjes zjente dhe turfullonte aq shumë, sa nuk e mbaja dot.

— Kthehu në shtëpi! Ti s'je foshnjë. Taksia na pret jashtë. Ti duhet të më kuptoje Mira. Se prisnja këtë rebelim nga ti që je një vajzë e zgjuar!

Shpresa me Petritin rrinin përballë meje me një vështrim të çuditshëm. E çfarë? Përse më qortonin?

— S'kam bërë ndonjë krim. Pse të arratisesh nga shtëpia?

Vura re fytyrën e dërmuar të tim eti.

Nuk duhej të kisha folur. Por unë kisha vetëm një dëshirë: të hakmerresha. Siç isha e tronditut s'doja të dëgjoja ç'më thoshin Shpresa me Petritin.

Babai qëndronte në këmbë, i heshtur, i trishtuar.

Ndjenja ime rebele, që kishtë ngritur krye, s'përmbahej.

— Nuk kam as shtëpi, as baba! — klitha.

— Mira! . . .

— Ti i zëvendësove të gjitha! Përse më trazon? A nuk je i kënaqur me kaq?

Shpresa bëri një lëvizje të dëshpëruar me dorë. Petriti doli jashtë.

Shikoja si u kërrus e u rëgjua trupi i tim eti. Shpatullat e tij u rënduan. M'u duk sikur u plak brënda këtyre minutave edhe disa vjet të tjerë...

\* \* \*

S'doja ta kujtoja më të kaluarën time. E ardhmja ishte në prag dhe vinte, që larg, nëpërmjet fjalëve të një letre të dashur dhe vështrimit të Kujtimit.

Zbritëm, të zëna për dore me Shpresën, shkallët e mermerta të universitetit. Ishte ftohtë. Ngritëm jaka e palltos. Po binte muzgu me një ngjyrë të purpurtë, sikur të kishin marrë flakë retë. Pastaj ngjyrat filluan të zbehen, nga të kuqërrreme u kthyen në manushaqe me një rrëth si të artë dhe pastaj në gri, e më vonë në blu.

Ne mbetëm një copë herë duke parë perëndimin e diellit. Nga instituti i arteve dëgjohej zëri i pastër i një tenori që këndonte me pasion. Heshtëm. Na rrëmbeu bukuria e muzgut... sidomos çasti i fillimit të muzgut, që të ngjallë në shpirt aq ndjenja të bukura. Filluan të ndizen njëra pas tjetrës dritat e neonit midis fletëve të pishave, që i jepnin ndriçimit një regëtimë të gjelbër. Ndërsa drurët e tjerë ishin ende të zhveshur.

Filloi vërvshimi i njerëzve dhe zhurma e jetës në qytet. Njerzit ecnin të shkujdesur. I gëzoheshin kthjellëtisë së ftohtë dhe perëndimit të diellit. Muzgjet në dimër kanë një ngjyrë të jashtëzakonshme. Jeta rridhete me ritmin e saj. Vëtëm duhet të mos mbetesh as një hap prapa, se është e pamundur të arrish atë që humbet.

— Shpresa, u vonuam! S'arrijmë dot as në mensë.

— S'ka gjë. Sonte më pëlqen të shëtis. Dhe sa për të ngrënë kthehemë në «klubin tonë».

Qesha. M'u kujtua «klubi». Një barangë me dërrasa. Një bufetjër me sy të enjtur, me një palë mustaqe spic si të lyera me dhjamë, ca tavolina të vogla

gjithë thërrime dhe gota të boshatisura birre. Në këtë klub shkojnë gjithë studentët kur mbeten pa darkë.

— Në fund të fundit — tha Shpresa — ti duhet të kuptosh diçka...

— Çfarë?

— Që s'mund t'ja fshehësh ndjenjat e tua shoses tënde më të afërt...

— Shpresa!...

— Përse mbylllesh në vetvete? Kujtimi është një djalë i rrallë dhe s'ka pse të skuqesh për dashurinë tënde.

— Jo... nuk skuqem... Vetëm kam dashur ta zgjidh në vetvete: A është kjo dashuria e vërtetë, që e kam pritur me aq kureshtje dhe ëndërra mahnitëse! Apo është një ndjenjë e rëndomtë dhe kalimtare?

— E zgjidhe më në fund?

— Po, Shpresa e dashur! Po! Po!

Shpresa zbriti e para në rrugëzën e ngushtë që dredhonte nëpër urën e drunjtë, humbur mes shelgjeve vajtues. U mbështetëm pas parmakëve duke përthyer gjunjët.

— Dëgjo, — tha Shpresa.

U ndie një fëshfërëritje e lehtë që të mbushte shpirtin me poezi.

Shpresa përkuli kokën dhe recitoi me zë të ulët dhe melodioz.

«O qielli im, ti je më i kthjellët se çdo kaltërsi.

«O dielli im, ti je më i zjarrtë se çdo dashuri...»

Kështu i fillon letrat e dashurisë Kujtimi? — pyeti ajo.

Unë qesha.

## II

— Shpresa?

— Hë!

— Zgjohu! Gjumashe. Po bie dëborë!

Ajo hap sytë. Sa më pëlqeijnë sytë e saj ngjyrë gri!

— I émbël éshtë gjumi kur je e lumtur! — i them unë.

— Edhe sikur ta zinim lumturinë me dorë nuk do të besonim që jemi të lumtur. Gjithnjë do të gjenim ndonjë shkak, pér të mos qenë të lumtur, — fillon të tallet Shpresa.

— Léri sofizmat. Më flihet. Ç'më zgjon kaq shpejt? «Ke shekuj që të flesh në qetësi».

— Po. Shiko! Shiko! Qenka vërtet dëborë!

Dëbora binte me copa të mëdha, të dendura dhe shkrihej menjëherë. Fëmijët vraponin. Hapnin çadrat, ruanin me kujdes dëborën që mblidhej mbi to, sepse ishin të etur pér të luajtur me topa.

— Shiko si éshtë veshur Dajti! Do të kaloni pushime të gëzuara. Do të rrëshqisni me ski. Vetëm të kesh kujdes, mos të vravosh shumë!

— Fajin e ka Petriti. Unë jam vajzë e urtë, po s'dua të mbetem prapa. Kam sedër të sémurë.

— Interesant. Mbrëmë gjithë rrugës jemi zënë me Petritin.

— Pse?

— Pér shkak të projekteve. Ka në kokë ca idera të çuditshme.

— Çfarë tha?

— Idetë e projekteve qenkan shumë standard. Tha se na mungon fantazia dhe vështrimi në të ardhmen e largët, se ajo që ndërtojmë duhet të mbetet sa më gjatë dhe jo të vjetërohet nëpér duar.

— Ka të drejtë.

— Tallesh?

Shpresa ngrihet më vrull. Vishet shpejt e shpejt.

«Nuk kam pasur motër ndonjëherë, po mendoj që nuk do ta doja më shumë se Shpresën. Do të ndahemi pér disa ditë. Do të më marrë malli.»

— E do shumë Kujtimin, thuaj të drejtën? — pyet ajo papritur.

- Ç'është kjo pyetje!
- A është ai çdo gjë për ty. Çdo gjë? Bota, horizonti, deti dhe qelli? Çdo gjë?
- Qesha me të madhe.
- Nuk është pak të jetosh vetëm për një burrë?
- Ç'të ka hipur në kokë?
- Po dashuria... a është e përjetshme? Në shekullin tonë... ka ca korrigjime...!
- Dashuria është vetëjeta. Po ti ç'ke kështu sot?
- I kam inat gjithë djemtë, sidomos Petritin. Kush e mban tashti, do të ngrefoset si gjel deti. Po, po të fillojë të më shessë mend prapë, do t'i përvishem që ç'ke me të.
- Epo mirë, përse nxehesh? Në qoftë se e kemi bërë projektin gabim duhet ta korrigojmë.
- Po atij do t'i dalin fletë.
- Përse e ngacmon gjithnjë Petritin! Ki mendjen!
- Edhe ti ki mendjen, mos i lësho shumë pe atij idhullit tënd, se do të të shkelë me këmbë.
- Dukesh që s'dashuron. Po e di ti që dashuria është barazi, është frymëzim, është shtytje e dyanëshme përpara. Në qoftë se nuk është e tillë, atëherë është lojë e cekët, kalimtare dhe pa kuptim!
- Shpresa mbështetet pas murit dhe mban zemrën me dorë. Ajo është në qejf, do të bëjë shaka.
- Aman, Mira. Nuk të mjaftojnë orët e leksioneve?
- Më teprojnë, bile.
- Ke të drejtë. Po unë i kam ngjarë atij të famshmit mbret të Francës, që e zinte koka kur merrej me «punë të mëdha»!
- E nënveftëson shumë veten, e dashur.
- E krahasoj me një mbret.
- Që ja preu kokën gilotina, harrove?
- Po shkoj të marr Petritin. Do të përpinqem të bëj autokritikë. — Mirë u pafshim!
- Shpresa doli gjithë gaz. Bora binte e shtruar dhe ishte e butë si pambuk.

Gjithnjë kur mbetem vetëm, pa të, dhoma më duket e zbrazët, e shurdhër.

Pres Kujtimin. Shpresa ka të drejtë. Ai nuk është një enigmë e pazgjidhshme, e mbuluar me një vello plot mister. Kaq shumë ia njoh tashti çdo njenjë, çdo mendim, çdo lëvizje dhe timbër zëri, të ecurën me trupin e hollë, pak të kërrusur, shenjën në mjekër dhe sidomos të qeshurën e tij të singertë. Ndjenja ime nuk është një flakë, që ndizet e shuhet. Më merr malli po të mos e shoh. Tashti ai është ende larg, po unë e di. Nga ai s'mund të më ndajë asgjë. Ne do të nisemi. Do t'i biem nëpër rrugët më të shkurtëra për të vajtur në hidrocentral.

Ndjej hapat e njohura në koridor dhe pa kuptuar as vetë tronditem.

— U bëra merak. Pse u vonove Kujtim?

— Rruga është gjithë dëborë. Mezi kemi ardhur me shytën e Hysos. Të kam folur për Hyson?

— Je mërzitur? Prit të të shoh!

— Hë! Si të dukem?

— Më mori malli! Po ty?

— Edhe mua.

Tashti nuk dua gjë tjetër, vetëm të dëgjoj këtë zë të quartë.

— Ku janë shokët?

— U nisën për pushime.

— Ç'po bëni me projektet?

— Kemi ngecur. Nuk e shprehim dot atë që duam.

— Do të mundeni. Vetëm njerëzit e dobët nuk mundeni.

— Petriti kishte vërejtje. Duhet t'i fillojmë edhe një herë nga e para. Shpresa është bërë tym se e ka vështirë të bëjë autokritikë.

Kujtimi vëren me kujdes skicat e projektit tonë. Duart nervoze nuk i zënë vend. Është i shqetësuar. Këtë e kuptoj edhe pa e parë fare.

— Do të vish Mira? — pyet ai më në fund. Jash-

të po na pret Hysua dhe Adriatiku, një shoku im që  
është transferuar në kantier.

Dalim jashtë. Fëmijët duan të na gjuajnë me topa  
dëbore. Dëbora bie papushim. Janë veshur me gëzof të  
bardhë mimozat, akacjet dhe shelgjet vajtonjës. Edhe  
trotuarët dhe çatitë e shtëpive janë mbuluar me dëborë.  
Në fund të rrugës, atje ku akacjet krijojnë një pyll të  
vërtetë, të bardhë më zënë sytë shytën e Hysenit.

— C'vepër origjinale është edhe kjo shyta juaj.

— Mos u tremb. Këtë «vogëlushe» e kemi të përpiktë, — thotë Hysua.

«C'vogëlushe! Është si një plakë që përpinqet të du-  
ket e re, vetëm, sepse ka veshur një fustan të bardhë»,  
mendoj me vete.

Hysua është shofer i rrallë. Këtë e kuptoj aq mirë  
në çdo lëvizje të përqëndruar, të kujdesshme. Adriati-  
ku ka veshur një pallto të trashë guben dhe rri i hu-  
mbur në të, si i hutuar.

— Pjesën e parë të rrugës do të fluturojmë, pas-  
taj do të çajmë — thotë Hysua. — Të ze maqina? — Jo.

— Shyta jonë vrapon, vrapon pa u ndalur fare —  
thotë Kujtimi.

Ne lemë prapa çdo gjë. Syri mezi arrin të kapë  
siluetat e majave të maleve të veshura me borë. Ata  
duken si gjigandë të përgjumur. Era e ftohtë hyn  
nëpër dritatret prej kauçuku.

Qielli është i plumbtë.

— Më ndiz një cigare — thotë Hysua.

Kujtimi merr paqetën nga xhepi i xhaketës. Je-  
mi kaq afër sa ndjejmë frysëmarjen e njëri-tjetrit.  
Ai nuk e vë re. Rruga është me gropë. Maqina na tro-  
shit dhe na hedh përpjetë.

Kujtimi është i emocionuar dhe hesht. E vërte-  
ta është se ai nuk e ka zakon të bëjë zhurmë, sidomos  
irreth vetes. Po as që është nevoja. Unë e di, kur  
e ka marrë uria, kur i flihet, kur është i lumtur dhe  
kur e bren diçka.

Para nesh dëborë.

Det dëbore.

Shyta, si një maune e rëndë, çan detin e dëborës.

— Do të arrijmë dot sonte? — pyet Adriatiku.

— Patjetër.

— Më duket sikur do të na mbulojë dëbora, ose do të na bjerë ndonjë ortek mbi kokë.

— Përralla! Që kur ke filluar t'u trembesh hijeve? Do të arrijmë sonte, gjallë ose vdekur. Kantieri nuk mund të qëndrojë asnë sekondë pa punë, — ia pret Hyseni.

— Po sikur të zihet rruga?

— Nuk do të zihet!

Uturima e motorit të merr mendtë. Një copë herë ne ndjekim zukatjen e fluturave të dëborës. Ato enden në hapësirë si të verbëra, pastaj përplasen mbi xhamin e trashë, të akullta, të pafuqishme. Ngrohtësia i kthen në brymë të shkëlqyeshme, por ja, një lëvizje e shpejtë e dy vijave paralele të fshirëses mbi xham, e pastaj nuk mbetet asgjë.

Vështrimi i vakët dhe i mjergullt i Adriatikut endet një copë herë në kabinë. Në ballë të saj, atje ku shoferët zakonisht mbërthejnë ndonjë kukëll ose majmun, Hysua ka vënë portretin e një luftëtarëje vietnameze.

Hysua dhe Kujtimi vërvhellejnë nëpër hundë melodinë e një këngë, që këndonin gjithnjë në fëmini, në muzgjet e buta të majit, ulur nëpër praqet e portave, n'ato muzgje të largëta dhe të dashura, që janë arratisur nëpër hapësirë.

Jashtë, bredhat duken si fidanë me atë petk të ndritshëm kristali, fidanë, që kanë nevojë të mbështetin supet e hajthmë mbi këmbët prej betoni të shtyllave të tensionit të lartë. Bredhat e lashtë me atë pamje të mjerë, sikur kanë nevojë që nga fqinjët krenarë e të pathyeshëm që përçojnë ngrohtësi e drithë në nervat e tyre, të zgjatet një dorë miqësore për të shkrirë kristalin e ftohtë të akujve.

Shyta me hundë të bardhë hungron dhe kafshon tanë me zinxhirë udhën.

— Filloi edhe beteja jonë e fundit. Beteja fitimtare, — thotë Hyseni. — Kur nisëm punimet në hidrocentralin «Lenin» ne ishim fare të rinj, ju kujtohet? Atëhere as që guxonim të mendonim kaq shumë! Kisha një shok malësor. Kolë e kishte emrin. Më thoshte shpesh: «A thue, he burrë, do të kena edhe na dritë në kullat tona? «Do të kemi, kudo do të kemi» i thosha unë. Më vjen keq që nuk jetoi deri tani. Ishte minator i rrallë ai. Një nga ata luanët e heshtur të tuneleve, një malësor i vërtetë dhe, kur e mendoj këtë, them me vete, që rruga jonë nuk ka qenë e shtruar me trëndafilë. Do të dëshiroja të jetonte edhe ai tani.

Shyta çan më vështirësi përpëra. Ne lëkundemi nën peshën e mendimeve tona. Në kabinë është ngrohet. Adriatiku rri i zhytur në pallton e tij, i lodhur dhe i humbur.

— Unë nuk mendoja kurrë se do të vinte kaq shpejt dita që në kullën e Kolës do të shkonte drita — vazhdon Hyseni.

Pas kaq vjetësh u takuam përsëri me plakun e Kolës. Ai mbahej ende i drejtë, thatim, me duart e rreshkura. Ai dridhte cigare njérën pas tjetrës. Në tiparet e rrepta dhe të ftohta të plakut, përveç vëmendjes dhe pritjes, s'mund të shikoje gjë tjetër. Ai punoi bashkë me familjen e tij për dritën elektrike. Hapën gropë, mbajtën shtylla pa pushuar as natë, as ditë. Unë i njoh mirë këta burra malësorë. Veç atë natë gati nuk po i njihja fare. Edhe të rreptë ishin, edhe si fëmijë të gëzuar, që çuditen dhe presin të shohin një mrekulli. Në shesh kishte më shumë se njëmijë burra dhe gra. Ja, erdhi çasti: dritë! Ata mbetën të mahnitur, sikur nuk i besonin atij çasti, dhe pastaj, thirrje, gëzim, lot. Plaku i Kolës më mbërtheu krahun, i heshtur e i përbajtur si gjithnjë. Po të tjerët qanin nga gëzimi. Plaku më tha: «Kur s'më kanë dalë lot sot, kurr, hej, njiherë në jetën teme s'kam me kja».

Adriatiku dëgjon i heshtur. Kujtimi është i mllëngjyer. Ai më shtrëngon dorën.

Ruga éshtë bërë më e ngushtë dhe më e rrezikshme, megjithëse shyta ecën me zinxhirë. Shytën e tärheq pesha e mezi lëviz. Qafa nga po kalojmë éshtë e hapur dhe suferina luan një valle të çmendur e të zemëruar.

Ne vemë re se Hysua éshtë i shqetësuar. Mbi ballin e tij mendimet tendosen. Por kjo zgjat vetëm një çast. Hysua vendos. Frenon. Hap derën dhe na thotë:

— Dalim të kontollojmë udhën.

Ai hidhet i pari nga shyta. Era me dëborë na përplaset me tärbim në fytyrë, sikur do të na hyjë kudo. Rreth nesh ngrihen pirgje dëbore dhe shtëllunga që të pengojnë të shohësh. Hysua përkulet mbi dëborë për të gjetur gjurmët e udhës së humbur. Kérkon dhe duket se mendon: «Ura éshtë e vogël. Shtresa e akullit, e trashë. Dëkora mbulon si mjergull gjithë rrugën. Një pakujdesi e vogël, dhe e gjithë kjo ngarkesë e çmueshme përfundon në humnerë». Ai vështron vjedhurazi nga ne. Diç murmurit. Nuk do të na frikësojë.

Ne shkelim një copë herë mbi dëborë. E kalojmë urën me kujdes duke sheshuar pirgjet e dëborës, nën zukatjen e fluturave të akullta, që luajnë një valle të egër para syve tanë.

— Më prisni këtu! — thërret papritur Hysua. Zëri i tij mezi dëgjohet nga era. — Kini kujdes, mbështetuni pas shkëmbit! Kështu mund të orientoheni më mirë.

Hunda e shytës duket nëpër mjergullën e lëvizshme të fluturave të dëborës si një përbindsh i madh, i fuqishëm që hungron dhe kafshon me zemërim udhën.

Hysua hap derën.

Mbi ballë i shkëlqejnë bulat të mëdha djerse.

— Kaloi dhe kjo — thotë ai.

Nisemi përsëri. Jemi futur thellë në malësi. Përpara nuk ka veç male, e male me një takije të bardhë. Si kici i një vaporit kolos zgjat hundën një thep shkëmbor.

Marr frymë thellë. Ajri éshtë i ftohtë. I mprehtë

si teh thike. Ai sjell me vetë erën e majave dhe të shkrepave. Kthej kokën. Kujtimi mban bishtin e cigares në qoshe të buzëve.

Vështrimet tona kryqëzohen dhe flasin.

Ul sytë. I nGRE përsëri. Një nënqeshje e lehtë e gazzmore vallëzon në sytë e kthjellët të Kujtimit. Fërkoj duart. Më mërdhijnë majat e gishtave. Ai më zgjat dorëzat. Janë ende të ngrrohta. Duart e mia thua jse humbasin në to.

Rruga drejt hidrocentralit shkon buzë lumi. Ujët rrukulliset me vrull në fund të lumit zemërak. As që shikoj më nga rruga. Dua të gjej një mendim të ri, të bukur për të filluar një bisedë, po më ka tronditur mëgina dhe më vjen rrötull çdo gjë.

— Ke frikë, Mira?

— Aspak.

— Je penduar që u nisëm në një mot të tillë?

— Pse të pendohem! Ju udhëtoni gjithnjë në këtë udhë.

— Edhe pak, thua jse arritëm, dhe do të shohësh kantierin, — thotë Hyseni.

— E shikon urën? Kjo është një urë gjigante — thotë Kujtimi.

As që e merrja me mend si mund të ishin rrugët, barakat dhe ndërtesat e reja. Në të vërtetë ato ishin të shpërndara aty këtu dhe të mbuluara nga dëbora. Nga larg, gryka e tunelit dukej si hyrja e një piramide gjigante.

— Qyteti im, po të pret në festë, — thotë Kujtimi.

— Vërtet! Paska shumë njerëz!

— Ndërrohen turnet. Kemi ardhur në kohë, — ia pret Hyseni. Ju sot do të vini patjetër tek unë. Gruaja ime do të gëzohet.

Kujtimi hap derën dhe më zgjat dorën. Na rrethojnë menjëherë punëtorë të veshur më rroba të trasha, qizme dhe kapota meshini. Shikojnë me kuresh-tje dhe pak vëngër nga unë.

— Si duket, këtu ka shumë pak gra — përshpërit Adriatiku.

— Megjithatë kemi gra të guximshme. E di që kemi edhe një minatore? Historia e saj është interesante e do ju a tregoj, — thotë Kujtimi.

Më janë mpirë gjymtirët. Duart i kam akull. Më buçasin veshët ende.

Po Kujtimi më shqetëson më shumë se vështrimet kureshtare të punëtorëve. E kuptoj menjëherë se me këtë trup të vogël që kam nuk ua mbush syrin. Kujtimi më njeh me punëtorët: «e fejuara ime». Në fillim më vjen turp. Zgjas dorën në një mënyrë të parvetëdijskime. E shoh si më peshojnë mirë e mirë. Megjithatë, përpinqem të buzëqesh. Duket Kujtimi u thottë, që dëshiroj të shoh tunelin. Më ther sidomos shpotia e hapur e njerit, një punëtori me fytyrë të djegur. «Kjo të futet në tunel? Po kjo i ka ende buzët me qumësh!».

Kujtimi flet me shokët e tij. Tronditem më shumë nga ai vetë. Nuk është më ai djali i drojtur, që shikonte skicat e projektit tim. Ata e rrëmbyen në mes tyre dhe mua nuk më venë re fare. Tashti, thuajse më harruan që jam këtu. Bisedimi ndërpritet herë pas here nga punëtori i gjatë me fytyrën e djegur, që lëviz vazhdëmisht duart e tij të mëdha.

Pas një copë here, ndërsa kemi qëndruar në hyrje të një barange, dëgjoj që flasin për tunelin, për argjinaturat. Kujtimi shkëputet dhe më afrohet. Me sa duket, ai më vë re sa e brishtë dhe e mjerë dukem pranë tyre. Skuqet. Murmurit nëpër dhëmbë një fjalë, që ngjan me «më fal».

Më vjen të rrëmbej krahun muskuloz të Kujtimit dhe të mbështetem pas tij.

— Shokët e tu nuk kanë besim tek unë! — i them.

— Ti s'i njeh njerëzit e thjeshtë! Ti ke lexuar vetëm nëpër libra për ta. Përse mendon ashtu?

— Ai me fytyrë të djegur më shikonte me inat.

— Kozmai? Ti nuk e di sa i do njerëzit ai. Është

një djalosh i rrallë. Nuk ka lindur me atë fytyrë ash-tu. U gjyntua para dy muajsh, por shokët, ama, i shpëtoi. Ai bile ia ndreqi samarin edhe shokut të tij më të ngushtë, sepse e ngacmonte dhë tallej me minatoren tonë.

### III

— Duhet të shpejtojmë — u vonuam — tha Kuj-mi.

Që në fakultet ne i kishim ndjekur me interes punimet për hapjen e tunelit pranë digës qëndrore. Në këtë tunel do të kalojnë ujrat e rrëmbyera të Dri-nit dhe kështu do të shpejtohen punimet e digës. Më vonë, kur gjithë ajo luginë do të përmbytet dhe të kri-johet liqeni dhe diga, tuneli do të shërbejë për të derdhur ujrat e tepërtë.

Kujtimi nxitohet, vishet. Edhe unë vesh një palë rroba minatori e humb në to. Ngjesh kapelen me një sy si të qiklopëve, dhe bashkë me shokët çajmë rrugën drejt zgavrës së tunelit. Do të përfundojë tuneli. Do t'i shkëputet malit një nerv që i dhemb shumë! Prandaj shkëmbi është i zemëruar, i zymtë dhe aspak mikpritës.

Kujtimi dhe shokët e tij ecin përpara. Llamba me karbit kërcet sikur do të shuhet. Nën atë tunel me përmasa gjigante njerëzit duken të vegjël.

Kujtimi dhe shokët janë të sigurtë në punën e tyre. Këtë e dija që në fakultet dhe e ndjeva këtu menjëherë, nga mënyra se si punojnë dhe ecin përpara të gjithë.

«Mirë, shumë mirë» më pëshpërit Kujtimi.

Vazhdojmë rrugën.

Dëgjohet zhurma e pistoletave që vjen si një gjëmim i largët.

«Kujdes, Mira kujdes! Mos e hiq kapelen».

Ecja kudo pas tyre. Ndrek rrezet që lëshon lla-

mba e karbitit, dridhjet e duarve të këtyre burrave të hekurt, që e kanë brejtur aq trimërisht shkëmbin.

Kujtimi ecën nëpër labirintin e njohur, thua jse familjar për të. Armatura është e fortë. Ai e shikon dhe i heton me kujdes të gjitha pjesët e tunelit, i prek me duar si mjeku që kërkon të dijë çdo çast gjendjen e pacientit të tij. Ne shpejtojmë. Ndjejmë gëzim që jemi në mes të shokëve. E kuptoj përsë vraponte Kujtimi, që të ishte pranë njerëzve të tij. Nuk i mbaj më inat, për atë çastin e parë të mbërritjes sonë! S'më vjen keq për buzëqeshjen ironike që u ndjehej kur shikonin duart e mia të holla. Nuk më shtie më frikë fytyra e djegur dhe pa qerpikë e Kozmait. Ai është përgjegjës i turnit. Pistoleta e tij çan zemrën e malit.

Po. Pistoletat rënkojnë me zemërim.

Kujtimi përgjon. Ai i njeh të gjitha goditjet, si muzikanti nuancat e notave. E di që po shkurtohen distancat. Tashti ka mbetur vetëm një shtresë e hollë, ndërmjet njerëz dhe tjetrës anë të tunelit.

... Një gjëmim i shurdhër lëkund edhe nervat më të imta të këtij shkëmbi vigan. Rrëzohen gurët e fundit. Ciflat e mprehta bien në fytyrat dhe në trupat e minatorëve. Djersët u kanë rjedhur çurkë. Nuk mund të dallohet asgjë në fytyrat e tyre si maska të zeza. Vetëm unë mund të shoh sytë e Kujtimit, të kaltër dhe të thellë si qielli. Ata shëndrisin me një vezullim èndërrues. «Më në fund... shokë».

Të gjithë janë të mallëngjyer.

— U hodh një hap. Një hap i sigurtë, — pëshpërit Kujtimi.

Ndërsa dëbora ka pushtuar kantierin.

\* \* \*

— Gruaja ime ka turnin e natës, — thotë Hyseni.

— Shkojmë në klub, njësoj është.

— Ju jeni sonte tek unë — thotë përsëri ai, — qoftë edhe në klub.

— Lëri, kavalierllëqet, Hyso.  
— Mira, nusja jonë, — vazhdon ai duke qeshur.  
Mos u mërzite nga djemtë që të vërenin me kujdes?

— Jo.

— E shikon, — vazhdon ai. — Djemtë tanë janë vërtet heronj. Ata s'pyesin as pér shi dhe as pér dëborë. Punojnë me orë të zgjatura. Këndej nga ne nuk ka kufi midis natës dhe ditës. Lodhen. Po nuk ankohen kurrë. Pastaj vijnë këtu në klub.

— C'do të porositni?

— Ne kemi një kino-club që na e kanë zili edhe qytetet e mëdha. Po edhe ne një qytet jemi. E di me sa banorë?

— Pesëmijë — i them unë duke qeshur.

— Bravo nuse, dukesh. që s'je vajzë mamaKE.  
Pastaj Hysua ndërron bisedë.

— Para disa kohësh dola në pyll me fëmijët. Pylli është larg. Ata thërrisin të gëzuar: «Sa bukur, sa bukur!» Premë një bredh, që s'patëm nevojë ta zbuluronim me pambuk. Kështu e pregetitëm pemën e Vtit të ri dhe e vendosëm jashtë, te dera e shtëpisë. Fëmijët menduan që kjo do të ishte një gjë shumë e bukur, një e papritur që do ta çudiste gruan kur të kthehej nga puna.

Adriatiku e vëren një copë herë Hysenin, sikur do të kuptojë përsë ka kaq krenari në zërin e Hysos, kur thotë «gruaja».

...Kur ishin ende nxënës shkolle, shumë vjet më parë, Hysya kishte qenë shoku më energjik i grupit të tyre. Ai i tërhiqte që të gjithë me mendimet e tij, me karakterin e tij të ciltër. Hysua i flakte mendimet e tij si copëza shkëmbi të këputura që nuk zinin njëri nën vete; ato ngjallnin diskutime nëpër dhomat e ftohta, dhe gjithnjë rrëmujë të konvikteve. Atëhere e quanin njeri sensacional dhe ai mbeti i tillë pér të gjithë, sidomos kur u hodh vullnetarisht në jetën e kantierit. Vetëm atë e quante jetë të vërtetë. Për këtë ndonjë e quajti tuaf, kokëkrisur, sidomos kur pas di-

sa kohësh u muar vesh që ishte martuar me vejushën me dy fëmijë të një minatori, që kishte vdekur duke luftuar për mbrojtjen e hidrocentralit. Ndonjëri e quajti edhe «dado fëmijësh» dhe «pa mend në kokë», sepse socializmi mund të ndërtohej edhe në qoftë se ai nuk vraponte çadër më çadër e kantier më kantier si nomad.

— Je me fat ti, Adriatik vëllai. Ta fillosh jetën në kantier në këtë kohë, duhet të kesh lindur me këmishë — thotë Hysua.

Adriatikut i bien këto fjalë si fshikullimë. Rri i vrenjtur e i menduar.

— Edhe pak e do të fillojë shfaqja. Shokët po na presin. U gëzuan kur morën vesh se do të vije midis resh.

— Vërtet? — pyet Adriatiku dhe ngrihet në këmbë me rrëmbim.

— Ç'pate?

— Asgjë, u mpiva.

Hysua nxjerr llullën.

— Ma ndez pak?

— Ti, sigurisht, dole vullnetar — thotë përsëri Hyseni.

Adriatiku kafshon bishtin e cigares.

— Jo! Më transferuan.

— Epo mirë, ç'më rri kështu i menduar o derëbardhë, kaq shpejt të morri malli për gruan? — bën shaka Hyseni...

— Këtu kemi një trupë estrade të mrekullueshme — ndërron bisedë Kujtimi.

\* \* \*

Dalim nga estrada të lehtë, të gëzuar. Qeshëm aq shumë sa na dhëmbën brinjët. Estrada e kantierit kishte vërtet një ngjyrë të re, të freskët, jetësore. Jashtë dëbora bie e hollë dhe transparente si kristal. Ne ecim pranë njëri-tjetrit. E ndjejmë komunikimin e mendi-

meve dhe ndjenjave pa folur asnë fjälë. Mbahem pas krahut të Kujtimit dhe kam një dëshirë të pakufishme të hap krahët dhe të pushtoj gjithësinë... E ndjej zemrën të mbushur me dashuri.

Dëbora bie e qetë, duke formuar një shtressë të bütë.

Ngjitemi në taracën e drejtorisë së kantierit. Kujtimi më rregullon mos më lagen flokët, megjithëse flutrat e dëborës bëhen më të rralla.

Para nesh shtrihet kantieri. Dritat e vinçave dhe sektorëve të punimeve duken fantastike nëpërmjet rrjetës së dëborës. Dritat vallëzojnë si mbi një dantellë të **qëndisur me yje**. **Kantieri ngrihet pa anë, pa formë, po megjithatë i fuqishëm** dhe madhështor, që nga balli i tunelit, që së shpejti fillon armaturën, e deri te lumi që duket si një gjarpër i zi zemërak, që ha pa pushim flutra dëbore.

Rrimë të heshtur, me dashurinë tonë. Çdo fjälë është e tepërt.

E përse të flasësh, kur ka edhe heshtje që flet?

— Mira!

Kthehem nga Kujtimi. Sytë e tij janë zmadhuar dhe duken si të lagur me lot. Ai më mban duart. M'i fut në pallton e tij që të m'i ngrohë. Dhe unë ndjej, që më pëershkon si një rrymë elektrike deri në pjesët më të imta të organizmit, ngrohtësia e ndjenjës së vërtetë.

— Kthehem!

Dëbora pushoi papritur.

— Mira, e kam vështirë të jetoj larg teje!

Sa i dashur dhe tingëllues më duket ky zë, në këtë getësi të bardhë.

— Po e kam po aq vështirë të jetoj edhe larg kantierit.

— E di, Kujtim. I di të gjitha. Më mirë mos fol. Shiko sa bukur!

Para nesh kantieri ngrihet nëpër mjergull si një statujë vigane, e bardhë e shëndritshme. Ai zgjon me vrullin e tij dremitjen e netëve dhe çdo ditë lartohet drejt qiellit të rimtë, drejt të ardhmes.

\* \* \*

— Ja kjo është shtëpia jonë. Këtë dhuratë na e kanë bërë shokët... — thotë Kujtimi dhe hap derën.

Mbetëm një sekondë të nemitur. Nuk bëmë asnjë hap përpara. Dhoma është e thjeshtë. E ngrohtë. Ndalem para saj. Më janë vrarë sytë nga drita dhe nuk dalloj ende mirë sendet. Kujtimi më tërheq për dore. Tashti dalloj qartë, edhe pejsazhin e rreptë prapa drifatëres pa perde, edhe fotografinë e madhe, në murin përballë.

Është fotografia ime. Kisha dalë para disa vjetesh në kopertinën e një reviste. Po kjo nuk ishte e këputur nga revista.

— Jam amator fotografish, — thotë Kujtimi shpejt, duke iu marrë goja. — E kam larë në laboratorin tonë. Të pëlqen?

#### IV

«Si Oso Kuka në Vraninë», thotë Shpresa duke u tallur. E thotë herë pas here.

Kemi disa kohë që jemi mbyllur me projektin. Shpresa rri shtrirë që të mos humbasë energji. Bëj ecë e jakë nëpër dhomë që të çlodhem. Një orë na ndau nga mbrojtja e diplomave. I hedh një sy rrëmujës së dhomës. Librat e fundit janë shpërndarë nëpër krevat dhe tavolinë. Shpresa më shikon me bisht të syrit, po nuk e ka mendjen fare se ç' them unë.

— Ç'dreqin ke që shkruan aq shumë në atë fletore?

— Ti ke thënë se të pëlqejnë projektet e reja. Duhet t'i mbrojmë pa na u marrë goja.

— Sigurisht. Po jo t'i jap në provim... — Sa më ka marrë uria! Shiko njëherë në dollap, a ka ndonjë gjë për të ngrënë?

— Zbrit të hash!

— I treta të gjitha rezervat. Më vjen keq për ty,

Mira. S'ke se ç'të humbasësh veç «zinxhirëve» të kurtizit.

Dëgjojmë hapat energjike dhe të njobura të Petriti...

— Petriti!

— Përse u trondite Shpresa?

— Erdhi ndihma e shpejtë. Tashti shpëtuam nga uria. Vrapo Mira! Hap derën!

— Ç'jeni bërë kështu? Sytë pa larë, flokët pa krehur... Ama u dorëzuat me një projekt.

— Na u sos durimi — thotë Shpresa.

— Nga frika e provimit! Ti e hodhe lumin...

— Shpresa turret e para. Shtron me shpejtësi tavolinët me sendet, që ka sjellë ai dhe fillon të hajë.

Petriti ulet në karrigën e vetme që kemi. Qesh me të madhe...

— Shiko, Shpresën! Si të uriturit e Xhek Londonit.

— Tamam. Veç nuk po më ndjekin ujqit.

— Petrit, shiko njëherë ç'kemi katranosur... — i them unë.

— Sa kalama që je! Po pse Petriti profesor është? Ai qesh.

— Shpresa është mëndjemadhe, nuk pranon kritika.

— Na thuaj Petrit ç'bëhet jashtë?

— Mbajnë zi!

— Sa të mbarojmë ne provimin, ë?

— Po. Vuajnë shumë nga mungesa juaj!

— Na thuaj të vërtetën.

— Kujtimi do të kthehet nesër. E ka marrë malli për Mirën. Përse nuk e kini hapur derën e ballkonit? Ju po mykeni fare. Jeni mbyllur si minjtë.

— Kemi frikë nga qielli i kthjellët.

— Nuk më besohet! Ju jeni vajza guximtare.

— Po, po, vetëm se sot... kemi ca frikë.

— Do të vijë një kohë që të gjitha këto do të na duken vogëlsira qesharake... — thotë Petriti dhe hap derën e ballkonit.

Dalim të dyja me një frymë, si të burgosura. Pa-

norama e qytetit lulëzon bashkë me pranverën dhe të ngjall ndjenja të ngrohta, intime. Autobuzët rrëshqasin me shpejtësi. Pranvera është në kulmin e lulëzimit të saj, si një vajzë shtatëmbëdhjetë vjeç. Ka veshur rroben e gjelbër dhe shpërndan erën dehëse të jargavanëve. Kjo të hyn me vrull në shpirt dhe të deh.

Edhe pak minuta na mbetën.

Presim radhën të nemitura. Petriti është më i tronditur se ne. Na porosit mos ta humbasim pusullën. Nga rezultatet e provimeve varet plotësimi i kërkuesës sonë! Në fund të fundit atdheut i duhen inxhierë të zot...

— Sa jeni lodhur dhe dobësuar. Nuk ju shoh dot, me sy të venitur si të një dreri të plagosur... Pa lere pastaj porositë e pafund të Kujtimit për shëndetin e Mirës.

Hymë të trembura në auditorin tonë. Studentët presin si të ngirirë nëpër banga. Komisioni. Rektori.

— Më erdhi radha të paguaj mungesat në leksione — qesh Shpresa.

— Kurajo! Mos u dorëzoni, — thotë Petriti.

Po më kapin ca të dridhura të lehta. Bobo! Po i hedh një sy kalimthi projektit dhe e mbledh veten menjëherë

— Si dukesh Shpresa?

— Më lerë rehat, se mos shpërthej si vullkan.

Shpresa pregetitet shpejt dhe flet përparrë meje... Flet bukur, me bindje.

Radha ime.

Filloj, e drojtur, të mbroj projektin. S'ndalem. Flas me pasion. Dua t'ja mbush mendjen pedagogut për gjérat që më ka mësuar ai vetë.

Në fytyrën e tij të menduar kalon një nënqeshje e lehtë. Diçka i pëshpërit në vesh rektorit. Komisioni i tërë dëgjon me vëmendje. Nuk e di pse më duket sikur aty pranë, fare pranë, është ulur edhe Kujtimi. Ai më vështron me vëmendje. Pranë janë edhe shokët e turnit të tij, Kozmai dhe Hyseni. Ndjeja nevojën të mbështetesha tek ata.

Duart më dridhen. Të gjithë dëgjojnë. Vazhdoj pa u ndaluar. Dua të më dëgjojnë. Të më vënë re. Të ndjejnë, të kuptojnë ëndërrat tona. Sepse ne duam të dimë më shumië, të përqafojmë çdo gjë të re, të bukur, që kanë krijuar njerëzit tanë. Dhe gjithë jetën t'ja falim atyre, edhe rininë, edhe dashurinë, edhe lumturinë.

Dal në koridor, e lodhur. Petriti më shtrëngon dorën me butësi. Shpresa kukuris dhe më pëshpërit:

— Po ti pse nuk i re shkurt?

— Isha frymëzuar. Dhe ndofta diçka do të vlejnë edhe këto projektet tona!

— Sa mirë fole! Sonte do të dëgjojmë sinfoninë tonë të dashur...

Kthej kokën nga Petriti. Ai buzëqesh duke pulitur sytë.

— Vishuni shpejt! Mos vonohemi, — thotë ai.

Vrapojmë për të gjetur taksi, si fëmijët e gjëzuar që s'i vret asnjë brengë.

Në taksi ulemi të tre pranë e pranë. Nuk e di se pse më kujtohet babai. Po nuk i them asnjeriu. Njëherë ai më fliste për krenarinë e një populli të vogël, që e shqelmonin të gjithë. Për ballin e tij të lartë, të përgjakur e të ndritur. Dhe për dëshirën që kishte ai popull i vogël të shkonte përpara, përpara!

Taksia vrapon me shpejtësi, duke lënë prapa ndërtesa, reklama dhe autobusë. Sa shumë njerëz!

Mbështes kokën në supin e Shpresës. Mendoj: Nuk dua të jem më e gjëzuar se kaq.

Shpresa është gjithnjë më praktike se unë. Rrimbështetur në sedile dhe sodit. Petriti luan me flokët e saj të gjatë.

— T'i pres? — thotë ajo.

— Përse do që t'i presësh?

— Të gjitha i prenë! Shiko sa mirë duken, si çuna.

— Po ne nuk duam që vajzat të duken si djem. Më mirë me flokë të gjatë, — thotë Petriti

— Dëgjoni një lajm të gjuar: Shokëve të Komi-  
tetit të Partisë u pëlqeu propozimi ynë. Nesër do të  
shkoj në dekanat...

## V

Sheshi përpara universitetit është bërë si një li-  
qen i mbushur me ujë nga rrëkezat, që zgresin nga  
kodrat përreth tij. Asnjë këmbë njeriu, vetëm ndonjë  
maqinë rrëshqet me shpejtësi. Në çdo gjysëm ore au-  
tobusi del nëpër rrjetën e dendur të shiut.

E q'mund t'i bëjë shiu èndrrës sonë! Èndrrës së  
dritës? Ajo është një pjesë e jetës sonë. Në grupin to-  
në u zhvilluan debate për stilin e ndërtimit. Petriti u  
ngrit mbi ne të gjithë dhe fitoi. Ai na mbértheu me  
logjikën e tij të hekurt që Shpresa e quan «maqinë e  
përsosur».

Përjashta bie shi.

Ne rrimë në auditorin tonë. Gjithë shokët e gru-  
pit presin Petritin.

Shpresa tund këmbën me nervozizëm. Nuk e du-  
roj dot.

— Mjaft kërceve, tashti.

Ajo vazhdon lëvizjen pa kthyer përgjegje, sepse  
s'e ka mendjen aty.

— Petriti po vonohet — thotë.

— Do të vijë. E ka penguar shiu. Përse nuk i dhe  
çadrën tënde — qeshi njëri nga shokët.

— Ju e dini. Èshtë shumë krenar ai dhe s'mund  
të dalë nëpër udhët e kryeqytetit me një çadër grash...  
Po më mirë bisedojmë për diçka tjetër — thotë Shpre-  
sa. — Mira, na trego për hidrocentralin... Për atë  
qytetin e ndërtuar me baraka të drunjta! Dhe për  
Kozmanë, për atë minatorin me fytyrë të djegur, që  
të shikonte me inat. Siç e shihni nuk na presin pallat-  
te të fildishta.

— S'ka gjë. Neve na pëlqen era e drurëve të pyllit...

— ... Hajde Mira na trego. Ti merr përditë letra nga kantieri. Mos i ruan të shkruash ndonjë roman?

U drodha si nga të ftohtit. Vërtet, unë merja letra! Kujtimi më shkruan me hollësi mbi çdo gjë. «Ne i hoqëm sondat e fuqishme të shpimeve të thella. Me-kanikët i pastruan dhe do t'i vendosin në anën tjetër për të vazhduar punimet në digë. Në atë anë lumi zbret me rrëmbim. Duam të mbarojmë pa filluar shirat, sepse ato do të shpëtojnë ujrat e Drinit dhe pastaj duhet t'i masim forcat mirë».

— Nëpër barangë ne do të vimë vonë, të dërmuar nga lodhja dhe nga shirat. Mira, ç'mendohesh? — pyet Shpresa.

— Asgjë.

— Po ne s'kemi frikë nga shirat. Do të ndërtojmë në mes të rrebeshit, do të ngremë argjinatura, do t'i këthejmë qafat e lumejve. Pastaj do të kthehemë në kapanone. Në mes ata do të kenë një fuçi të madhe si shpotret. Përse e përfytyroj kështu kapanonin? Është kështu Mira? — pyet Shpresa.

— Afërsisht.

— Mirë pra. Do të ulemi ballë për ballë me ndërtjonjësit. Unë sigurisht s'do ta lejoj Petritin të më japoë këmishën për ta larë, s'ka fjalë! Punët do të jenë të ndara. Do të rrimë pranë veteranëve të hidrocentraleve. Do të jemi miq me ta. Ata do të na flasin për jetën e tyre, të ashpër e të bukur.

Sa fantazi që ka Shpresa. Unë ende kam në xhep letrën, që mora dje nga hidrocentrali. Ajo ngjan si një shkrepëtimë e largët, si një këngë, si një legjendë.

«Tashti që të shkruaj po zbardh agu, po mua nuk më zë gjumi edhe nga lodhja edhe nga malli edhe nga dashuria. Mira! Letrat e mia janë të rrëmbyera si vërshimet e ujrave të pranverës. Diga qëndrore rrezikohej. Ujrat vërshonin të turbullta, të errëta. Diga kishte mbetur si një trap i madh në mes të ujrave. Ti e di, që duhej t'i ndërronim rrjedhën ujit, pikërisht pranë tu-

nelit, që pamë atë ditë bashkë, të kujtohet? Shirat erdhën papritur dhe mund të na përmbytnin digën, punën dhe mundin tonë, të na shtynin edhe një vit punimet. Ti e ke parë atë grykë ku zhvillohen punimet e digës qëndrore? Ne u sulëm në mes të shiut dhe filloam të hedhim trungje pemësh dhe q'të gjenim përtë krijuar një pengesë që të na jepte mundësi të mbyllnim rrjedhën e lomit. Në ishullin e digës kishim grumbulluar dhë të thërmuar sa një kodër. Shiu binte me rrëshkekë, po uturima e buldozerëve që mbartnin dhe, e eskavatorëve dhe e njerëzve ishte më e fuqishme. Gati njëzet orë u përleshëm pa u ndalur, pa fjetur, pa ngrënë, pa u kujtar pér asgjë përvëç mposhtjes së sulmit të këtij lumi. Ai dukej i frikshëm, si një përbindësh. Ne e sulmonim pa pushim me trungje pemësh pér të krijuar një argjinaturë përballë tunelit që do të lidhët një cektinë zhavori me ishullin e digës, me ishullin lundronjës, që nëpër shi dhe rrebesh, në përplasjen e ujratvet të lomit dukej si një anije akullthyese. Në këtë luftë të pabarabartë ne sulmoheshim nga dy fronte; nga qelli dhe nga lumi! Vetëm kur rrebeshi u ndal dhe zbardhi ditë, pamë se lumi e kishte gërryer edhe një pjesë të pri-tës. Filloi sulmi i fundit! Në krahun tjetër u hodh një skelet metalik dhe vrulli i lomit u ndal. S'patëm kohë të gëzoheshim, kur shpërtheu një rrebesh i ri, ujërat e shtuan shpejtësinë dhjetëfish. Ishim lagur deri në palcë. U vërsulëm përsëri në pritë dhe krijuam një barikadë me gjokset tona. Kjo barikadë e çuditëshme e mposhti përbindëshin. Pas nesh shokët e tjerë hidhnin dhe trungje e gurë. Kështu ja zumë rrugën rrjedhjes.

Tashti lumi kalon buzë tunelit. Kemi edhe një betejë tjetër. Ajo do të fillojë kur t'ja ndryshojmë rrugën ujut dhe ta detyrojmë të futet në tunel. Po atë betejë do ta shikosh vetë me sytë e tu, Mira!

A e di kush ishte gjithë kohën pranë meje? Kozmai dhe minatorja e kantierit tonë!

Shokët u ndërtuan edhe atyre një dhomë me tulla, si e jona. Është njësoj si të kesh një apartament shumë

luksuz. Shokëve të kantierit u pëlqen që nuset tonë, të cilat veshin pantallona dhe mbajnë gozhup me kapelë mushamaje, të kenë një dhomë të ngrohtë ku të rrisin fëmijët. Ndoshta në kantierin tonë do të lindë një fëmijë! A nuk është një gjë e bukur!...»

Nuk e di sa kohë u bë që mbaj ballin mbështetur pas xhamit të auditorit dhe kujtoj ç'më shkruan Kujtimi në letrën e fundit.

Përmendem dhe dëgjoj Shpresën që vazhdon me planet e saj, planet tonë.

— Nëpër rrugë do të mbjellim pemë. Ç'lloj pemësh do të mbjellim?

— Mimoza.

— Shelgje vajtues.

— Gështenja të egra.

— Pisha...

— Unë them më mirë mimoza. Ato janë lajmëtarë të pranverës, ato e përbuzin dimrin.

— Po atje është veri, bën ftohtë. Duhet të mbjellim bredha. Kur të bjerë borë ata do të duken si pemët e Vtitit të ri.

Dëgjoj Shpresën dhe vë buzën në gaz. Sa bukur! Pothuaj kemi harruar se përsë po presim këtu, kemi harruar edhe shiun edhe vetveten.

Shokët përshpërisin me zë të ulët.

Po një valë entuziazmi e ndërpret murmuritjen.

Petriti është mbështetur pas derës. Flokët i kullojnë ujë. Ai është sulur nëpër shi. Shokët e ngrejnë në krahë. Ai qesh dhe thotë: «Ngadalë, bre shokë, se më copëtuan». Pra, e kanë pranuar kërkesën tonë përtë punuar gjithë grupi në hidrocentralin e madh.

— Hë nuse, si thua ti, a nuk është e bukur kur të shpien si krushq shokët e tu? — më pëshpërit Shpresa në vesh.

Jam ndalur para shtëpisë sime. Më presin si miq të vjetër parmakët e ndritur të shkallëve. Dikur edhe unë rrëshqisja nëpër to. Muret janë mbushur përsëri me zhgaravina. Edhe unë posa mësova shkronjat e para përdorja muret për dërrasë të zezë. Të gjitha kanë mbetur njësoj, sikur asgjë s'ka ndryshuar. Të gjitha të njohura deri në imtësi. Po edhe të largëta, të huaja.

Më duket sikur do të zbresë nga shkallët një çap-këne e marrë me flokë të shpupurishura, e me një fustan gjithë njolla, sikur do të dëgjoj zërin qortonjës të nënës sime: «Mira!»...

Rri e mbështetur në parmak. Djersë të ftohta më mbulojnë. Më kujtohet zëri i tim eti:

«Përse u arratise? S'kam bërë ndonjë krim. Ti je vajzë e zgjuar dhe duhet të më kuptosh».

Po tashti kush i zbret këto shkallë?

Dera e koridorit është e hapur. Qëndroj një sekondë e mbështetur pas dorezës. Syri im, i mësuar me të gjitha imtësitë, i kap ndryshimet që kanë ndodhur. Dera e dhomës së bukës është e hapur. E marr me mend se andej ka kaluar im atë. Ai është gjithnjë si i hutuar. I zënë me diçka, e ka zakon t'i lërë dyert hapur.

C'më mban ende të mbërthyer në derë? Unë nuk e njoh mirë gruan e tim eti. Kur e ndeshja në rrugë përpinqesha të mos e vija re. Fanatike në vendimin tim, s'kisha dashur të dëgjoj asgjë të mirë për këtë grua, që kishte hyrë në shtëpinë time, që kishte zënë vendin e nënës sime. E gjithë kjo më dukej e pabesueshme, më dulcej edhe më e pabesueshme që babai të kishte një fëmijë tjetër, dhe aq më tepër që ai ta donte.

Po sigurisht që e donte.

Rri e mbërthyer në derë. Përfytyroj babanë me një foshnjë në duar, të bukur, të shëndoshë, si një bu-

rim i pashterur jetë. Fëmija kap flokët e bardha të tim eti dhe qesh. Kujtimi im më i hershëm i fëminisë është pikërisht i tillë. Edhe unë bëja po kështu. Po atëhere ai kishte flokë të zez, të ndritur dhe pak të lyrshëm.

Po unë, përse jam mbërthyer në vend?

Shokët më presin poshtë në rrugë. Ne do të nisemi. Do të nisemi!

Po përse s'paskam fuqi ta shqelmoj këtë egon time të vogël? Këtë rebelizmin tim të kotë?

Shikoj herë dhomën dhe herë qiellin e kthjellët. Në horizont vozit një re e hollë, e tejdukshme, si një ëndërr. Dhe bota është aq e madhe, aq e kthjellët! A mund të mbetet njeriu i vogël dhe egoist në një qiell kaq të kthjellët dhe të pastër?

«Jo, — them unë me vete, — s'kam pse të tërhiqem si frikacake. Kam ardhur të ftoj babanë në dasmën time!»

## NJË NJERI

Rrija në kabinetin tim. Lexoja me vëmendje studimin e një kirurgu. Nëpërmjet shënimeve doja të merrja me mend jetën e njeriut, që e kishte shkruar, mënyrën e të menduarit dhe fizionominë e tij. Studimi ishte interesant; fliste për operacionin çezarian. S'ngrita kokën nga leximi, as kur u hap dera, megjithëse dëgjova gërvimën e saj të lehtë.

«Duhet vajosur, dhe nuk është nevoja ta ndërpres leximin sa herë që hyjnë e dalin mamitë», mendova.

Vetëm pas një cope herë vura re. Para meje që-ndronte në këmbë një grua e re me një gërshet të verdhë si kurorë rrëth kokës. Njollat bojë kafe në fytyrë, në vend që ta shëmtonin, i jepnin hijeshi. Patjetër më tërhoqi gërsheti i verdhë, sepse ai ishte thuajse i jashtë-zakonshëm për një grua të modës së sotme. Ajo dukej si një vajzë e re, e drojtur, pa asnjë stoli përvèç atij gërsheti. Dëke e parë, ndjeva një çlodhje të çuditshme pas punës me tension të gjithë asaj javë. Papa-ndehur vështrimi im u step. Gruaja i kishte buzet të fryra e pak të mavjosura.

— E keni elektrokardiogramin? — e pyeta.

Gruaja më zgjati një fletë të zverdhur e të vjetëruar. Lexova vetëm emrin. «Vjolleca Mema... punëto-re, kombinat». Nuk doja t'i pranoja zigzaket e çrre-gullta, që më kërcenin para sysh.

— Elektrokardiogramë më të rinj kini?

— Jo.

— Përse s'jeni vizituar më parë në klinikën tonë?

— Më dukej sikur do të ma zmadhonin sëmundjen.

— Vërtet?

«Po tashti? Ç'do të bëjmë me ato buzët e tua cianotike? pyesja veten pa e ndarë vështrimin nga ftyra e hequr e gruas. — Me këto zigzaqe të çakërdisura të zemrës nuk i shpëtojmë dot «zmadhimit» të sëmundjes. «Megjithëse jam këtu që të të shpëtoj, një gjendje e tillë më shqetëson».

— A do ta shoh të paktën një herë fëmijën? — pyeti gruaja, me një zë të ulët gati duke pëshpëritur.

Në atë fill zëri kishte edhe frikë edhe shpresë edhe guxim.

— Patjetër do ta shikoni fëmijën dhe jo vetëm një herë!

— Ka disa vjet që e pres këtë foshnjë!

— Në observacion — urdhërova.

Bardha, mama, që deri atëhere më kishte ndjekur me vërejtje, mori gruan dhe doli.

U ktheva nga dritarja dhe po ndiqja pa e pasur mendjen çap e jakun e shqetësuar të një burri me trup të vogël. E mora menjëherë me mend. Ai duhej të ishte burri i saj. Nuk më ngacmonin më diskutimet e zjarrrta të studentëve të mijekësisë në dhomën përbri. Më parë i dëgjoja dhe vija buzën në gaz.

Të gjithë qënjen time e rrëmbeu gruaja me zërin e butë dhe vështrimin pyetës.

Muzgu zbriti ngadalë i përgjumur. Në qellin e përhimtë qëndronte ende një brez i kuqërremptë si në manushaqe. Isha e shqetësuar për gjendjen e gruas! Nuk mund të qëndroja në një vend.

Dola në koridor dhe e ndoqa pas gruan duke kujtuar se si i shkrepi ajo shkëndijë gëzimi, si u ndriçuan të gjitha tiparet e saj, apo dëgjoi që do ta shihte fëmijën. A thua e dinte ç'e priste? A e diinte ajo që çapet e saj të vogla shkonin krah vdekjes kaq thjesht, sikur luanin me të?

E veshur me këmishën e bardhë të maternitetit, gruaja ngjiste shkallët. Doja të kuptoja mendimin e saj! C'mendonte, për shkallët që po i ngjiste vetë dhe që do t'i zbriste së bashku me fëmijën në krahë? Apo për atë burrin e shkurtër, që e priste në trotuar? Ajo ecte para meje. Pashë si u step. U ndal pranë derës së paralindjes.

— Bardha, — thashë unë, — shkon përparrë!

Mamia e tërhoqi gruan për dore. Nuk doja që të shikonte dhomën e paralindjes, sepse e dija sa përshtypje mund të lerë te një grua e re, që as e ka marrë me mend këtë dhomë. Urdhërova ta veçonin të sémurën në një kthinë të qetë. Atje kishim vetëm një të shtruar, që kish albuminë të theksuar dhe e mbanim nën kontroll.

Gruaja më vështroi gjatë, e hutuar, sikur donte të më pyeste. Edhe unë e kuptova menjëherë atë që mendonte ajo me vështrimin e ngulur mbi hekurat e ndritura të kokës së krevatit. Ne i lyenim çdo vit me ngjyrë të bardhë, po prapëseprapë ato mbeteshin ashëtu të palyera, përfjetësisht të ndritura nga fërkimi i duarve të nënave. Hekura të ndritura! Dëshmi e hesh-tur e dhëmbjes dhe e guximit. Sikur të mund të fliste gruaja, do të thoshte me zë të lartë, ndofta me një zë kumbues dhe të ëmbël:

— Dashuria e nënës për fëmijën kalon provën e këtyre dhomave, prandaj ajo është edhe dhimbje edhe dashuri.

— Doktoreshë, mund të flas... pak?... — pyeti gruaja.

— Sigurisht.

Ajo hapi dritaren. Mugëtira e vakët e mbrëmjes nuk e pengonte të dallonte trupin nervoz dhe energjik të të shoqit.

— Shko, unë jam shumë mirë... Ti sonte ke tur-nin e natës.

— Ehu, përsë bëhesh merak! Thuaj, vërtet, si je?

-- Mirë... Nisu de!

— Nesër në mëngjez, mirë u pafshim...

Gruaja u kthye nga unë.

— Nesër është ditë e gëzuar, apo jo, doktoreshë?

Unë vëreja e shqetësuar të gjitha lëvizjet e saj. E dija që kish dhimbje të lehta, po s'donte ta jepte veten. Dhe mbahej aq mirë, sa më çudiste me forcën

~~the guximin e saj!~~ A është e mundur të mos e shpëtosh një njeri të tillë? E dija që ajo kishte ardhur tek *ne, sepse e donte* shumë atë fëmijë, që sapo i kish ndjerë lëvizjet e para, ashtu siç donte gjithshka, që e rrëthonte; ajo donte çdo hap të nxituar që bënte burri i shkurtër, kur kthehej nga turni, çdo fije floku të zi që linte ai mbi këllëfin e bardhë të jastëkut, çdo tingull gazmor, që lëshonin fëmijët, kur luanin në sheshin pranë shtëpisë së saj, sepse të gjitha këto përbënин atë gjë të mahnitshme dhe të shkëlqver që quhet jetë.

Gruaja u mbështet pas hekurave të krevatit dhe lëshoi një rënkim të lehtë.

«Filloi» mendova, «po fillon beteja e vërtetë...»

— Doktoreshë, po më zihet fryma... Nuk do ta shoh dot fëmijën...? — pëshpëriti lehtë. Dhe mua m'u duk si një gjethje, që do të shkëputet dhe do të bjerë e lodhur.

— Ju, që jeni kaq trime, po trembeni kot — thashë nëpër dhëmbë, duke u munduar ta largoja përfytyrimin e gjethes së tharë... Po ajo ishte aq e zbetë!

Gruaja vuri buzën në gaz me hidhërim.

— Më falni... tha — ... po nganjëherë vërtet më zihet fare fryma...

Ndiqja mendimet e saj si të shkruara mbi ballë, që luftonin njëri-tjetrin. Ajo më pa me sytë e inë-dhenj të shkruar dhe unë sikur lexova:

«Pse, kaq lehtë mund të vdesë njeriu?»

«Shumë mirë... Kështu duhet menduar...» thashë me vete.

Mamia dhe sanitarja sollën bombolën e oksigje-

nit, pikërisht në çastin që duhej. Gruaja filloi të humbiste ndjenjat. Nuk lëvizja nga dhoma. E dija se si do të zhvilloheshin ngjarjet. Ajo ishte zverdhur nga dhëmbjet, që po i shpeshoheshin.

— Nuk shoh... Nuk do ta shoh dot as foshnjën time... — tha. Ne u përpoqëm t'i jepnim të gjitha lehtësitë, që të kishte një lindje normale. Bënim ç'ish-te e mundur që të mos i humbiste ndjenjat. Humbja e ndjenjave ishte shumë e rrezikshme për atë çast. Mua më ishte tharë djersa në ballë dhe kisha të ftohtë nga tronditja. Nga ana tjetër, shikoja se si filloi të venitej drita e syve të saj. Ajo po e shikonte tur-bull çdo gjë, që e rrëthonte. Djersë të ftohta i binin mbi ballë. Pale frymëmarrja! Gruaja u murrëtye si nga të ftohtit. Edhe zemra ime u ftoh dhe ngriu fare.

— Nuk shoh, nuk do ta shoh dot foshnjën! — pëshpëriti edhe një herë gruaja... dhe nuk u ndie më, sepse humbi për një kohë të gjatë. Edhe unë mbeta një çast, një çast që ndoshta ishte më i vështiri i jetës sime.

Nuk ishte hera e parë që përlleshesh me hijen e vdekjes. Ajo hynte tinëzisht nëpër sallat e operacionit dhe përgjonte çdo lëvizje të skalpelit tim. Luftoja me gjithë shpirt, sepse nuk doja të lëshoja as një fije flaku. Edhe njeriu vetë nuk dorëzohej aqë lehtë!

Po gruaja ishte nderë para mëje dhe unë me të shpejtë thashë:

— Në sallën e operacionit.

Megjithatë isha në një mëdyshje torturonjëse! A do t'i qëndronte vallë zemra e saj provës së rëndë të operacionit? Doja ta shpëtoja gruan me çdo kusht, dhe isha gjithë zemërim ndaj vetes dhe mjekësisë, që s'mund ta ndalonte vdekjen e parakohëshme, që s'mund ta zgjaste edhe disa dhjetëra vjet jetën e njeriut!

Ndjeja dhimbje të vërtetë fizike, kur dëgjoja frymëmarrjen e çrrëgullt të gruas. E quaja veten fajtore. Po, fajtore...

Heshtja kish mbetur pezull apo më dukej vetëm

mua? Jo... Bile edhe nënave të tjera u vinte keq të ngri-nin zërin se mos e shqetësonin gruan.

Gjithnjë, kur nishesha për të operuar, i flakja mendimet dhe lëkundjet prapa derës. Hyja e sigurt. Vetëm damari që më rrihte ngadalë mbi tëmtha, si tiktaku i një sahati, tregonte shqetësim. Thellë në veten time vetëdija e përbuzte vdekjen.

Skalpeli punonte në heshtje, në qetësi, saktë. Pre-ka trupin e njomë ngjyrë trëndafili të foshnjës. E pashë vetëm kur përpërlejë në duart e mameve të shqetësuara që nuk po e dëgjonin klithmën e tij. Vazhdoja të qepja plagëën e operacionit çezarian. Filluan të më vërshonin mendime të ngrrohta dhe të gëzuara, sikur ishin çliruar nga zgjedha e rëndë e vdekjes. Dhe e kuptova. E kisha kryer punën time. Klithma e parë e foshnjës!... Atë s'e dëgjoi nëna, po unë. Nëna s'ishte akoma në vete. Megjithëse e shqetësuar, vura buzën në gaz. Përshëndetja e njeriut. Në klithmën e tij kishte gëzim. Gëzim dhe shpresë. Ai thoshte pa drojtje:

«Mirësetëgjej, jetë. Mirësetëgjej...»

Atë qast pata një dëshirë: të çikja duart e njoma të foshnjës. Po nuk kisha kohë. Isha në ankth. Prisja t'i dilte narkoza nënës dhe mbaja në dorë pulsin që mezi ndihej. Sa të gjata dhe torturonjëse m'u dukën ato sekonda! Sa do të qëndronte gruaja në këtë «gjumë»?... Oh, vërtet... ta zemë se nëna është e lodhur... po fle... Ky mendim më erdhi papandehur. Doja të besoja që rrreziku kish kaluar, që ajo jo vetëm flinte, po shikonte edhe èndërr.

Ndjeva pulsin, që filloj të normalizohej. Nuk e di përsë më merrej fryma. Ndofta nga lodhja, ndofta nga tronditja. Kush pandeh se mjekët nuk kalojnë në-për emocionet më të forta dhe më tronditëse, i quan ata zanatçinj të thjeshtë e të ftohtë!

Gruaja, shumë e dobët, dha shenjat e para të jetës... Ajo u përpoq të lëvizte qepallat. Po unë e dija se nuk do të arrinte dot menjëherë t'i lëvizte, sepse ato akoma i rëndonin si plumb. Ndofta e para ndjesi

ishte rryma e ajrit që shkonte pa pushim dhe i lehtësonte frymëmarrjen.

I hapi sytë? E dija që rrëth saj ishte akoma mje-gull. Mezi mundi të lëvizte dorën. Dhe menjëherë provoi a e kishte fëmijën.

Ne e kuptuam. Mamia mori foshnjën dhe ja vuri në krah. Ndofta kjo rrymë jete, që përshkoi si shkëndijë elektrike gjithë qënjen e saj, kur provoi ngrohtësinë e trupit të foshnjës, ishte më e fortë se çdo ndihmë tjetër mjekësore! Gruaja u përpoq të ngrinte krahun dhe ta prekte. Po nuk lëvizi dot asnje muskul.

Filloi të shikonte më qartë. E pa fëmijën! U përpooq të buzëqeshite. E mahniti ngjyra e purpurtë dhe pushi i butë, që mbulonte fytyrën e foshnjës. Ndofta s'i besohej se ajo krijesë aq e vogël mund ta fuste në vallen e vdekjes...

Mamia mori fëmijën dhe doli.

Gruaja nuk arriti ta pyeste se ç'ishte djalë apo vajzë. Po ç'rëndësi kishte? Ajo ishte gjallë dhe kishte sjellë në jetë një njeri.

## FUSTANI NAJLON

Nëna ime ishte ende e re. Gërsheetat gjysmë të thinjura i lidhte prapa kokës. Sytë bojë ulliri si në gri kishin një vështrim të vendosur. Që e vogël e mbaja mend gjithnjë të veshur me rrobat e zeza të vejushës. Duart i mbanin erë jodio si të gjitha infermiereve. Në shtepinë tonë të vogëljeta rriddhete e qetë. Nëna ishte gjithnjë e zënë me punë. Nganjëherë nuk e shihnim njëra-tjetrën me ditë të téra. Por kur kthehej ajo, në çfarëdo ore që të vinte, do të kalonte patjetër nga dhoma ime. Vinte pa fjalë. Në ballë i shtrihej një rrudhë e thellë. Ajo hidhte sytë nga tavolina dhe fillonte të rendiste librat që ishin grumbulluar atje parregull. Shpesh më gjente të zhytur në punë, pér të preqatitur ndonjë referat, ose duke u marrë me problemet e aritmetikës racionale. Unë ngrija kokën dhe e shikoja. Menjëherë e ndjeja se sa e shtrenjtë ishte pér mua ajo grua me flokë të thinjur dhe sa, shumë e mbushte me dashuri jetën time. Jeta e saj kishte qenë e zyrtë dhe pa gëzime, si jeta e çdo gruaje, që i vdes burri dhe e lë të re. Duhej të jetonte vetëm sepse kishte detyrën e nënës, detyrën e familjes. Jeta e saj u ngjante atyre gjetheve të zverdhura, që bien e i japid ushqim tokës. Gruaja po lindi fëmijë s'jeton më pér vete, jeta e saj u takon të tjerëve. Kështu kishte kaluar jeta e nënës sime.

Nganjëherë doja t'i thërrisja nënës, t'i thoja se duhej të bënte një jetë më të gëzuar, të ishte më e gjallë,

më e qeshur. Rinia ime kërkonte gëzim e buzëqeshje përreth. Kurse nëna ishte gjithnjë e mërzitur, dhe në këtë çështje ajo kishte pikëpamjet e saj të ngurta dhe të pandryshueshme. Nuk arrinte të kuptonte se cili mund të ishte gëzimi dhe lumturia e saj, përveç meje. Jetonte vetëm për mua. Unë ja merrja dorën e lodhur dhe ja mbaja ndërmjet duarve të mia.

Pastaj filloja t'i tregoja ndonjë gjë për të qeshur. Ajo bënte buzën në gaz. Sa më pëlqente kur çlodhej pranë meje! Më lëmonte ballin, fuste gishtërinjtë e saj si kreher në flokët e mi, pastaj pëshpëriste «natën e mirë nusja ime». Sa rëndësi i jepte së ardhmes sime!

\* \* \*

Një natë nëna hyri duke përplasur çizmet. Mbylli çadrën. Dëgjova ujin që rriddhe në koridor. Ajo kishte qenë roje nate me Fredin, të fejuarin tim. Tashti nëna nuk i thotë ashtu kot fjalët «natën e mirë nusja ime».

— U lage mama?

— Jo, erdha më autobus.

Dukej nga zëri që ishte bërë nervoze. Dhe unë e kuptova se ajo do të fillonte që të më qortonte. Sapo u dha te dera, u drodha. Ishte e lodhur. Po unë nuk kisha më dëshirë për shakara si dikur. Ajo erdhi dhe u ul pranë meje duke fshirë flokët e lagur. Dukej e trondituri. S'ishte mësuar ta kundërshtoja, kurrë. Çdo dëshirë e saj kishte qenë ligj për mua.

Po prej disa kohësh, e përse ta fsheh, që kur jam fejuar me Fredin, apo mbetëm vetëm, ulur përbimi kanapenë e dhomës sonë më lindin lloj-lloj mendimesh. Shporetë më duket se është vjetëruar shumë dhe sikur e ka humbur ngjyrën. Shtrati i nënës mbuluar me kuvrtë të bardhë më duket i vettuar dhe jetim. Fotografia e tim eti mbi boro është gati të rrëzohet. Ndërsa unë, sikur jam futur në një valle, symbyllur, dhe nuk jam në gjendje të largohem. Vlij vërdallë duke u tërhequr nga vullneti i papërkulur i nënës sime.

Deri kur do të vazhdojë kjo?

Ndejtäm një copë herë pa folur. Pastaj nëna foli e para:

— Fredi erdhi deri te dera dhe nuk deshte të hynte brënda.

— Ah... por tashti është vonë.

Unë dëshiroja të thosha «shumë mirë», po ula sytë.

— Lejla, ka disa kohë që ti je ftohur nga Fredi.

— Nënë, po ti e di...

— Çfarë të di moj bijë? Çfarë?

— Po unë të thashë. Seç ka ca mendime ai që më largojnë prej tij. Ti e di nënë, ne e kemi biseduar kaq herë.

— A e di që ai mund të mos e harrojë këtë qëndrimin tënd gjatë gjithë jetës? Ai nuk është mësuar kështu si bën ti. Ti po e prish jetën tënde dhe timen. Sa me zor ia arritëm kësaj fejese. Ne jemi njerëz të thjeshtë. Dhe t'i biesh në sy djalit të inxhinierit plak, të kesh një burrë si Fredi, të pashëm, të ri, mjek të zotin dhe djalë studioz, ashtu si të pëlqen ty, nuk është gjë aq e lehtë. Sillesh tamam si fëmijë.

— Po unë nuk e kam veten në dorë. Duhet të më kuptosh.

— Pa mendo një herë, edhe pak e do të marrësh maturën. Çdo të bëheshe po të mos ishe fejuar me Fredin? Do të të hidhnin në ndonjë fshat të humbur. Sa mësuese të reja plaken nëpër fshatra dhe luten të martohen me ndonjë malësor, ndonjë mësues fshati, me ndonjë shofer, po as ata nuk i marrin moj bijë, sepse duan zoçka të reja njerëzia, nuk janë budallenj. Shiko Lejla, unë jam nëna jote dhe, dua që të jesh vërtet e lumtur. Të kam të vetme, dhe dua të të kem këtu pranë. Dhe ta dish se je një vajzë, që ke lindur me fat të bardhë.

— Nënë, e pse s'u fejua Fredi me atë vajzën flokë verdhë, që e shëtiste me motor?

— Se djemtë shëtisin shumë, po nuk kanë qejf të martohen me ato që shëtisin. Dëgjo! Kur vinim rrugës

me Fredin, vendosëm që të martoheni me të mbaruar provimin e fundit. E diela e parë bie më 30 qershor.

Unë heshta e u mbylla në vetvete. S'mund ta fyeja nënën. E dija shumë mirë se ç'kishte bërë ajo pér mua. Kishte mohuar gjithë jetën e saj. Pra edhe unë duhej të sakrifikoja diçka pér të mos e shqetësuar. Deri vonë e respektosa thellësish vetmohimin e saj. Po papritur, atë çast mendova: «Më mirë të mos kishte sakrifikuar aq shumë. Më mirë ta kishte bërë jetën e saj të plotë. Ajo nuk i qëndroi besnikë zemrës së saj. Nuk provoi fare dashuri në jetë. Ajo i qëndroi besnikë zakonit dhe detyrës së saj si nënë». Po të mos isha kaq e detyruar ndaj saj, tashti unë do të isha e lirë dhe do të kisha të drejtë të kundërshtoja. Do të kisha të drejtë të mbroja mendimet e mia.

— Nënë, po sikur të mos e dashuroj dot Fredin, ç'familje do të krijojmë ne? — pyeta.

Ajo më shkundi pér krahësh, sikur deshte të më përmendte.

— Budallaçkë! Ç'është kjo marrëzi që flet! Mos ta ka marrë mendjen ndonjë nga ata çiliminjtë e klasës tënde?

— Jo! Ata i kam shokë.

— Ç'të bukur shokë! Që kur vajtët në hekurudhë, kini luajtur mendsh fare. Po këtu nuk jemi në malësi dhe nuk jemi njerëz të zakoneve prapanike.

Hyra në dhomë. Më dukej sikur ajo rrotullohej, sikur tek unë ishte thyer ajo ndjenja e thellë e dashurisë që kisha deri atëhere pér nënën.

Nëna vazhdonte të fliste.

— Po... — thoshte ajo me vendosmëri.

Zëri i saj më vinte i largët.

— Dashuria e vërtetë lind pas martesës. Kështu na ka ndodhur të gjithëve.

Nëna vazhdonte të fliste, kurse unë e ndjeja veten të pafuqishme pér t'i kundërshtuar. Ndofta ajo edhe kishte të drejtë. Ndofta unë duhet të përpinqesha më shumë pér të qenë «e arësyeshme».

Fredi shtyu me lehtësi derën e rëndë prej hekuri. Vila e Fredit fshihej nëpër një pyll të vërtetë hurmash. Vetëm antena e televizorit bënte majë mbi to, ndërsa shtëpia e fshehur prapa pemëve, dukej sikur nuk deshte që të lidhej fare me botën tonë, me zhurmat, me ecë e jakën e autobusëvet, dhe njerëzve. Kaluam nëpër rrugën e shtruar me pllaka të bardha. Megjithëse kisha qenë shpesh në shtëpinë e tij, prapë më zuri një dridhje dhe nuk e di përsë ajo shtëpi e bukur, me një verandë të madhe, me mure të lyer me ngjyra të ndryshme, m'u duk si një kështjellë e çuditshme mesjetare, që kishte mbirë papritur atje.

Në oborr doli inxhinieri plak. Që nga koha kur kish dalë në pension kishte mbyllur edhe kapakët e disa studimeve shkencore dhe merrej me kopshtari. Ishte një plak i thinjur, energjik, me një vështrim të mprehtë dhe depërttonjës, me një buzëqeshje të kënaqur. Ndofta është pikërisht kjo buzëqeshje që më shtie të dridhura dhe më ngjall një ndjenjë pakënaqësie.

— Mirëseerdhe bija ime!

«Sa dorë e ftohtë» mendoja duke kaluar nëpër verandë. Hymë në dhomën e bukës. Ajo ka në mes një tavolinë ngjyrë arre, nëpër dollapet me xhamë shkëlqejnë servise të shtrenjtë. Duket sikur edhe sendet, si frymorët i përshkon një ndjenjë vetkënaqësie.

Inxhinieri vërtitej nëpër shtëpi dhe fliste vazhdimi misht duke u përpjekur që unë të përgjigjem ose të marr pjesë në bisedë. Po ishte e çuditshme. Nuk nxirrija dot as gjysmë fjale. Gjithë kohën vetëm dëgjoja dhe heshtja. Po mendoja për nënën e Fredit. Ndofta edhe ajo ka qenë dikur në vajzë gazmore plot jetë, por dalëngadalë nën hijen e kësaj shtëpie të izoluar u kthyte edhe vetë në një hije.

Plaku doli nga dhoma. Fredi u mbështet në poltronë, më hodhi një vështrim të kujdeshshëm dhe më tha:

— Lejla, të dua shumë, shumë. E ndjen ti këtë?

Para disa kohësh kur kthehesha prej shkolle e shkujdesur, me çantën e librave, pas shpinës sime rrëshqiste motori i Fredit. Po unë as që e ktheja kokën. Kisha mërzi, bile mezi e mbaja inatin. Isha gati të shfryj. Çe pandehte veten ai? Përse më ndiqte hap pas hapi? Unë hyja në shtëpi dhe përplasja derën në hundët e mjekut të ri dhe elegant. Dhe zieja nga inati për sigurinë e tij. Ai dukej sikur thoshte: «Mjafton të dua unë dhe gjithshka realizohet».

Ndoshta ishte pikërisht kjo sjellje përbuzëse, që e shtyu Fredin të mos heqë dorë prej meje.

Fredi thoshte vetëm fraza të zgjedhura.

— Si dëgjoj për herë të parë këto fjalë.

— Ah, po unë prandaj të dua shumë, sepse ti je e ftohtë, krenare dhe përbuzëse. Si një perëndeshë antike. Megjithëse nëpër filma ato i bëjnë me flokë të verdhë, unë i mendoj kështu si ti, me flokë të zez dhe me sy të kaltër si në blu.

Mendoja: «Fjalët do t'i marrë era». Ato në të vërtetë janë vetëm zhurmë e kotë. Pastaj do të mbetet njeriu. E përse të mos mbetej Fredi si një njeri të cilët t'ë mund t'i besoja jetën time? Përse?...»

— Ç'ke kështu? Unë kam vënë re se kur je me shoqet, je e gjëzuar dhe gjithë fjalë e muhabete. Unë dua që ti të sjellësh në shtëpinë tonë zhurmë, gaz dhe rini. Rininë tënde të vërtetë pa asnje ngjyrë artificiale. Rininë tënde të mrekullueshme.

Në atë çast hyri nëna e Fredit. Ajo më përqafoi dhe më vështroi me dhimbshuri. Nuk e di pse ndjeja një keqardhje për atë grua. Ishte e re, ose dukej e re, me një lëkurë të bardhë e të lëmuar, pa asnje rrudhë. Fredi më shikonte me triumf sikur deshte të thoshte: «Gratë e shtëpisë sonë nuk plaken kurrë». Po unë kisha një ndjenjë tjetër. Sepse ajo fytyra e saj e bardhë, që nuk kishte parë rrezen e diellit më dukej më shumë si fizionomia e një të burgosure, e një të sëmure.

Mua më pëlqente më shumë fytyra e nënës sime, me rrudha të thella dhe me flokët të thinjur. Ato ishin gjurmët e jetës, të luftës së saj me jetën. Kurse nëna e Fredit!... Më tmerronte bardhësia e saj prej qelqi dhe heshtja e saj. Dukej sikur jeta për atë grua kishte ndaluar në vend.

Ajo mori nga tryesa albumin dhe po e shfletonte. Edhe mua më tërhiqnin fotografitë. Mundohesha t'i lidhja me njera-tjetrën e të kuptoja jetën e njerëzve që më rrethonin.

Albumi i Fredit ishte mbushur me shumë fotografji të Fredit, të nënës së tij, të motrës së martuar, me fotografji të shoqeve, dhe kishte sidomos shumë fotografji nga plazhi. Fredit, duket i pëlqente vetja në plazh. Fotografi pranë motorit, në mal, alpinist, student jashëtë shtetit, dhe plot e plot shoqe sa të merreshin mendtë.

— Nuk duket e çuditshme — tha inxhinieri pa lëvizur nga vendi — ky djalë i vogël u bë burrë, bile dhe me nuse, kurse ne u plakëm pa e kuptuar, apo jo grua?

Nëna e Fredit vetëm buzëqeshi, me atë buzëqeshjen e vakët dhe pa shprehje.

Ra zilja e telefonit. Fredi brofi në këmbë dhe e rrëmbeu.

— Falemnderit, falemnderit! U siguan bilëtat e teatrit, — tha ai, pasi vuri receptorin në vend.

— Po sonte ka një program shumë të bukur në televizor — tha babai, — ç'ju duhen biletat e teatrit?

— Ka qejf Lejla të shkojmë. Do të shohim dramën që ka shkruar një grua: një dramaturge është që ka qenë edhe shoqja ime.

— Kush, Irena? — pyeti me habi babai.

— Po, Irena! Pse si ju duket?

— Asgjë. Tashti është koha e emancipimit të gruas! Ndofta pas disa vjetësh do të jetë nevoja të fillojmë nga emancipimi i burrit, apo jo Fredi?

Fredi qeshi me të madhe.

— Jo, jo baba, nuk do të jetë nevoja.

Kur dolëm në rrugë Fredi më shtrëngonte krahun dhe më shikonte herë pas here me bisht të syrit.

— Kush t'i siguroi biletat? — e pyeta.

— Irena, e njeh?

— Po. Kur isha në klasën e katërt fillore, ajo ishte maturante në shkollën tonë.

Më kishte mbetur i gjallë në kujtesë ai çast kur e pashë pér herë të parë atë vajzë. Festonim përvjetorin e themelimit të partisë. Të gjithë nxënësit e shkollës pedagogjike, të shkollës ushtrimore si dhe mësuesit tanë ishin në sallën e studimit të konviktit, që kishte edhe një skenë. Nga radha e maturantëve doli një vajzë e gjatë, me gërsheta të zeza. Një pëshpëritje e lehtë u ndie në sallë. «Irena, Irena». Pastaj ra një heshtje e thellë. Vajza drejtoi trupin dhe filloi të recitojë. E gjithë salla e ndiqte me një frymë si të ishte një njeri i vetëm, e magjepsur nga tinguili që shpërndante zëri i saj. Unë rrija e struktur në një qoshe; në zemër patë një mbresë të pakuptueshme që më mbeti pér shumë kohë.

Kishim një copë herë që ecnim në bulevardin «Stalin». Para Pallatit të madh të kulturës ishin grumbulluar njerëz dhe dëgjonin koncert nga grupet amatorë. Ne mezi çamë njerëzit që rrinin pranë e pranë.

— Irena ka qenë mikja ime, — theu heshtjen Fredi.

— Këtë e dinë të gjithë — iu përgjegja unë. — Unë ju kam parë gjithnjë kur kalonit pranë rrugës sonë.

— Irena është një grua shumë e çuditshme. Një nga njerëzit më të çuditshëm që kam parë në jetën time.

— Vërtet? Po përse u ndatë?

— Ajo e donte shumë teatrin.

— Çudi, po ti je intelektual, njeri i kohës. Si kështu?

— Po ajo u njoh me N., regjizorin, dhe u martua me të. Nuk mund të pajtoheshim bashkë, sepse nuk më pëlqente që gruaja ime të ishte artiste.

— Ke mbetur gjithnjë shok me të?

— Po. Ajo as që pyet nga konvensionet. Është gjithnjë në kërkim të diçkaje. Irena mund të jetë një shoqe e mirë, por jo një grua e mirë. Po të martohesha me të, do të përfundoja patjetër në çmendinë.

— Interesant! Këto që thua ti janë gjithë kontradikta.

— Ti do ta shohësh vetë dramën e Irenës. Jam i bindur që do të më kuptosh më mirë. Ashiu siç jam i bindur që ajo ka shkruar një drainë të krisur, për ndonjë grua të krisur, siç është edhe vetë.

Kur dolëm nga teatri, ecnim të dy nëpër trotuar duke këmbyer ndonjë vështrim. Secili ishte zhytur në mendimet e tij. Drama ishte e fortë. Kishte për heroinë një mësuese, një vajzë të thjeshtë malësore, që lufftoi deri në vdekje, e nuk u thye. Irena luante rolin kryesor në dramën e saj, dhe nuk e di pse e ndjeja vreten po aq të vogël, si dikur në sallën e studimit. Fundi tragjik i dramës ishte prekës, po dashuria për të ardhmen, besimi tek e nesërmja e ndriste dramën si dielli dhe e përshkonte të përtej. Irena më kishte tronditur me lojën e saj.

Shihja fytyrën e vrenjtur të Fredit dhe mendoja për kufirin që do t'i vinte gruas së tij. Fredi gjithnjë thoshte: «Gruaja ime dëshiroj të jetë e tillë...»

— Ç'mendon për dramën? — e pyeta Fredin.

— Ti e kupton se sa larg është Irena dhe drama e saj nga mendimi që kam unë për gruan ideale. A nuk t'u duk artificiale dhe plot deklarata, ajo mësuesja?

— Jo! — thashë unë. — Ajo ishte një mësuese e vërtetë dhe një luftëtare e vërtetë.

Fredi qeshi me të madhe.

— Çudi, që të gjitha ju të rejat mendoni sipas ske-mave të disa librave dhe dramave tona të dobëta, që dalin e botohen si kërpudhat pas shiut. Ju është pri-shur shija estetike.

— Fred! Pse flet kështu për «librat tona», për «dra-mat tona». Sipas teje cilat janë libra të mira?

— Libër i vërtetë është ai që të tërheq me diçka të jashtëzakonshme, që ka një stil krejt të ri. Mua më intereson e më tërheq mënyra si shprehet një autor, jo çfarë shpreh ai. Arti i vërtetë është kërkimi pambarim i një forme sa më të përsosur.

— Po, ky është arti për art. E kemi bërë edhe në shkollë. Po mos harro veç se s'ka mbetur e pavdeksh-me ndonjë vepër e shkruar me art të kulluar, po pa përbajtje, përkundrazi, — thashë me rrëmbim.

— E sheh! Ne edhe kur flasim, flasim me formula, me ç'na kanë mësuar në shkollë.

— Ashtu?

— Ha, ha, ha.

— Pse qësh?

— Sepse ti je shumë naive, Lejla. Je një fëmijë që beson çdo gjë që të thonë në shkollë.

Më mbeti në sy e qeshura e Fredit.

Ndofta unë s'dija të shprehesha me fjalët e duhu-ra e të përballoja elokuencën e tij prej njeriu më të pjekur e me të rrahur se unë në jetë, por e ndjeja që kisha unë të drejtë e jo ai. Unë i ndjeja si pjesë të jetës sime ato që lexoja, kurse atij të përkëdhelurit, të velurit, i duheshin karamele, që treteshin lehtë.

S'ishte e mundur të mendonim njësoj. Sigurisht ai e shikonte botën, njerëzit e mua, nga maja e tij olim-pike me një mospërfillje dhe ironi të padurueshme.

Natën u zgjova disa herë e tronditur. Herë e shi-koja Irenën duke buzëqeshur, herë Fordin të zemëruar, që përshpëriste pareshtur me zë të ulët si të ngjirur:

«Gruaja e ime nuk duhet të jetë artiste. Më pëlqen më mirë të gatuajë gjellë të shijshme se sa të shkruajë drama tragjike». Sa i hapja sytë unë përsëri shihja Fre-din duke qeshur me mendimet e mia. Endërra e çoro-dit vazhdonte pa ndërprerje. Unë brofa në këmbë, Kisha të ftohtë. Po gdhinte. Vija vërdallë nëpër dhomë dhe nuk çlirohesha dot nga një peshë që më rëndonte si një gur në zemër. Nënë, ti po fle pranë meje e qetë, se më ke preqatitur një të ardhme të lumtur. A mund ta dish ti se sa e vogël është ajo lumturi? A e di se sa e akullt dhe e huaj është për ne ajo botë, kur bërtasin gjithnjë «Gruaja ime»..., sikur të ishte fjala për të thënë palltua ime, kravata ime, këpucët e mia...

### III

Dita e fundit e shkollës. Oborri ziente nga këngët. Ne nuk donim të mallëngjeheshim, që klasa e tretë po na e zinte rrjeshtin në oborr. Ne këndonim dhe entuziazmi ynë i rrëmbeu të gjithë. Këndonim këngën e dashur të aksionit: «Marshi partizan».

Në të gjitha gazetat ishte botuar letra që kishte dërguar klasa jonë. Ne kërkuan të punojmë vullnetarisht në zona të largëta malore, për të zëvendësuar mësuesin hero, Ismet Sali Bruçaj. Donim të shkonim atje, së bashku me drithën elektrike, nëpër rrugët që ndërtuan shokët tanë të aksioneve, duke kënduar këngën e marshit partizan. Kjo ishte një e papritur që përbysë planet që kurdisnin prindërit tanë. Kjo ishte si vetë kënga e marshit partizan:

«Zhurmshëm thyhen si masa vigane.

Këngët tona

Këngët e hekurta partizane.»

Klara, shoqja ime e bangës kishte shkruar një

vjershë, që ishte botuar pranë letrës sonë në «Zerin e rinisë». Vjershën e kishte mësuar përmendësh dhe e recitoi para gjithë nxënësve të shkollës.

Vjersha fliste për një mësues të ri që ecën në dëborë dhe furtunë. Nata është e errët, era është e fortë, por ai ecën, ecën dhe nuk tërhiqet.

Unë e dija se pa tjetër do të vinte Fredi i alar-muar, me gazeten, që kishte edhe emrin tim.

Dhe s'isha gabuar. Pa mbaruar mirë së recituari Klara vjershën, u duk motori gri i Fredit. Ai vrapi drejt meje me një vështrim kërcënues, por e mbajti veten. Rrotullonte në dorë gazeten «Zéri i Rinisë», vështronë oborrin dhe nxënësit që vazhdonin këngën:

«Ecim, ecim, ecim dhe marshojmë...»

Kjo është një këngë e çmendur tha ai: Një këngë që të ngre nervat:

— Na pëlqen shumë. E këndonim gjithnjë kur ishim në hekurudhë.

Fredi shtrëngoi dhëmbët dhe ndërrroi bisedë.

— Më mori malli, kam dy ditë pa të parë. Më mirë të isha bërë marangoz, se sa mjek. Po na shkatërrohen nervat duke punuar pa pushim; aq sa nuk shohim dot as gratë tonë!

«Po vjen rrotull — mendoja — thuaje të shkretën»

— Të kam sjellë diçka për të ngrënë. Je dobësuar shumë e dashur, prandaj unë kam preqatitur një rapport që të mos japësh provime. Sepse shëndeti, është numri një në jetën e njeriut. Të tjerat janë zerot që i shtohen njëshit. Pa hiqe një herë njëshin. C'vlefte do të kenë zerot? — thotë një proverb kinez.

Fillova ta humbas durimin.

— Falemnderit, po është e kotë: Unë e ndjej veten fare mirë, bile më mirë se kurrë.

— Vërtet? Po kush është mjek këtu, ti apo unë?

— Ti vetë the, se dëshiron që të jesh më mirë marangoz.

— Lëri shakatë Lejla, nuk është koha për shaka. Edhe sikur të marrësh diplomën, prapëseprapë, ti do të qëndrosh pa punë, se këtu në Tiranë s'ka vend për mësueset.

— Përse e rrotullon nëpër duar atë gazetë?

— Ah, po, desha të thosha që ke bërë shumë mirë që nuk je ndarë nga shoqet. Populli thotë: «Me të thënë e me të bërë është në mes një det i tërë! Ti je e sëmurë, nusja ime e vogël. Kupton? Je e sëmurë! Ja tashti do të bisedoj me drejtorin e shkollës për ty.

— Jo Fred, nuk do të bisedosh, me asnjeri,

Papritur me shkrepit mendimi: Ç'mrekulli do të ishte sikur Fredi të thoshte papritur «ne do të shkojmë së bashku do të punojmë së bashku, do të krijojmë jetën tonë të re, të shëndetshme, me dashuri të pakufishme».

Ja se ç'ëndërroja.

— Ruaje veten, shëndeti është dhurata më e çmuar që i ka dhënë natyra njeriut. Dua të shkëlqesh gjithnjë. Dua të më çlodhësh kur të kthehem nga klinika, ku do të kem parë aq fytyra të venitura dhe të sëmura.

— E ke parë nënën time?

— Fred, të lutem mos më folë për nënën tënde!

Fytyrës së tij i ra një hije e gjelbër nga zemërimi.

— Pse?

— Mos do që të katandisem edhe unë si nëna jote? Një njeri, që vetëm sa bën hije mbi dhe?!

— E shikon? Kisha të drejtë. Ti je sëmurë, po flet përqart. Sigurisht që ke temperaturë. Hajde të shkojmë në shtëpi.

Unë heshtja, dhëmbët më kërcisin sikur më kishin zënë vërtet ethet.

— Ke të ftohtë, e shikon? Hajde të dalim në diell. Ki kujdes, — m'u drejtua. — Ti do të bësh kështu si dua unë.

Kisha një copë herë që shikoja një krimb që zva-

rrisej në pluhur. Rropatej të ngrihej mbi një degë të hollë, por përsëri përplasej për dhë. I vura këmbën dhe e shtypa me neveri.

— Kuptoj Fred — thashë unë me sytë gjetiu që të mos më lexonte mendimet.

Ra zilja për të hyrë në mësim.

Shokët këndonin dhe mezi u ulën nëpër banga. Klara më vështronte e hutuar. Klara ashtu duket si e hutuar po është një vajzë me ndjenja të Holla dhe èndërra të guximshme. Unë rrija në bangë si e trullo-sur. E dija se tashti do të fillonte luffta e vërtetë me ata. Po e dija që lufta do të ishte e rrëptë. Rrija në bangë me sy të mjegulluar dhe nuk kuptoja kush hyri në klasë. Mësuesja po më pyeste:

— Cili është heroi më interesant i ditëve tonë, hero i gjallë si Pavël Korçagini? Thuaje, thuaje Lejla.

U ngrita e trembur, sikur u zgjova nga një gjumë i thellë. Klara kishte ulur kokën dhe më pëshpëriste. Shokët më pëshpërisnin nga të gjitha anët e klasës. Vetëm unë heshtja. As shihnjë, as dëgjonja njeri. Lotët më ishin mbledhur në grykë, dhe unë i gjelltisja e zemëruar me veten dhe me dobësinë time. Mbështetësha pas bangës dhe shikonja atë botën e Fredit, ngritur kundër meje me gjithë mjeshterinë e saj të djallëzuar. «Një raport mjekësor. Ti je e sëmu-rë. Ti duhet të pushosh.» Ndofta do të më shtrojnë edhe në spital si në tregimin e Çehovit, në një spital psikiatrik, sepse nuk jam mirë nga nervat.»

— Ulu, ulu. Kush do ta plotësojë? — tha mësuesja.

Vetëm atëherë e vura re mësuesen e letërsisë, atë grua me vështrim të ngrohtë dhe të zgjuar, që e doja aq shumë.

Zilja. Në mes shokësh. Ata filluan këngën. Sa e bukur ishte kënga jonë. Ajo këngë më kujtonte tra-senë.

«Ecim, ecim dhe marshojmë...»

Kështu shkonim duke kënduar, ne, nëpër udhën

tonë të dashur drejt kufirit, ku shpërndahej mugëtira dhe lindnin agimet e paharruara të diellit mbi trase. Çdo ditë e përshëndesnim diellin me ndjenjën e gëzimit që kishim dalë para tij në rrugën e trasësë. Shkonim në të dy anët e saj dhe lëmshi i zjarrtë shkrep-te, pastaj dalëngadalë rrezet puthnin kazmat dhe flo-kët tona dhe ne i thoshim në mes të këngës sonë: mirë-mëngjez, diell, mirëmëngjez!

«Ecim. Ecim dhe marshojmë...»

Kjo këngë ndihej edhe në mbarimin e ditës kur shkriheshin ngjyrat blu dhe e kaltër dhe një mjergull e argjendtë zëvëndëson te perëndimet e zgjatura të diellit në Myzeqe. Ktheheshim nga traseja dhe bota si-kur zgjerohej. Para nesh hapeshin horizonte të pakufishme. Këto horizonte kurrë nuk do t'i kishim ndjerë kaq të pakufishme po të qëndronim pranë oborreve tanë, pranë kaktuseve e vilave të fshehura me kujdes ndër hurma.

Ne do të ecim dhe mbi qiellin tonë, do të ndri-jnë ëndërrat tona si masa vigane, ëndërrat tona partizane!

## V

— Natën e mirë, nusja ime.

— Natën e mirë, nënë!

Mbetem vetëm. Ulem para pasqyrës, që e njoh qysh në kohë të fëminisë. Akoma ndjej në sup pre-kjen e lehtë të dorës së nënës. Një palë sy, larg nga njëri-tjetri, më vështrojnë me vëmendje nga pasqyra. E kam dashur gjithmonë këtë pasqyrë. Ajo është përmua si ditar. E mbaj mend veten që kur isha një vajzë e vogël, me fjongo të bardhë në majë të kokës.

Mbi komodinë është një tufë me zambakë, që më ka sjellë Fredi dhe mbi krevat fustani i najlonit. Fus-

tani i ka ardhur nga jashtë inxhinierit, pér nusen e djalit.

Fredi éshtë i gëzuar «që më nё fund çdo gjë u rre-gullua.» Bisqet e hollë janë përkulur. Të gjorat lule! Sa janë lodhur! Éshtë ora tre pas mesnate.

Pasqyra hesht e akullt, me një avull të lehtë nga frymëmarrja ime.

Tërheq shpejt sirtarin. E lexoj pér të njëqindtén herë raportin që ka pregetitur «komisioni mjekësor i shtëpisë sime». Dhe të gjithë e kanë pranuar si të vërtetë. Edhe unë duhet ta pranoj. Kështu ngul këmbë nëna ime.

— Përse më dukesh kaq e huaj, o nëna e ime?

Më duket se një zë i dobët më thotë:

— Lejla! Mendohu mirë!

— Çfarë të mendoj?

— Vendimin që ke marrë. Ti do të vrasësh nënën me duart e tua!

Kujtoja se ora ishte akoma tre. Por akrepët lëviznin më shpejt se çdo natë. Të gjitha sendet në dhomën time, sikur kanë një ritëm të shpejtë, të nxituar

Qielli éshtë i kthjellët. Qershori. Atje lart, pa u mërzitur pér asgjë, bën roje «ylli im». Që në fëmini e kam dashur atë yll, sepse ishte më i madh dhe më i ndritshëm se të tjerët. Padashur duart prekin fustanin. Sa i ftohtë! Si shtresë akulli. Kthehem përsëri nga pasqyra. Nëpërmjet një tisi të hollë, shikoj po atë vajzë të huaj. Sy të kthjellët dhe zbetësi të çuditshme.

— Epo «kjo zonjushë» qënkam unë! .

Akrepët lëvizin pa mëshirë. Mbetën edhe dy orë! Gjithëshka e zhytur në errësirë e dremitje do të zgjohet. Edhe dy orë! Kjo dhomë ku kalova fëmininë e rininë do të më bëhet e huaj.

Të përbuzësh nënën. Si mund ta bëj?

«Po s'mund të lejoj që ta gatuajnë jetën time si të duan, goftë dhe nënën»

«Po ajo ka jetuar gjithë jetën vetëm pér ty. Si mund t'i japësh një shuplakë të tillë?»

«Nëna po lufton kundër së vërtetës dhe idealeve tona.»

Kështu vazhduan mendimet gjatë atyre dy orëve.

Po tashti erdhi çasti: ose duhet të vesh këtë fustan të bardhë, fustanin najlon ose... .

Disa avuj si lot rrëshqasin nga pasqyra, ku kam mbështetur ballin pér ta ftohur.

— Lamtumirë nënë!

Fustani najlon, i zbukuruar me lule të ndritura, fle, i hedhur mbi krevatin tim.

Mora një valixhe të vogël. Hapa derën. Eca në majë të gishterinjve. Nëna ishte e lodhur. Flokët e thinjur i ishin shpërndarë nëpër jastëk. Pata një dëshirë të madhe të ulesha në gjunjë, e ta puthja. E shikoja. E dija mirë përsë kishte kaq thinja. Po nuk mund të bëja ndryshe. Ndërmjet nesh qëndronte fustani i bardhë najlon.

## MIREMENGJEZ!

Gazetarja nxori blokun e shënimeve, rregulloi xhupin e trashë dhe shkroi shpejt e shpejt, pa pasur kohë të mendohej, përshtypjet e ditës. Ditët dhe netët ishin të mbushura me aq ngjarje, sa ajo s'mund të kthehej e t'i shikonte përsëri shënimet e veta. Vetëm shkruante.

Në fillim ajo s'deshte të tregonte se ishte gazetare. E ç'rëndësi kishte? Ishte vullnetare si të gjitha gratë e tjera, që banonin në atë dhomë të thjeshtë, të ftohtë, me të plasura e me të cara të thella nga tërmeti. Po ishte e pamundur ta mbante të fshehtë, sepse ajo do t'i shkruante patjetër artikujt e vet, do t'i niste me vargun e parë të maqinave ose do të jepte me telefon ngjarjet që s'prisin më. Po gazetarja donte që gratë të ishin sa më të natyrshme në jetën e tyre dhe ajo të shkruante të vërtetën pa ekzaltime, pa e zbehur. Mundohej të rrëmbente fragmente jete, megjithëse e dinte që e vërteta ishte gjithnjë më e fuqishme, më e mprehtë nga ato që shkruante.

— Nesër fëmijët s'do t'i varin çantat nëpër degët e pemëve, — kumboi në dhomën e heshtur një zë i kthjellët.

Gazetarja ngriti kokën dhe i buzëqeshi gruas që po fliste. Iu kujtua një djalë i vogël e i imët, me shall të kuq. Ai dilte çdo mëngjez prej çadrës pranë shkollës që ndërtonin gratë vullnetare. Djali fërkonte duart për t'i ngrohur, merrte çantën e varur te pema e mbuluar

me dëborë, e hapte, nxirrte librat. I shikonte për një çast. Përsëri e varte çantën në degë. Vraponte me shallin që ia merrte era dhe punonte bashkë me vullnetarët.

— Po, — pëshpëriti gazetarja, — nesër fëmijët do të ulen përsëri në bangat e tyre. Ndërsa ti, Liri, na qenke mallëngjyer, sepse ke kaq net që po ngre murat e shkollës së Afërditës.

Afërdita qeshi dhe mori një tok fletoresh për t'i korrigjuar. Kishin qenë kaq të zënë këto kohë sa i kishte lënë pasdore fletoret. Po nesër fëmijët do të ulen përsëri nëpër banga.

— Ti Afërditë, gjithë kohën mbrëmë flisje nëpër gjumë për Diellën dhe për Ndrekën.

— Sigurisht, për djalin tënd? — pyeti gazetarja.

— Ndreka s'është djali im, ka qenë nxënësi im. Edhe Diella, nëna e tij, ka qenë nxënësja ime, — tha mësuesja.

Gazetarja ngriti sytë dhe e vështroi e habitur.

— Më kërkove të them diçka interesante. Shkruaj për Diellën! — tha përsëri mësuesja.

Zëri i saj ishte i thellë, i ulët. Gazetarja la punën. Edhe Liria po e vërente me vëmendje mësuesen.

— Ne vetë, me duart tonë, i hoqëm rrënimet e shtëpive të shkatërruara — vazhdoi ajo. — Shtëpia e Diellës ishte shembur. Kishte zënë Ndrekën brenda. Diella priste me trupin e ngrirë, me sytë e zmadhuar, që vështronin në hapësirë, si të verbërit, derisa i hoqën të gjitha tullat, gurët e tjegullat dhe dolën pantallonat e kaltra prej kadifeje të Ndrekës. Shembja kishte ndodhur fare papritur, për një çast të vetëm! Diellës i ngriu çdo ndjenjë dhe çdo mendim sikur t'i kishte mbuluar një shtresë e trashë akulli. Ne u çuditëm kur ajo e mori vetë djalin në duar. Vetëm nga flegrat e hundës e sytë e ngrirë si xham, pa asnje pikë lot, mund të kuptoje dhimbjen e saj. Pastaj të gjitha u kryen aq shpejt, sa ajo dhe unë s'morëm vesh gjë; ishim si të mpira. Ende pa mbaruar së kërkuan

njerëzit nëpër rrënimet, ende pa marrë veten nga plagët e thella, rodhi deri në këtë skutën tonë të largët lumi i rrëmbyer.

Shtëpinë e Diellës e ngritën krejt të re. Ajo punoi e heshtur dhe e fortë. Unë e kam dashur gjithnjë Diellën, që kur ishte e vogël, që kur rrinte në gjunjë në dhomën e një kulle që ishte «klasa» jonë dhe shkruante gërmat e para. Më vonë kur u bë me fëmijë ëndërronte fshehurazi, që Ndreka i saj të bëhej mësues. Megjithatë, ajo nuk u tërroq: Ajo punoi me të gjithë të tjerët duke pasur një dhimbje aq të madhe.

Gazetarja dhe Liria ndejtën një copë herë pa folur.

— A ka mundësi ta shoh Diellën, — pyeti gazetarja.

— Patjetër! E ka shtëpinë në fshatin fqinj. Nesër mbasdite shkojmë atje.

— Ti Afërditë je shumë e lodhur. Fli pak se të zgjojmë ne, — tha Liria.

— Mua s'më zë gjumi, — tha ajo, — megjithëse jam e këputur.

— Të them të drejtën, as unë s'do të vija të püşhoja pikërisht tashti, po ç'tu bëj atyre vajzave të uzinës sonë. Ju e patë vetë. Shko që shko! Dhe kur të qepen, është e kotë, më mirë lëshoju udhë, — vazhdoi Liria për të ndryshuar bisedën, sepse vuri re që mësuesja ishte zverdhur shumë.

— Vërtet, para disa ditësh, kur ngrica të thante duart, kur mjegulla na pengonte të punonim, një vajzë e gjatë, Lili më duket e quanin, bënte shaka me shoqet. Thoshte me zë të lartë se i pëlqente të punonte natën në mjegull, — tha gazetarja.

— Ah, ajo pikaloshja është djalli vetë! I bie aq bukur fizarmonikës nëpër mbrëmjet e vallëzimit! Ke qenë në mbrëmjet e rinisë sonë?

— Po, kanë diçka që të përtërin dhe të jep jetë. Nuk e mban mend? Aty jemi njojur bashkë.

Një copë herë heshtën. Gazetarja shkruante. Li-

ria merrej me zjarrin, njërsa mësuesja e mbështetur pas murit dukej sikur dremiste, po në të vërtetë s'donte të pengonte gazetaren që punonte nën dritën e dobët të llambës.

Gazetarja vështroi shënimet. Ngriti kokën.

Liria mori revistën «Shqiptarja e re» dhe filloi të lexonte. Pastaj tha:

— Po lexoj shkrimin për shoqen e uzinës sonë, Shegën. Ajo ka qenë një grua e ndrojtur, e trembur, që jetonte gjithnjë nën hijen e burrit të saj. Megjithatë në shkrim nuk është kapur një çast vendimtar i jetës së saj. Unë kam qenë pranë dhe kam parë si luftonte edhe ndaj vetëvetes. Dhe q'luftë i është dashur të bëjë për të shpërthyer zinxhirët e rëndë të katër mureve, të atij rrëthi të ngushtë të kuzinave të ngrohta ku vdesin hovet më të bukura të rinisë. Këtë vdekje të ngadalshme shpirtërore mund ta shpëtojë vetëm një kolektiv i zjarrtë, vetëm ai mund ta transformojë jetën e mjegullt e të përgjumur në një jetë të vërtetë... Shiko, po na shuhet zjarri! — tha Liria dhe u ngrit t'i hidhte dru.

Jashtë frynte një erë e akullt. Kanati i rrëzuar i dritarës përplasej herë pas here, dhoma përkundëj, sikur të ishte një ashkël e vogël në një det me furtunë. Shtëpia ndodhej buzë udhës. Vargu i gjatë i auto-kolonës, si një arter vigan i sillte Dibrës së plagosur gjak dhe jetë. Era sillte copa të shkëputura nga bisedat e shoferëve:

«Kujdes, qafa ka ngrirë!»

«Ku fjete mbrëmë?»

«E ku të flija. Kohë për gjumë është!?»

«Kujdes zinxhirët!»

Pastaj përplasja e dyerve, uturima e motorëve dhe era.

Liria i mbante sytë mbyllur dhe dëgjonte zérat e shoferëve.

Uturima e motorëve u shua. Gazetarja kontrollonte artikullin, shton te paragrafe, prishte dhe ishte

e kredhur e tēra nē punën e saj. Dhoma e mësueses ishte e madhe dhe e ftohtë. Era depërtonte nëpër tē çarat, megjithëse gratë ishin munduar t'i zinin ato. Dhoma ngrohej vetëm kur mbushej plot me vullnetare. Po ato prej disa netësh po punonin duke ndërruar turnin, duke marrë nga një sy gjumë. Duke jetuar pranë e pranë nē këtë dhomë tē madhe dhe tē ftohtë, gratë dhe vajzat vullnetare ndjenin se si u shkrihen tē gjitha ndjenjat dhe mendimet e tyre nē një mendim tē vetëm: — Fëmijët duhet tē fillojnë sa më parë nga mësimet. Dhe ndërtesa e shkollës po rrитеj çdo ditë me një shpejtësi tē pabesueshme.

Gazetarja filloi tē hidhte nē tē pastër artikullin me shpejtësi, duke u përpjekur tē shkruante sa më qartë që tē mos e qortonin daktilografistet pér shkrimin e keq dhe tē pakuptueshëm. Ajo donte ta niste sa më parë me kolonën e maqinave, bile mendoi një herë ta jepte nē telefon, por telefonat ishin tē zënë dhe bisedat mezi dëgjoheshin.

Gratë ishin veshur me pantallona tē trasha e puhovra tē leshtë. Kishin hedhur krahëve nga një gozhup tē trashë ngjyrë ulliri. Gazetarja ishte e re, e imtë, me një vështrim tē zjarrtë dhe ngulmonjës, ndërsa Liria i kishte shpatullat tē gjera, ishte e shkurtër, e plotë, nē një moshë që është zor ta përcaktosh. Ndërsa mësuesja kishte flokë tē bakërt, si tē kishin marrë flakë, dhe një fytyrë ende tē re.

Gazetarja nuk ju tha se shkrimi bënte fjalë pér atë dhomë, pér netët pa gjumë, pér vullnetarët, që tashti rendisin tjegullat mbi çatinë e shkollës.

— Liri, — i tha gazetarja kur mbaroi së shkruari — tē lutem tē më ndihmosh!

— Me gjithë qejf...

— Të më tregosh kujtimet e tua gjatë kohës që punoje si shofere taksie.

Liria mblodhi supet.

— E ç'të tē them? Sa fytyra kam parë e sa ngjarje kam dëgjuar. Në fillim s'më harrohet habia e nje-

rëzve dhe aty-këtu edhe përbuzja e ndonjërit. «Një grua shofere?! Megjithatë, po të mos kisha thyer dorën në një aksident, edhe tashti do të punoja si shofere! Dhe kësaj radhe do të vija bashkë me shokët e mi të autokolonës, këtu në Dibër.

— Do t'u lutem të m'i thuash më me hollësi, është shumë e nevojshme për mua. Më folë për përshtypjet e para kur fillove punën në uzinë!

— Furrat e saj shkrijnë bashkë me metalin edhe «vogëlsirat e shpirtit». Do t'i përmbledh të gjitha forcat! — qeshi ajo. — Po përse nuk shkruan për Afërditën? Afërdita na priti në këtë dhomë me aq ngrohësi, saqë ne s'do ta harrojmë kurrë. Kur të kthehem i nëpër shtëpitë, Afërdita s'do të ketë kohë t'u përgjigjet letrave tona.

Afërdita ngriti kokën dhe buzëqeshi.

— Liri, léri shakatë! E ç'të shkruajë për mua? Jeta ime është e zakonshme, si e të gjitha mësueseve të fshatit.

— A nuk ke qenë partizane? Gjithë jetën e kalue këtu, në këtë dhomë me llambë vajguri. Dhe thua që kjo është e zakonshme?!

Gazetarja mbloindi shënimet dhe i futi në një zarf.

— Shpejtoni! — dëgjoi zërin e Lirisë. — Vajzat do të thonë se ne, vërtet, jemi plakur fare. Si thua Afërditë?

Mësuesja vuri buzën në gas.

— Duke punuar gjithnjë me fëmijët e harroj vetëveten — tha ajo. — Gëzohem dhe jam e lumtur tek mendoj se dhe fëmijët e mi do të ulen nesër nëpër banga.

— Hajdeni! Shpejtoni! Vajzat kujtojnë se ne do të flemë këtë natë!

— U vonuam, — tha gazetarja.

— Nesër do të të japim në dorë çelësat e shkoillës, Afërditë, — tha Liria kur po kaptonte prakun.

Mësuesja doli e para me fener në dorë.

Ishte ende natë, kur ato u hodhën në rrugën e

mbuluar nga ngrica. Njëshkolona e maqinave lëvizte papushim. Era kishte pushuar. Qielli ishte kthjelluar, gjithshka përreth dukej si e akulltë. Të ftohtët të hynte në palcë. Pranë ndërtesave kishte grumbuj zjareresh dhe njerëzish.

E para ecte mësuesja me fenerin që ndriçonte udhën. Gazetarja kishte humbur në xhupin e trashë dhe Liria mendonte për atë malësoren me emrin Diella. «Njeriu është i fortë. Dhembja të trullos, të paralizon, por të gjitha këto janë të përkohshme, sepsejeta prapëseprapë është e dashur dhe e bukur. Njeriu është më i fortë se guri. Bile edhe zemra e brishtë e nënës është më e fortë se guri».

Kur u afroan pranë shkollës, grupi i vajzave dhe i grave vullnetare, të cilat dy orë më parë u mblohdhën dhe e detyruan Afërditën me Lirinë të shkonin në shtëpi për të pushuar, ishin aq të zëna me punë, sa nuk i vunë re kur u kthyen prapë. Liria u fut e para ndërmjet grave.

— Ma lërë mua. Shko ngrohu, qenke bërë akull!  
— i tha ajo një myzeqareje të re.

Myzeqarja s'lëvizi nga vendi. I hapi udhën Lirisë. Gratë i bindeshin Lirisë, ajo ishte teknike dhe përgjegjësja e punimeve të shkollës. Por kjo myzeqarja sikur të qenkej shurdhuare fare. Ajo vetëm sa pëshpëriti: «Ka ardhur një vullnetare e re! Kurse, ju shoqe, nuk e zbatuat vëndimin e kolektivit. Përse u kthyet?»

— Midis nesh vijnë gjithnjë vullnetare të reja, — iu shhang përgjegjes Liria.

Nata ishte e ftohtë. Zakonisht netë të tilla dimri janë të heshtura dhe të bardha, po kjo natë ishte e shqetësuar dhe plot zhurmë nga uturima e maqinave, nga lëvizja e njerëzve. Dibra dukej si një stacion vigan, si një stacion ku kalonin mijëra e mijëra njerëz që i vinin në ndihmë.

Mësuesja e thinjur, gazetarja trupimët dhe myzeqarja e re i rendisnin me aq mjeshtëri tjetër, sikur gjithë jetën të mos kishin bërë gjë tjetër.

— Na ka ardhur një vullnetare e re. Ajo të kërkoj sapo erdhi, — i tha myzeqarja mësueses.

— Vërtet, po ku është?

— Atje, me vajzat e uzinës, po rendit tjegulla.

— Është ende errësirë, mezi dallohet. A të tha si e kishte emrin?

— Diella!

— Diella?!

Liria, e shpejtë si gjithmonë, e dëgjoi e para. Sa hap e mbyll sytë u gjend midis vajzave të uzinës së saj. Mësuesja e vuri re që përqafohej me një grua të gjatë dhe u drodh, sepse e njozu Diellën. Ndjente lodhje e mezi lëvizte nga vendi. I jepte automatikisht tullat myzeqares. S'kuptoi përsë s'vrapoi drejt Diellës për ta takuar.

Mësuesja u ngjit pak më sipër. E zuri për krahu gazetaren dhe e tërhoqi mënjanë.

— Do të njihesh me Diellën? — i tha.

— Gjatë gjithë kohës mendoja shkrimin për të!

— Hajde të të njoh. Diella është këtu midis nesh. Në fund të fundit, Diella është grua trime, — pëshpëriti mësuesja me sytë që i shkëlqenin nga lumturia.

Mësuesja mori gazetaren për dore. Gazetarja ishte e tronditur. Në jetën e saj ajo ishte takuar me shumë njerëz, po kjo grua ishte me të vërtetë interesante. U afroan pranë malësorës, që punonte me vajzat e uzinës, ndërsa mësuesja kishte një ndjenjë të pakuptueshme adhurimi dhe mirënjojheje për ish-nxënësen e vet.

Liria dhe vajzat e uzinës rrinin përreth Diellës, sikur donin ta ruanin që të mos e prekte gjë, bile as pu-hiza e lehtë e mëngjezit!

Agu që i binte mbi supet i jepte Diellës një shkël-qim të bronxtë. Gazetarja e vërejti me kureshtje dhe kur po i shtrëngonte dorën e ashpër dhe të fortë e përshtëndeti me zë të gëzuar:

— Mirëmëngjez Diella!

## PËRBUZJE

— Shoku doktor!

— Çfarë?

— Edhe një rast tjetër urgjent. Kanë sjellë një fëmijë të plagosur.

Doktor Gjergj Vasili shkundi kapitjen dhe bashkë me kirurgen e re, i doli vigut përrpara.

— Përse jeni vonuar kaq shumë? — thirri ai.

— Është nga të uzinës — u përgjegj infermierja.

Doktor Gjergji e dinte. Uzina ishte larg.

— Po shoferë s'ka atje.

— Fëmija u plagos para gjysmë ore. S'kishte mundësi të vinim më parë, mërmëriti shoferi duke rrötulluar kokoren nëpër duar.

Doktor Gjergji e pa me vërejtje shoferin. Iu duk si fytyrë e njojur. Po ai as që e ngrinte kokën. Ishte i lодhur, i parruar dhe vështronte vëngër e me mosbesim doktorin.

Nuk kishte kohë të mendonin më gjatë.

— Pulsi?

— Mezi ndihet.

Fëmija ndehej pothuaj pa jetë me një të çarë të thellë në ballë. Fytyra i qe mbetur në gjak.

— Pastrojeni, — tha doktor Gjergj Vasili, pasi qëndroi një sekondë i pavendosur.

— Cipa e trurit nuk është prekur, — vërejti Margarita.

Gjergji psherëtiu i lehtësuar.

— Vendoseni!

— Gati! Pregatituni doktoreshë.

Fëmija kishte humbur shumë gjak.

— Transfuzionin!

— Doktor po grupin? Janë mbaruar rezervat e grupit zero.

— Shpejt, përcaktioni grupin!

— Filloni, — tha Margarita dhe zgjati krahun. Unë kam grupin zero. Bëni transfuzion direkt. S'kemi kohë.

Pasi mbaroi së qepuri plagën, doktor Gjergji ngriti kokën. Margarita ishte zverdhur, po ishte e qetë sikur të mos kishte ndodhur gjë.

Doktor Gjergj Vasilit i dridheshin duart nga tendosja e nervave. Spitali i qytetit R. s'kishte pasur kurrë kaq pacientë, kaq kirurgë dhe kaq jetë të shqetësuar dhe plot ankth. Dridhjet e tokës e shkundnin herë pas here, po kirurgët me gjithëse të dërmuan nga lodhja dhe pagjumesia vazhdonin operacionet dhe kurimin e të plagosurve nga tërmeti.

— Përcilleni djalin në dhomën Nr. 6, — urdhëroi Gjergji.

— Mos u shqetësoni, do të qëndroj vetë në dhomën Nr. 6.

— S'është nevoja Margaritë.

— Ju punoni me aq pasion, si ato ditë kur na mësonit në fakultet mjeshtërinë e kirurgut, — tha ajo.

— Gjithnjë kam dashur të bëhem kirurg.

— Këto ditë, që kini ardhur ju dhe kolegët tuaj, profesor, pér mua kanë qenë ditë të vërteta! Mjekët duhet të jenë gjithnjë të frymëzuar në punën e tyre.

Gjergji u kthyte nga Margarita. Ai e mbante mend kur rrinte në auditor, këtë vajzë të urtë dhe të dobët. Rinte gjithnjë në bangën e parë dhe shënonë çdo fjalë të leksionit. Ai as që mund të merrte me mend, se do vinte një ditë urgjentisht në këtë spital që e kishte ngritur vetë dhe do të gjente pikërisht aty ish studenten e vet, kirurge të parë.

— Kirurgët duhet të jenë gjakftohtë. S'është mirë të rrëmbehesh nga pasionet.

— Më falni, profesor, dua t'ju pyes. A keni vënë re se sa shumë na duhet të bëjmë pér të merituar emrin mjek i vërtetë? Ne kemi një rrjet shëndetësor model. Kemi spitale, mjete, barna dhe shteti ynë harxhon miliona pér shëndetin e popullit. Po ne vetë jemi prapa! A nuk u shqetëson kjo profesor? Mua më shqetëson. S'mjafton të japim leksione shembullore dhe të kënaqemi me atë që kemi arrirë. Shteti bën investime të mëdha, na sjell aparate e laboratore nga më modernet, kurse ne nuk i përgjegjemi ende sa duhet kësaj teknike mjekësore kaq të përparuar.

Gjergji po e vërente me habi ish studenten e tij.

— Këto ditë në Dibër kanë ardhur me mijëra vullnetarë, vazhdoi ajo. — Ata kanë sjellë me vete gjithshka të bukur, të ngrohtë dhe njerëzore. Këto ditë, megjithëse ju dhe kolegët tuaj jini të lodhur, me net të tëra pa gjumë, unë kam parë të realizuar èndrrën time: si duhet të jenë mjekët e vërtetë. Jo nënë një rast, po gjithnjë! — Mos ju mërzita profesor?

— Jo. Aspak. Po më bëni të mendohem.

\* \* \*

Kur doli nga dera e spitalit, Gjergji lëvizi dorën sikur deshte të përzinte një mendim. Largoi me majën e këpucës një tok dëbore, që u shpërnda nëpër shkallët e gurta si një tis i hollë.

«Këtu çdo gjë ka ndryshuar», mendoi, duke vështruar qytetin që ishte rritur brenda disa viteve sa mëzi e njihje.

Jo, tashti ai nuk ishte më një qytet i humbur dhe pa emër. Ishte një qytet i vërtetë, modern dhe, megjithëse e tërë krahina ishte tronditur nga tërmeti, ky qytet i ri, i fortë tallej me zemërimin dhe kërcënimet e nëntokës. Ato ditë ai ishte gjithë jetë. Në të gërshtoheshin dhe

lidheshin të gjitha linjat e automjeteve, materialeve të ndërtimit, lëvizjet e njerëzve nga krahinat më të ndryshme të vendit.

«Po, — thoshte Gjergji. — Tashti vërtet është bërë një qytet i madh, dhe s'njoh pothuaj asnjeri në këtë qytet. Po as që donte të takonte ndonjë të njohur... Edhe pak ditë kishin mbetur. Njerëzit do të mbaronin ndërtimet dhe do të kthehen në përfestuar Vitin e ri në shtëpitë e tyre. Dalëngadalë edhe të plagosurit do të ngrihen në këmbë.

Eci një copë udhë. Ju kujtua shoferi. Ku e kishte parë atë fytyrë? Po përsë çuditej? Ai ishte Gazmiri, shoku i Suzanës dhe i Pirros.

«Ah, prandaj më vështron me aq mosbesim. Prandaj më shikonte me aq neveri? Dhe unë dua që të mos më njohin në këtë qytet. Po më merret fryma! Kush mund të marrë me mend sa frikë kam se mos takoj rastësisht Pirron, apo Suzanën në rrugë?»

«Më mirë të mendoj për Margaritën. Margarita flet për shqetësimë! Po a e di që edhe mua po më shqetëson? Ç'është kjo? Unë e njoh veten time. Do të rrëmbehem papritur, do të ndizem si kashta, pastaj kjo flakë do të shkëputet prej meje si meteor dhe do humbasë në hapësirë pa lënë asnje gjurmë.»

Ai u step një çast. Britmat gazmore të fëmijëve që dilnin nga shkolla me çantat në duar, sikur e shkundën.

Ngriti jakën e palltos.

Deri te hyrja e spitalit Gjergji deshte të mos mendonte asgjë tjetër veç Margaritës. Kështu vetëm mund të çlodhej. E përsë të mendonte tjetër gjë? Këto ditë ai duhej të merrte një vendim të shpejtë! Sepse kishte frikë nga vetja. Sepse ai e dinte sa mund të dashuronte. Tashmë i kishte flokët të thinjur dhe ishte bërë një burrë serioz.

Kur u ngjit në lulishten e spitalit i hodhi një sy qytetit të shqetësuar dhe të veshur me një petk akulli. Gjithnjë e kishte parë me përbuzje këtë qytet ku ishin ngatërruar aq shumë fijet e jetës së tij. Korabi me ma-

jat e veta të bardha shponte mugëtirën. Shpejtoi hapat. Në koridor ndjeu éren e njohur të spitalit.

Veshi shpejt bluzën e bardhë. Filloi vizitën nëpër pavion. Vizitoi pacientët e operuar. Ishte nervoz dhe ziente përbrënda nga mëdyshja.

Margaritën e gjeti në dhomën e mjekut të rojes.

— Mirëmbrëma, — tha ai. — Si éshtë djali?

— Ka ardhur e ëma. Tashti éshtë i qetë. Po fle shumë mirë.

Ajo lëvizi lehtë kokën dhe vazhdoi të lexonte. Ai vështroi një copë herë dhe ndjeu një dyndje mendimesh. «Përse bën sikur nuk i interesoj fare?»

— Mos keni harruar gjë profesor? — pyeti Margarita.

— Jo! Çfarë po lexoni?

— Mjekun e tre kontinenteve.

— Gjeni kohë të lexoni, kur keni kaq netë pa gjumë?

— ...

Gjergji qeshi nën hundë. — Jini ende në kohën e iluzioneve optike, — tha ai. — Jeni gati të dashuroheni me një personazh libri. Megjithatë kam një vërejtje të vogël për heroin tuaj. Me gruan sikur nuk mund të përputhej. Si shpjegohet kjo?

— Gruaja e tij ishte një rrëkezë e vogël mikrobor-gjeze. Betyni ishte oqeani i madh dhe i fuqishëm. Te disa njerëz përmblidhen mijëra të tjerë. Unë po të isha në vendin tuaj në fakultet, do t'i detyroja studentët ta lexonin e rilexonin këtë libër, — tha ajo.

— Vërtet? Dëshëron të vish në fakultet? Po ndofta kjo nuk éshtë një èndërr e parealizueshme.

— Më keqkuptuat, profesor.

Margarita ngriti qerpikët e gjatë. Sytë iu rrudhën pak nga një nënqeshje e lehtë. Gjergji e shikoi pa u ngutur. Po megjithatë u drodh. Ai s'desh ta besonte ftohtësinë e akullt të vështrimit të vajzës!...

Atë kohë dera e sallës u hap me vrull. Një grua e re me një vështrim të përhumbur u sul drejt Margaritës.

— Më ndihmoni. Djali s'është mirë.

Gjergji ngriu. Iu mblodh një lëmsh në fyt.

— Suzana! — pëshpëriti ai pa zë.

Gruaja as që e vuri re.

Gjergji deshte të thërriste përsëri. «Suzanë!» —

Po shtrëngoi gjuhën ndërmjet dhëmbëve.

Suzana kishte shtangur në këmbë dhe vështronte me sy lutës Margaritën. Nishani i zi mbi buzë i dukej më i madh nga të dridhurit e pavetëdijshëm.

Ata shkuan në dhomën e djalit.

Gjergji lëkundej si i dehur. Dëshironte të shihte edhe më ftyrën e gruas me nishanin e zi. Po Suzana i ktheu shpatullat. U përkul mbi djalin dhe zgjati dorën, mbi ballin e ftohtë.

— Çfarë ka, ju lutem, më thoni çfarë ka?

— Mos u shqetësoni. Asgjë!

— Si është puna Margaritë? Më thuaj të vërtetë, si është puna? — pyeti ajo e munduar nga brenga, dhe nuk e ngriti kokën të vështronte Gjergjin.

— Mblidhe veten, — tha Margarita e tronditur. — Ti je guximtare? A nuk më ke treguar vetë që je guximtare! Përse alarmohesh kot?

Gjergji mbeti në mes të dy grave i huaj dhe gadi i harruar. Suzana s'ktheu asnjëherë kokën nga ai, sikur të mos ekzistonte fare. Gjergjit iu përtéri e gjithë e kaluara.

\* \* \*

Mëngjezi i parë i jetës së tij si mjek. Ai përshkoi ngadalë shtëpitë e përgjumura të qytetit. Hyri në klubin e vogël plot me njerëz të panjohur.

— Një gotë raki!

— Si urdhëron doktor!

Gjergji ngriti kokën. Buzëqeshi hidhur. «Ç'dreq doktori jam unë!» Në këtë vend të largët e të humbur kishte disa ditë që e mundonin mendimet si grera të mërzitshme dhe ai i përzinte:

... S'është e vërtetë që e kanë fyter, që e kanë fla-

kur në këtë qytezë minatorësh si një ashkël pa vlerë. Po sado që mundohej dhe vriste mendjen, për të gjetur kush ja kishte bërë këtë nder, sado që kërkonte të dinte si ishte e mundur ta degdisnin atë, që kishte ardhur nga Evropa me titullin «kirurg» në këtë skutë të humbur, ku ha pula gurë, ndërsa dhjetra të tjerë që mezi kishin marrë provimet, duke u rrëzuar nga dy e tri herë në një lëndë, kishin mbetur në Tiranë, nuk e gjente dot. Ku mund t'i gjendej filli kësaj pune! Ishte e kotë. Të dërgojnë në këtë «qytet» qesharak me njëzet shtëpi punëtorësh të njëlljoja: «Hajde vëlla, shko! Detyra, humanizmi... shpëto jetën e njerëzve». «Po dale more shok, unë nuk di asgjë për vete». «Hajde, hajde prandaj e ke marrë diplomën të shkëlqyer». «Po duhet të paktën një mjek i vjetër afër». «Lëre modestinë mënjanë, shok» «Epo mirë»... ja si vjen puna. Qërrro sytë po deshe. Këtu nuk ka ende një spital rural për të qenë. Të çuditshme janë edhe këto mendime që të lëvrijnë si mijra rrëkeza të padukshme. Ai donte t'i mërgonte diku larg tij... Po... Ja ku rrinte atje i humbur në një qoshe! Në hyrje u duk një grup djemsh, veshur me gozhupa, që bënin shaka me njëri-tjetrin. Bashkë me ta ishte edhe një vajzë e gjatë, me një nishan të zi, veshur me pantallona kadife dhe pallto të shkurtër prej gëzofi, e me kapuç të bardhë prej leshi.

- Tungjatjeta Gaqo!
- Tungjatjeta, djema!
- Ç'kemi ndonjë gjë për të ngrënë?
- Mish zogu!
- Çaj të ngrohtë ke? — pyeti vajza.
- Kam.
- Më bëj një.
- Ne duam konjak, — thanë djemptë.
- Ku nxiton kështu moj çupkël! S'kemi hapur ende sytë.
- Lëri shakatë Gaqo! Kemi shumë punë sot, — tha ajo pa kthyer kokën.

— Si urdhëron!

Vajza e rrufiti me gllënka të mëdha gotën e çajit, ndërsa djemtë përpinqnin gotat. Pastaj u larguan pothuajse me vrap. Pas pak u dëgjua zhurma e një motori, dhe asgjë. Gjergji iu afrua kamerierit.

— Cila ishte ajo vajzë?

— Vajza jonë!

— Duket vajzë e shkathët.

— Ka lindur dhe është rritur këtu, kur krahina jonë ishte ende një fshat me disa shtëpi.

— Si e quajnë?

— Suzanë. Prindërit i kanë vdekur që në kohën e tërmetit. Atëherë tërmeti bëri kërdinë, sepse ishte dimër, sepse ishim vetëm dhe të varfër. Ata që shpëtuan nga tërmeti, mezi ia dolën të ftohtit e urisë. Ne atëherë as që kishim parë me sy mjek. Vajzën e rritën kushërinjtë dhe e dërguan në shtëpinë e fëmijës... Po ajo u kthye këtu te ne.

Gjergj Vasili zbriti në rrugë. Tufani i natës kish te ngritur pirgje dëbore, si kodra. Pas tyre ecte një varg i madh njerëzish. Ata ecnin duke bërë një zhurmë të lehtë, sikur shkelnin mbi sheqer. Dëbora ishte e shkrirë. Turma u zhduk shpejt brenda gjysmë ore, sikur e përpiu dheu. Ai mbeti vetëm. Herë pas here kthente kokën. Nuk dallonte gjë, veç gjurmëve të mëdha që linin këmbët.

U fut në dhomën e vizitave. Një ndihmës mjek. Dy infermierë. Ky ishte i gjithë personeli.

Një copë herë Gjergji rregulloi dollapin me xhamë. Pastaj vendosi veglat e kirurgjisë. Psherëtiu. Mblodhi gjithë dokumentat, i futi në sirtar dhe u ul në poltronë. Cili do të ishte ai pacient fatkeq, që do t'i binte në dorë për herë të parë?

Dera u hap pa trokitur. Në dhomë hyri infermieri, që solli me vete një rrymë të ftohtë ajri. Doktori ngriti sytë me përtesë nga flaka e zjarrit.

— Vigun!

— Përse?

— Aksident.

— Kjo na duhej për të filluar karierën, — tha ai duke sharë nëpër dhëmbë.

Gjergji u trondit. Para tij shtrihej e këputur po ajo vajzë me kapuç të bardhë, që kishte parë në mëngjez.

— Si ndodhi?

— Kishte hipur në majë. Në uzinën që ndërtojmë buzë lumi.

\* \* \*

Gjergji u ngjit në dhomën Nr. 6 më shpejt se netët e tjera. Vajza ishte e lodhur. Dukej më e hollë se zakonisht, e zbetë. Këmbën e thyer ia kishin vënë në allçi. Rrinte shtrirë. Nuk fliste. Mbante sytë myllur. Ai e dinte (kishte lexuar kaq shumë libra këto kohë) që plagët ndikojnë në gjendjen shpirtërore të të sëmurëve. Ajo dukej e gëzuar vetëm kur vinin punëtorët e kantierit të ndërtimit. Ai çuditej sa shumë njërrëz vinin për ta parë vajzën. Nuk ishte në gjendje t'i ndalonte. Ata qëndronin të drojtur para saj, sikur të ishin fajtorë. Ajo pyeste për gjithshka, për betonimin e oxhakut, për montatorët, për punën dhe për shokët. Pastaj heshtte. Më shumë nga të gjithë Gjergjit i bënte përshtypje një djalë me trup atleti, me sy të pastër si të fëmijëve, me vetulla të trasha, të zeza.

— Do të eci si më parë? — pyeti ajo, sapo pa në derë doktorin.

— Sigurisht!

— Mërzitem. Shokët punojnë edhe për mua. Pirrua dhe Gazmiri bëjnë nga tre norma. Po kjo s'mjafton!

— Cili është Pirrua, ai me vetulla të trasha?

— Po. Nuk mund të rri më shtrirë.

— Do të ngriheni shpejt.

Gjergji e vështroi me vëmendje. Ajo dukej shumë e re.

— Ju kam zili — tha.

— Përse?

— Në këtë moshë njeriu mendon se është i pavdekshëm.

Vajza u gjallërua.

— Ose i pëlqen të fluturojë... nuk ve re trarët e akullt... shkel mbi ta pa të keq.

Suzana filloi të qeshë.

— I keni rënë më të. Më pëlqen të fluturoj, po jo në quell!

Gjergjin e thirrën për një të sëmurë tjetër. Brënda atij muaji në spital qenë shtruar edhe njerëz të tjerë. Ai nuk u vonua shumë. Kalonte nëpër koridor dhe i dukej sikur përpara po hapej një botë e re, e freskët, intime. Ora ishte ende njëmbëdhjetë. Qyteti i vogël dukej sikur dremiste nën peshën e dëborës.

Suzanën s'e kishte zënë gjumi. Kokën e mbante kthyer nga muri.

— Natën e mirë Suzanë! Doni të flini?

— Jo. Dua të shoh këto projekte. Shokët mendojnë të shpejtojnë punimet.

— Edhe mua s'më zë gjumi. Po ju duhet të pushoni.

— Më mori malli për qytetin. E kemi ndërtuar vetë.

— Qytet për të marrë malli!

— Unë e dua tamam si nëna fëmijën.

— Pse nuk vazduat fakultetin? Roli i nënës nuk ju shkon fare, — pyeti Gjergji.

— E vazhdoj me korespondencë, — tha ajo. — Edhe Pirrua e vazhdon bashkë me mua, vetëm se ka zgjedhur një degë tjetër. I pëlqen të bëhet inxhinier mekanik. Merreni me mend si do të jetë ky qytet pas disa vjetësh.

— Bravo! ç'guxim! Ju po më çudisni Suzanë. Më dukeni si ca heronj romantikë që shkojnë në shkretëtira!

— Më ka tërhequr pasioni i ndërtonjësit. Ky është një pasion i fuqishëm që të bën të lumtur.

Gjergji ishte ulur në krevatin bosh. Mendonte përvete: «Do të zvarrisen vitet, do të thinjem, do të matufepsem dalëngadalë nga tekat e këtij qyteti të vogël, që nuk është vendosur ende në hartën e Shqipërisë. Thua do të ngryset gjithëjeta kështu?» Aty afër ishte shtrirë një vajzë e re. Ai mund të zgjaste dorën dhe... E çfarë?

— Ndërtonjëse, keni bërë një gabim, — tha duke u ngritur me rrëmbim.

— Çfarë gabimi?

— Nuk ndërtuat një spital të ri!

— Prisnim doktorin.

— Ashtu?

— Po, edhe një doktor energjik!

Gjergji mbeti një hop i menduar. Pastaj pyeti befas:

— Po unë si të dukem?

Suzana i hodhi një vështrim të butë dhe tha si me vete:

— Është ende shpejt të gjykojmë për ty, doktor!

\* \* \*

Të gjitha dritat e qytetit shuhën zakonisht në orën dhjetë. Vetëm dritarja e dhomës së Suzanës mbetet si një sy i hapur në errësirë deri në orët e vona. Që kur u shërua Suzana, Gjergji, ajo dhe Pirrua punojnë së bashku. Gjergji vjen shpesh për t'i parë dhe e ndihmon Suzanën në projektin e spitalit të ri. Dhoma e vajzës ishte e thjeshtë. Një fotografi e Suzanës midis shokëve montatorë, në një kornizë të vogël, të ndritur, ishte luksi i vetëm i saj. Suzana vishej gjithnjë pothuaj njësoj. Pantallona të zeza, pullover të trashë. Projekti i spitalit po përfundonte. Gjergji priste që të fillonin sa më parë nga zbatimi i projektit. Po vendi? Duhej gjetur një vend i përshtatshëm, të mos përfundonte puna vetëm me një fletë lavdërimi, apo me një të rra-hur të krahëve: «djalë energjik».

— E gjeta!... — murmuriti me vete. Vendi më i mirë është kodra në hyrje të qytetit.

— Në hyrje? — pyeti Pirrua.

Ai mbeti ashtu i menduar, sikur peshonte diçka. Pastaj vazhdoi punën pa e ngritur kokën.

— Nuk më duket, — tha pas pak Suzana.

— E ke gabim. Atje do të ngremë edhe një pyll të vogël. Një park, që të pushojnë të sëmurët, — ngulli këmbë Gjergji.

Suzana heshti. Një copë herë ata ndoqën secili rrjedhën e mendimeve të veta. Pirrua përpinqej të ishte i qetë. Po nuk mund të ishte. I dukej se Suzanën e kërcënonte një rrezik. Përse mendonte ashtu? Ndofta sepse ata ishin mësuar me njëri-tjetrin, që në shtëpinë e fëmijës, po tashti papritur kishte hyrë midis tyre një i huaj!

— Si janë pacientët tuaj? — theu heshtjen Suzana.

— Mirë.

Pas një copë here ai shtoi:

— Të thuash të drejtën, u lodha.

— Kaq shpejt? Po ju keni ende një rrugë të gjatë për të bërë, doktor — tha Pirrua.

— Ndofta. Megjithatë u lodha (deshte të thoshte: së prituri përqapjet e nënës sime poshtë e përpjetë nëpër ministri. Ajo kërkonte vazhdimisht t'ja sillnin djalin pranë... se e kishte të vetëm).

— Në se ju lodh projekti mund ta lëmë, — tha Pirrua.

— Jo! Jo...

Ai deshte të shtonte që te spitali i kishte të gjitha shpresat për të shpëtuar nga vëtmia, për të fituar jetën e vërtetë si kirurg. Po nuk tha asgjë.

— Nesër mund të bisedoni me kryeinxhinierin. Projektin e kini gati, — tha Pirrua.

— Faleminderit.

— Unë do të nisem për në harruar, — tha Suzana.

Gjergji iu afrua tryezës. Vajza i shpjegoi duke i treguar me laps të gjitha dhomat.

— Salla e operacionit ka shumë dritë. Ju pëlqen?

Gjergji pohoi me kokë. Vazhdoi të shihte lëvizjet e shkathëta të duarve të saj. Duke e vërejtur iu duk si një zog i vetmuar, i dobët, që përpëlitez. Hunda kryeneçe, sytë e errët dhe flokët prerë si djalë. Jo! Kjo nuk ishte nga ato femra mëndjelehta; që duan të bien në sy.

— Projekti mbaroi. Merreni, — tha Pirrua.

Gjergjit s'i pëlqeu toni i ftohtë i zërit të tij dhe rrudha e vogël në ballë. U përshtendet me ta dhe doli në rrugë. Shtrëngonte atë tub të hollë letre, ku mbësh-teste aq shpresa. Suzana e përçolli. Mbeti te dera. Atij i erdhi që ta rrëmbente në krahë e ta ngrinte lart, po nuk bëri veçse një përkulje të lehtë.

— Mos u vono shumë andej, sepse unë kam filluar të bëhem xheloz, — i tha befas dhe çau drejt errësirës.

\* \* \*

Po Suzana u vonua. Gjatë kësaj kohe, ai punoi me ngulm. Nuk kishte kohë të mendonte. Spitali donte punë. Zbatimi i projektit kërkonte vullnet. Ai u përzie me ritmin e jetës së minatorëve që jetonin rrëzë malit dhe njerëzve që ngrinin çdo ditë e më lart oxhakun e uzinës. I kishte gjykuar kot e pa i njohur, vetëm tashti kuptoi se i gjithë pulsi i këtij qyteti ishte i shqetësuar.

Mbaroi ora e vizitës. U ndje zilja e telefonit.

— Alo!...

Zëri vinte nga larg si më drithërimë.

— Suzana!

— Si shkon puna me «spitalin tonë»?

— Pirroja është një djalë i shkëlqyer. Punon sa përdhjetë veta!

— E shikon?

Megjithatë ai nuk e donte Pirron. Nuk e pëlqente

mënyrën se si e ruante Suzanën prej tij. Ai e kuptonte që Pirrua e dashuronte Suzanën. Dhe kjo i sillte bezdi. Po nga ana tjetër ai nuk e kuptonte dot as veten e tij! Përse nuk i linte të qetë këta të rinj? Përse donte të hynte medoemos në mes të tyre?

- Kur do të kthehesh?
- Po nisem... Në ora nëntë jam aty.
- Mirëupafshim, Suzi!

Gjergji ndjente diçka, sikur i merreshin mëndtë. Ai e ndjente se shkonte drejt Suzanës pa menduar më tej. Megjithëse thellë ai e quante atë kokëshkretë, të çuditshme dhe të pakuptueshme. Zbriti në klub. U drejtua nga banakieri. Sytë e tij të vegjël ndiqnin me vëmendje.

- Një shishe verë «Malaga»!

Gjergji mori shishen. Doli nëpër rrugët e qeta. Ora tetë pa një çerek. Mendonte. «Do të shkojmë në shtëpinë e Suzanës. Do të bisedojmë. Kështu është më mirë se sa të rrish të thartosh trutë me libra». Përveç librave mjekësore, që ishin të domosdoshme, ai nuk lexonte asnë libër tjetër. E kishte gjetur ku të kapej për të arritur atë që mendonte: «Spitali i ri që do të sundonte gjithë qytetin, gati në lartësi me oxhakun e uzinës. Njerëzit do të kalonin rrëzë këmbëve të tij... Dhe përpjekjet e dëshpëruara të nënës s'do të shkonin kot. Më në fund ai do të kthehet në shtëpinë e tij».

Hyri në dhomë. Po vishej.

Në derë u dëgjua një trokitje e lehtë.

«Erdhi.»

— Je trime Suzanë! — i tha kur po dilnin në rrugë.

— S'kam bërë ndonjë heroizëm — qeshi ajo!

— Nuk ke frikë të shëtisësh vetëm në këtë orë? Kur gjithë vajzat e urta flenë. E di? Kisha një shoqe që dëshironte të ishte djalë.

— Pse?

— Djemtë janë të lirë! Kurse është s'na lenë të qetë

llafazanët, intrigantët, njerzit e vegjël që ushqehen me fjalë e shpifje si çakenjtë që ushqehen me kërma — thoshte ajo. Pastaj shtonte «Dua të jetoj pa u futur në guaskë. Dua të thyej vargonjtë e opinionit, që të mbajnë mbërthyer. Dua të bëj kryengritje!»

Këto fjalë sigurisht i kishte lexuar në ndonjë libër. Se në të vërtetë ishte vajza më e drojtur dhe më e pafuqishme. Megjithatë donte të bënte kryengritje! Si mendoni nuk janë qesharake ato gra që flasin me fraza të mëdha për lirinë, për personalitetin, për emancipimin ndërsa vetë fshihen prapa kurrizit të burrave të tyre si t'ishte kjo një barikadë?

Gjergji qeshi. Pas pak pyeti.

— Si duket puna e uzinës?

Ngrihet gjithnjë lart — tha Suzana e menduar dhe iu kujtua Pirrua. Ato ditë ai ishte larguar dhe qëndronte si i huaj me të. Përse? Ajo nuk e kishte fyer asnjëherë, ndërsa ai i shmangej, përpinqej të mos e takonte.

— Ç'ju ra ndër mend të fillonit ndërtimin e uzinës në mes të dimrit?

— Ç'pyetje? Edhe një nxënës i klasës së parë e di që ne nuk jemi punonjës stinorë.

— Po tashti është aq vështirë dhe ty të kanë ngirrë duart, Suzi.

— Uzina e përpunimit të bakrit është e domos-doshme për këtë qytet minatorësh. Duhet të mbarojë sa më parë. Dhe ne do t'a mbarojmë. Tek ne vijnë cdo ditë vullnetarë edhe nga kooperativat bujqësore!

— Bravo!... Po duket duan të shpijnë kockat. Njerëzit e bujqësisë tashti kanë pushim!

— Gjergj. Pse flet sikur ke zbritur nga retë. Njerëzit e bujqësisë nuk kanë pushim. Ata duan të ndërtojnë, të gjithë kanë dëshirë të ndërtojnë. I gjithë atdheu është një kantier i madh ndërtimi.

— Suzanë ti the se s'të pëlqejnë gratë që flasin fjalë të mëdha.

— Kjo është e vërtetë. Nuk më pëlqejnë. Po unë flas ato që ndjej... që i ndjej shumë thellë — tha ajo.

Vajza e ngadalësoi hapin dhe u hodh anës së rrugës. Dritat e një maqine si prozhektorë shponin errësirën. U duk rruga e shkelur nga mijëra këmbë. Ata u ngjiten përpjetë në kodër, ku ishte ngritur skeleti i «Spitalit të ri». Poshtë shtrihej qyteti që ende s'kishete marrë formë. Dritëzat e vogla të apartamenteve lëviznin si xixëllonja.

— Shiko ç'pamje interesante do të kini çdo ditë parasysh — tha ajo.

Gjergji mbeti një copë herë i menduar.

— Nuk është keq.

— Sa herë hapim themele, sa herë vendosim piketa mendoj se ndër to do jetojnë ata njerëz, që dikur flinin mbi fier.

— Ata as që do mendojnë për ndjenjat e hollatë ndërtuesve...

— Më vjen keq. Ç'është ky mosbesim? Përse mathyeni èndrrën?

— Sepse ne po ndërtojmë një spital ku edhe do vdesin.

Pas këtyre fjalëve sundoi një heshtje e gjatë.

— Dua të jesh më realiste, Suzanë! Ta shohësh botën ashtu si është, dhe jo si èndërrojmë të jetë.

Prapë heshtën. Pas një copë here Gjergji pyeti:

— Ke të ftohtë?

— Pak.

— Kthehemë në shtëpinë tënde? Apo duhet t'i marrim lejë Pirros? Ai më duket është bërë zheloz. Sa herë më sheh zverdhet dhe mezi e përmban veten.

— Jo — tha ajo. Unë më Pirron s'kam asgjë! — po megjithatë s'i erdhi mirë që Gjergji foli për Pirron.

U kthyen. Ajo ecte përpara, ai pas dhe mbulonte me këpucët e tij të mëdha gjurmët e lehta e të vogla, që linin këmbët e vajzës.

\* \* \*

Pranvera po zbriste ngadalë dhe zgjonte natyrën e përgjumur e të ngrirë. Ndjehej aroma e borës së shkrirë, vërvshimi i ujrave, kërcitja e akujve që çaheshin.

Suzana dëgjoi zërin e Gjergjit në receptor.

— Alo... Alo... Sapo u ktheva nga kryeqyteti. Dua të të shoh! Kur do të mbarosh?

— Nga ora dympëdhjetë, — tha ajo.

— Nuk mundesh më përpara? Harrove që sot është ditë pushimi?

— Jo, jo... Nuk e kam harruar. Po s'mund t'i le brigadat vullnetare pa udhëheqës. Edhe ata kanë ditë pushimi. Pse kur punonin për spitalin tënd, s'kishim ditë pushimi, — qeshi ajo.

— Si të duash. Unë do të dal të pres.

Suzana la receptorin. Ishte e turbulluar.

Pranvera erdhi aq papritur!

Kur mbaruan brigadat vullnetare ajo s'deshte të kthehej me maqinë. U nis në këmbë. Ajo kishte kaluar aq herë nëpër atë udhë kur kishte qenë e mbuluar me dëborë. Ndërsa tashti drurët ishin në atë çastin e mrekullueshëm të zgjimit të jetës, kur sythat janë në përgjim dhe të duket se do shpërthejnë brënda një çasti.

Suzanën po e dehte era e pyllit. Ajo ecte lehtë. Gjethet e vogla e delikate të spërkatura nga vesa luanin një melodi të ëmbël, të bukur. Ajo i dëgjonte. Këndonte. Në të vërtetë s'këndonte me zë, por brenda shpirtit të saj ndjente tingujt e melodisë së ëmbël përkëdhelësse, të pastër dhe gati të kristaltë. Edhe në shpirtin dhe në trupin e Suzanës po lulëzonte pranvera.

Jehet vinin thellë-thellë dhe mbushnin pyllin dhe zemrën me tinguj drite.

Ajo ecte nëpër udhën e shtruar të pyllit. Mendonte për Gjergjin. A e shikonte ai atë shpërthim? A e

ndjente sa bujare dhe e bukur ishte jeta dhe dashuria?

Këtë ajo e tha me zë të lartë dhe pa rrëth e rrotull e hutuar.

Oshëtima i përsëriti edhe një herë fjalët e saj. Suzana u ul e këputur mbi degën e një trungu të prerë. Ajo vështronte si e habitur atë copë quell aq të kaltër e të kthjellët, ndjente qetësinë dhe zhurmën e lehtë të pyllit, shikonte barin e njomë si një qilim i gjelbër dhe përsëri përbrenda dëgjonte tingujt e asaj këngës së pastër që këndonin sythet në shpërthim. Një drithërim i lehtë i përshkoi gjithë trupin dhe e bëri më të ndjeshëm shpërthimin e ndjenjës së re. Ajo s'mund të përfytyronte se çdo të ndodhët më vonë. Ajo vetëm mund të thoshte që edhe dashuria ngjante me sythet e kësaj pranvere. Zgjati dorën. Dhe vetëm atëherë ndjeu se në krye të rrugës Gjergji po vinte drejt saj.

— Suzanë! — i thirri Gjergji, gjithë gëzim.

Suzana mbante një lule margarite në duar. Luannte me fletët e saj.

— Suzanë! Diskutimin tim e pëlqyen shumë.

— Pra e kalove provën me sukses? — tha ajo pa e pasur mendjen aty.

— Ishte një provim i shkëlqyer. Folën edhe ata të ekipit që erdhën para disa kohe në spitalin tonë, dëgjon? Ata e quajtën si një spital shembullor dhe mua më mbuluan me një thes lëvdatash.

— Prandaj të qenkan rritur pendët, — qeshi Suzana.

— Jo! Nuk është puna aty. Çdo njeri ka synimet e tij në jetë... Dhe unë po të them, se jam më afër se çdo herë tjetër synimit tim. Çdo gjë e kam paramduar. A të kujtohet kur të thashë se duhej të ngrihej spitali në një vend që të bjerë në sy? Dhe ja vërtet spitali ynë në kodër, me atë park të bukur, me pisha të drejta, me sallën model të operacionit, me diktarën time për një rregull të rreptë dhe të përsosur,

ishte filli ku u kapa. Dhe pér këtë të falenderoj ty, Suzanë. Ti më mësove se ç'duhej bërë pér të dalë nga ajo platinje dhe hutim që kisha kur mbarova studimet.

— E pastaj? — pyeti ajo. — Ti spitalin nuk e ndërtove pér vete, por pér punëtorët tanë.

\* \* \*

Doktor Gjergji vinte rrotull nëpër sallë si një luan i zënë në kafaz. Të gjitha dritaret e sallës së operacionit ishin mbuluar me një tyl të hollë e nuk linin të dukej asgjë. Po doktori as që kishte ndër mend të shikonte jashtë.

«Suzana do të lindë fëmijë...» Kjo i ishte ngulur si një gozhdë në tru.

Nuk mund t'ia falte vetes këtë marrëzi. Ç'ishte ky fëmijë, si një bubullimë në mes të një dite të ndritur!... Po fundi ai nuk ishte ende fëmijë. Nuk do të vrashim njeri. Jo është një paragjykim të mendosh pér sentimentalizma të kota. Ai po ia arrinte qëllimit të tij. Së shpejti do të largohej përgjithmonë nga kjo skutë e largët. Dhe ja ku na del një fëmijë!

«Po ajo është aq e çuditshme, a thua do të pranojë?» Ai do të flasë hapur me Suzanën.

Ajo e shikon botën me sytë e një njeriu të dashuruar. Çdo gjë i duket e bukur. Por jeta ka edhe një realitet tjeter të egër, i cili të bën ta ruash fort lëkurën tënde. Ç'pandeh ajo? Se është lumturi e madhe që të të zbardhen flokët nëpër skela duke ndërtuar qytete?! Naivitet! Po megjithatë ai i druhej Suzanës, sepse ajo kishte sy të mprehtë dhe shihte deri në fund të shpirtit. Gjergji mundohej gjithnjë të tregohet më i mirë se ç'ishte në të vërtetë. Përse e bënte këtë gjë? Që t'i pëlqente asaj? Po! Por më në fund ai do të fliste hapur... Ai do t'ja shpjegonte Suzanës. Jo vetëm se nëna e Gjergjit është tmerruar nga Suzana, por edhe ai vetë.

Ish te têrhequr drejt Suzanës ashtu si têrhiqet njëriu gjithnjë nga e panjohura dhe e rrezikshmja.

Jo. Suzana duhet ta kuptojë. Ai thoshte kështu megjithse i druhej asaj. I trembej jetës së saj të rrëmbyer, pasionit për të ndërtuar, kokës së krisur. Ai i trëmbej asaj, prandaj druhej t'i fliste.

Ai s'mund të martohet me një Suzanë! Po përsë e bëri një gabim të tillë? Përsë e têrroqi vajzën në këtë qorrerek? Jo! Në të vërtetë nuk e têrroqi ai. Suzana vetë u dashurua me të. Ajo ishte e çuditshme, as që bëhej merak dhe u thosh të gjithëve se e dashuronte. Bile edhe Pirrua për të mos humbur miqësinë e saj ishte i detyruar ta pranonte ndjenjën e Suzanës. Dhe të gjithë djelmoshat e brigadës së Suzanës e respektonin Gjergjin nëpërmjet saj. Po ç'do të ndodhë sikur ta merrnin vesh të vërtetën? Ata e quanin Suzanën «motra e shtatë vëllezërve» dhe Gjergji e kishte vënë re se ata nuk lejonin t'i prekej asaj asnjë fije floku! Ç'duhej të bënte? E gjitha varej nga qëndrimi që do të mbante ajo!

«Kjo periudhë e errët e plot ankth do të mbarojë shpejt... Ajo nuk është aq e çmendur sa të marrë nëpër këmbë jetën e saj dhe timen. Kurse kjo punë është aq e thjeshtë. Unë jam kirurg, Suzana duhet të pranojë.»

Gjergji do të çlirohet. Detyrim nuk do të ketë më. Do të jetë i lirë. Liria është privilegji i burrave. Natyra vetë e ndërttoi njeriun në këtë mënyrë. A mund t'i shpinte ai nënës një provinciale me pantallona? Kjo është krejt e pamundur. Do të ishte vërtet një skandal për gjithë rrëthin e tij: për nënën, për motrën... Po më shumë për Gjergjin vetë. Suzana nuk ishte për jetën e kryeqytetit.

Po sikur të mos pranojë Suzana?

Po sikur të jetojë fëmija? Sikur ai të detyrohej të martohej për shkak të këtyre rrëthanave?

Si do të vepronate? Si?...

\* \* \*

Suzana u kthye shpejt atë ditë. E lajmëruan që e kërkonin. Ajo zbriti shkallët e menduar. Donte të tregohej e gjëzuar. Po kjo ishte e pamundur. E përshëndeti ftohtë, aq sa u çudit dhe vetë. Gjergji u drodh po nuk e dha veten. Ecën një copë rrugë të heshtur. Lanë prapa krahëve kodrën dhe ndërtesën e spitalit ngritur me aq pasion nga të dy.

— Ku do të shkojmë? — tha ai.

— Nuk e di — u përgjegj ajo.

Gjergji s'bëri më pyetje të kota. As që ktheu kokën. Hidhërimi ishte vijëzuar në të gjitha tiparet e Suzanës. Gjergjit i dukej se ecte mbi gjemba.

— Përse u vonove kaq shumë? Pyeti më në fund sa pér t'u gjendur në fjälë.

Vajza ishte dobësuar. Dukej e lodhur. Sytë i shkreptinin me një vendosmëri të çuditshme. Ai e ndjente se ajo diçka bluante, por e mbërhente dhe e mbante të mbyllur.

— Suzanë! — foli ai.

Vajza heshti një copë herë.

— Shiko Suzanë, s'kemi përse të luajmë dhe t'ia fshehim mendimet njëri-tjetrit.

Ajo kishte ditë, që e priste këtë. Në fillim u zverdh, po e mori veten. Gjergji shikonte shpatullat e dobëta të vajzës...

— Shiko Suzanë. A je në gjendje të bësh një sakrificë pér lumturinë tënde! Fëmija do të na e prishë të dyve të ardhmen! Po të marrin vesh shokët e kolektivist, sidomos Pirrua, do të tronditen dhe do fillojnë nga zhurmat, mbledhjet e ku ta di unë çfarë! Po ti e di që të gjitha janë të kota, sepse s'mund të kriohen familjet me mbledhje dhe zhurma. Kjo është një çështje krejt personale dhe na përket vetëm ne të dyve. Shokët e tu mund të bëjnë vetëm një gjë: Të më ngulin pér jetë këtu.

Po unë nuk dua të rri këtu Suzanë. Tashti çdo gjë

është rregulluar. Ti je e re dhe Pirrua të dashuron. Tashti ti duhet të më kuptosh sepse je vajzë e zgjuar. Duhet të ndjesh dhe të kuptosh synimet e mia. Nga ana tjetër nuk mund të shqelmosh të ardhmen tënde. Pirrua do të ta falte dashurinë time, po të mos ishte në mes një fëmijë i huaj...

— Ç'thuas kështu Gjergj?

— Do të shtrohesh në spital, dhe të abortosh. Këtë s'do ta marrë vesh asnjeri.

Suzana ndejeti një copë herë e heshtur. Sa të gjata iu dukën Gjergjit ato çaste!

— Unë do ta rris vetë fëmijën time. Dhe ti, Gjergj Vasili rri i qetë, as unë, as kolektivi s'do të të biem në qafë. Shko ku të duash! Je i lirë... — tha ajo me mundim të madh.

— Suzanë! Ti s'je në vete! Po a e di ç'do të thotë kjo për ty?

— Çfarë kërkon nga unë?! — briti Suzana.

Doktor Gjergji u çudit. Suzana brenda atyre çasteve kishte ndryshuar krejt. Në sytë e saj kishte kaq përbuzje, kaq neveri, sa ai u drodh.

\* \* \*

Muajt e tjerë që kaloi në qytetin R. doktor Gjergj i mbeten si një vizion i çuditshëm. A i erdhi mirë që puna përfundoi me kaq? S'dinte as vetë se ç'të thoshte. Asnjeri s'mund ta akuzonte për gjë, sepse Suzana heshti. Megjithatë ai kishte frikë. Kishte shumë frikë. E ndjente veten si një njeri, që ka rrëshqitur buzë greminës dhe ka shpëtuar për fat.

Gjergji shkonte kokëular nëpër rrugët e këtij qyteti që s'e kishte dashur asnjëherë. Dhe priste si i etur ditën, kur do të largohej njëherë e përgjithmonë nga këto mure, nga këto rrugë, nga ky spital, që e qortonte në heshtje.

Trokiste dera. Vraponte dhe priste mos i vinte ndonjë ftesë gjyqi. Po ftesë nuk i erdhi asnjëherë. Nuk

i besohej që Suzana do të heshtte. Po, ajo heshti. Dhe mbeti para syve të tij gjithnjë e pakapshme, gjithnjë sikur e vërente nga lart duke buzëqeshur me përbuzje. Ai e dinte se sa shumë mund të përbuzte ajo, sepse e dinte dhe sa thellë dashuronte ajo.

Ai eci në rrugën e tij ashtu si mendonte. U kthyte në qytetin e lindjes. Dhejeta bëri punën e saj. Tashti ka gjithshka që kishte lakmuar. Është kirurg i njojur në kryeqytet, dhjetra studentë dalin çdo vit nga duart e tij.

Që atëhere nuk e takoi më Suzanën. Dëgjoi se e kishin parë nëpër kantiere. Pas disa kohësh dëgjoi që ishte martuar me Pirron. Kaq. Nuk kishte guxim të pyeste më pér të.

Por ja ku qëlloi ta takojë edhe një herë. U panë përsëri. Ai i dëgjoi zërin. E pa si u mpi nga përbuzja. E pa si i dridheshin lehtë shpatullat. Ndjeu urejtjen e saj.

\* \* \*

Djali ishte ende në gjumë. Suzana me Margaritën i qëndruan mbi kokë gjithë natën dhe ruajtën lëvizjet e tij. Një lëvizje sado e vogël mund t'i shkaktonte hemorrhagi cerebrale.

Ndërsa Gjergji gjatë gjithë kohës bënte roje në spital. Kontrollonte të plagosurit dhe ndalej para dhomës Nr. 6.

Margarita dhe Suzana bisedonin.

Në rrugën, që apo ishte hapur nga dëbora, përparrë portës së hekurt të spitalit po vinte një grup punëtorësh. Gjergji njoju Pirron, pastaj shoferin, Gazmirin. Dhe iu duk sikur po e fshikullonin me kamxhik. U bë nervoz dhe i paduruar.

Shokët e Suzanës hynë në koridorin e heshtur. Prrua ishte i shqetësuar.

Doktor Gjergj Vasilit iu kujtua çasti kur i kishte parë para disa vjetësh këta djem të rinj dhe të gëzuar.

Ai u tërhoq që të mos u dilte përballë. U përpoq të shikojë me bisht të syrit. Suzanën e mbante pér supash Pirrua. Gjergjit i mbeti një përfytyrim i qartë i të gjithë tipareve të saj, deri në hollësira. «E fortë. E papërkulshme, dhe atë njeri, tek i cili ka mbështetur supin, ajo e dashuron me pasion, ashtu si mund të dashurojë vetëm ajo, dhe e quan baba të djalit tim...»

— mendoi.

Hapat u larguan. Doktor Gjergj Vasili nuk guxoi ta shikojë as Margaritën në sy.

Margarita ishte aty dhe ai ndjente frysëmarrjen e saj. Por, ajo s'e shihte fare atë.

— C'mendon?! — e pyeti më në fund Margaritën duke e zënë pér krahun.

— Asgjë profesor. Po shikoj rrugën dhe vullnetarët — tha ajo.

Gjergji i hutuar dhe i lodhur ktheu kokën. Në rrugë kishte gjallëri. Lëvizje. Jetë.

Gjergjit i dhimbte koka dhe sikur diçka e mbërtente pér fytin. I dukej se edhe në spital në dhomën nr. 6 ishte futur një pjesë e kësaj jete të fortë dhe optimiste, ndërsa ai duhej të fshihej në hije. Në sytë e kthjellët të Margaritës shkrepëtinte përbuzja!...

— Megjithatë, s'po më thua të vërtetën. Atë që mendon në të vërtetëtë në këtë çast, — tha Gjergji.

— Po jua them: Mbrëmë mësova jetën e Suzanës.

## M È S U E S I

*Kushtuar H. B.*

Gruaja, e zemëruar, thirri sa u ngjir «plak matuf», «rrri, ore, rehat, merr atë copë pension dhe çlodh kockat». Megjithatë ajo vetë e ndihmoi të mbërthente dërrasën e zezë në murin e dhomës. Rregulluan disa karrike të vjetra si banga. Kështu krijuan «klasën». Filuan të vijnë edhe nxënësit, jo kur binte zilja, se zile skishin, por në çdo kohë dhe në çdo orë të ditës. Të çuditshme janë edhe gratë! Megjithëse mallëkonte nëpër dhëmbë «se u bë shtëpia han», «mbeta gjithë ditën me fshesë në dorë», ajo përsëri shoqëronte nxënësit dhe u tregonte klasën. I vështronte me radhë edhe kur i shpinte kafenë plakut të saj quditej sa urtë që rrinin! Sa e dëgjonin! Ajo i njihte mirë të gjithë fëmijët e lagjes së saj, bile qysh kur kishin lindur, qysh kur kishin filluar të belbëzonin.

Mësuesi i kontrollonte, u jepte problema, kërkonte zgjidhjen e tyre, u mbushte boshillëqet dhe, nga njëherë, i rrëmbyer siç ishte, shkonte deri në shkollën e ndonjërit nga «nxënësit» e tij. Bisedonte me mësuesin e matematikës, bisedonte me mësuesin kujdestar; përpiquej t'i drejtonte mësuesit e rinj, të hynin më thellë në karakteret e nxënësve të tyre, t'i nijnin deri në thellësi të shpirtit dhe të mendimeve dhe kështu të punonin me secilin. Mësuesit e rinj pëshpërisnin se

kishin nga dyzet nxénés në çdo klasë dhe ishte e pamundur një punë më e thelluar dhe kërkimtare, po me gjithatë e dëgjonin mësuesin e vjetër. Ai kthehej i lodhur nga këto «ekspedita», ulej në stolin para shkallëve dhe fshinte djersën. Gruaja i sillte kafenë dhe i thoshte me zë të ulët:

— Mos u lodh kaq shumë, more qyqar!

Përgjegjej edhe ai me zë të ulët dhe të plotë:

— S'kam ndër mend të rri i qetë, moj plakë!

Kur mësuesit e tjerë mbyllnin vitin shkollor dhe niseshin për pushime, ai bashkë me plakën e vet nxirrte edhe disa karriga dhe stola të tjera dhe fillonte punën më të vështirë dhe më serioze me nxénësit e mbetur për vjeshtë. Nga kjo punë që bënte mbushej me forca, me energji të reja siç mbushet dhe lulëzon rrapi plak në pranverë. Nxénësit venin tek ai pa ndrojtje, si në shtëpinë e tyre.

Dita fillonte duke përtërirë edhe imtësitë më të holla të jetës së shkollës. Mësuesi hapte derën e «klassës» së vet, i lehtë, gazmor, sikur të ishte një djalë i ri.

— Mirmëngjez!

— Mirmëngjez, profesor! — përgjegjeshin nxénësit.

— Uluni të fillojmë mësimin, — vazhdonte ai me zërin e ulët dhe të plotë.

I pëlqente kur nxénësit uleshin duke pëshpëritur lehtë.

Ai i hetonte me radhë dhe...

— E ke kot që fshihesh, Stefan, thuaj më mirë që s'je prebatitur.

— Po, — belbëzonte nxénësi dhe ulte sytë.

— Ngreje kokën, nuk më thua pérse?

Stefani heshtte.

Nxénësit e tjerë vinin buzën në gas dhe vështronin Stefanin, që ishte bërë si rrepkë e kuqe nga dielli. Mësuesi e dinte, që Stefani kishte qenë në plazh, ai e dinte se deti është një ngasje shumë e fortë dhe Stefanin s'i shpëtonte dot.

Mësuesi i afrohej. I pëshpëriste:

— Bën shumë mirë që kalitesh në diell dhe në ujë. Një sportist i vërtetë duhet të jetë i fortë. Po ama s'duhet të mbetet kurrë pér vjeshtë. Ndryshe do të mendojnë të gjithë se sportistëve u punojnë muskujt dhe jo truri. Kurse kjo s'është e vërtetë, apo jo?

Stefani skuqej gjer në veshë dhe shkruante ushtrimet bashkë me nxënësit e tjerë.

Pranë Stefanit rrinte Vera. Ai e njihte dobësinë dhe frikën e saj nga numrat. Përse matematika e tururonte kaq shumë këtë vajzë?

Ai e dinte që Vera ishte e ngadalshme, e dinte që asaj i qe mbushur koka se ishte «tapë në matematikë». «Jo, jo, Vera! S'ka koka të veçanta pér matematikë. Ka vetëm punë, punë të palodhur dhe këmbëngulëse. S'duhen kopjuar detyrat edhe në qoftë se gjen ndonjë qoshe të fshehtë në oborrin e shkollës, pér arësyen e thjeshtë se s'gjenjen mësuesin, po vetëveten».

Vera punonte në heshtje pér zgjidhjen e një probleme të vështirë. Të gjithë punonin në heshtje.

Nga dritarja e hapur frynte një erë e lehtë dhe dëgjohej shushurima e gjetheve të plepave si të lara në argjend. Rrezet e diellit që depërtonin nëpér gjethet u jepnin flokëve të kuqërrëmtë të Verës një shkëlqim të bakërtë.

Jashtë dritares shtrihej parku. Bari ishte lagur nga vesa e mëngjezit. Dukeshin kolovajzat e braktisura të fëmijëve, që kishin shkuar në kampin ditor si dhe disa statuja të bardha dhe të lëmuara. Përballë tyre bënte hije një rrap i moçëm me lëvozhgë të errët dhe të plasaritur.

\* \* \*

«Sot jam më keq se fillestarët» mendonte mësuesi kur po dilte nga shtëpia. «Ata janë të habitur se shkojnë në shkollë pér herë të parë. Unë jam i paduruar, sepse dua të kem në dorë një klasë të vërtetë. Do të hyj përsëri në mësim duke shtyrë derën, me çantën time dhe me regjistrin».

Ai ecte me hap të lehtë. Dhe ja, menjëherë u mbushën rrugët me nxënës. Edhe ai ecte me hapin e mën-gjezit të shtatorit dhe e linte veten ta rrëmbente rrëkeja e vrellshme. Ai e ndjente vërshimin e gjakut të ri dhe e dinte që këtë vërshim e sillte turma larushe e rinasë. Kurora e flokëve të tij, si shkumë e bardhë, herë dukej e herë humbiste në atë det ngjyrash.

«Kjo është një ditë e lumtur! Megjithëse përsëritet çdo vit, më lë gjithnjë mbresa të reja» mendonte.

Mësuesi hyri në derën e shkollës pa u kuptuar. Nxënësit kureshtarë, si gjithnjë, përshëndetën mësuesin e tyre të dashur.

Ata po e prisin. Në shkollë ishte bërë traditë, që vitin e ri ta hapte mësuesi i vjetër. Pas përshëndetjes së tij, pas atyre fjalëve të shkurtëra dhe të thëna me zë të ulët, që i dëgjonin me nderim, ata ngjiteshin nëpër klasa.

Rrjeshti i nxënësve u nda më dysh. Drejt mësuesit vrapi një vajzë me grykëse dhe me jakë të kollarisur.

— Ç'kemi, Arta? — tha ai duke buzëqeshur.

Arta e zuri për dore profesorin.

— Përse u vonuat, profesor? Ne po ju presim. Edhe nxënësit po ju presin. Nxënësit e ndiqnin me sy dhe nuk e kuptionin përse belbëzonte mësuesja e tyre kur bisedonte me profesorin. Sepse ata nuk besonin që mësuesja e matematikës të mallëngjehej ndonjëherë.

Ata ecën një copë herë pa folur.

Arta e theu e para heshtjen.

— Ju më dhatë një mësim të shkëlqyer, profesor. Vera dhe Stefani u përgjegjën shumë mirë në provimet e vjeshtës. Pra fajin e paskam pasur unë. Duhej të isha marrë më shumë me ta.

— S'ka gjë, të gjithëve na ka ndodhur një gjë e tillë. Zotësi është të mos përsëritet.

... Filloi të ngjitej në shkallët e gurta të shkollës dhe ndjente një dobësi, diçka e vakët i ngjitej në grykë. Oborri ishte si një ditar pa fjalë i gjithë jetës së

tij. I dukej sikur po fillonte që nga fillimi. Do të zhvilointe një ditë mësim, do të dëgjonte kërcitjen gazmore të bangave, do të vinte përséri Artën në bangën e parë. Ajo do të dëgjonte si çdo vit mësuesin plak duke pulitur sytë e kthjellët. Kurse prapa do të rrinin nxënës të rindërtuar. Jo shokët e saj, po nxënësit e saj.

Arta ishte e gëzuar, dhe s'dinte se ku t'i fuste duart. Një herë i mbante në xhep, pastaj rregullonte shiritin e kuq të dezhurnut që kishte në krah, ose vërente flokët e butë dhe të bardhë të mësuesit.

Mësuesi ishte ndalur te shkallët. Para tij vështronin dhjetëra sy të zgjuar, të dashur dhe të vëmendshëm.

Nxënësit dëgjonin përshëndetjen.

Ndërsa fliste, mësuesit i dukej se po çlirohej nga barra e rëndë e viteve që mbante mbi shpatulla. Dalëngadalë nga mjegulla e kohës sikur dilte një djalosh, që nuk ishte veshur me kostum të ri, që nuk kishte flokë të thinjur. Ai mbante një kostum të thjeshtë studeni, të zbardhur dhe tepër të ngushtë për shpatullat e tij. Po ai nuk kishte turp të hynte në oborrin e shkolllës me ato mëngë të ngrëna nga të mbajturit.

Nxënësit filluan të ngjitnin shkallët dy e nga dy duke folur me zë të ulët. Mësuesi vërente Artën, Stefanin, Verën dhe të gjithë ata që e përshëndesnin.

Dielli dukej se kishte mbetur pezull prapa pishave, shelgjeve dhe trëndafilëve që kishin shpërthyer në lulëzimin e vonë të vjeshtës.

Mësuesi ngriti dorën sikur deshte të ruante vegimin e atij djaloshi, vegimin e rinisë së tij, që po hynte në oborrin e shkollës dhe që e bënte zemrën e tij t'i rrihete fort.

Dielli i qeshur dhe miqësor derdhë ar pa kursim atë mëngjez.

Mësuesi e ndjente se edhejeta e tij ishte shpërndarë në mijëra grimca të vogla, se tek çdo nxënës kishte mbetur një grimcëz e jetës dhe e rinisë së tij dhe se ata ishin shumë, shumë.

## SHQETËSIMI I NJË GRUAJE

— Madalenë! shiko rrezet e diellit si hedhin vallle gazmore mbi sipërfaqen e trazuar të detit, që shkëlqen me reflekse të tejdukshme!

Madalena mbante syze të errëta. Ajo donte të vështronte diellin «drejt në sy», po nuk mundej. Pulleti qerpikët, hodhi vështrimin mbi trupin muskuloz të Bardhit. Dëgjoi po s'iu përgjegj.

— Një përsosmëri të tillë, thua jse të paarrijtshme ka kombinuar natyra! Peneli im është shumë i varfër — vazhdoi Bardhi dhe shpejtoi të përfundonte skicat nga plazhi, që do t'i botonte në një revistë. Ajo u hodhi një sy skicave.

— Këtë treptik do ta quaj «Punëtorja e re».

Madalena s'u përgjegj.

— Këto kohët e fundit je bërë e heshtur si peshqit. Ç'ka ndodhur, mos të shqetëson ndonjë nga ata mjeshtërit e argjendit? — bëri shaka ai.

Madalena as që e ktheu kokën.

Vërtet ajo punonte në repartin e argjendit të ndërmarrjes artistike «Migjeni». Në fillim i qe dukur e pamundur të endëte fije aq të holla.

Një ditë mjeshtëri, që mësonte Madalenën kishte bërë shaka.

— Sa gabim kemi bërë ne që nuk mësuam gratë dhe vajzat tona të merren me argjendin. Tashti ato do ishin mjeshtre të vërteta.

Dhe një puntore e imët dhe e shkathët, ia pat përgjigjen në majë të gjuhës:

— Sepse ishit konservatorë, shokë!

— Jo, po nuk besonim, që mund ta bënин këtë punë.

— Aha... pikërisht ky është konservatorizmi, fillon nga konceptet...

— Madalenë, — vazhdoi Bardhi. — Ti as që po më jep përgjegje.

Ajo nuk u çudit. Bardhi s'e kishte pyetur ndonjëherë pér punën e saj. Ai pyeste vetëm pér «mjeshtërit e argjendit»... ose diçka tjetër.

Po as ajo s'kishte pasur ndonjë mendim të sajin mbi pikturen! Kishte qenë e sigurtë pér famën e Bardhit si piktor i talentuar. E admironte, sepse të tjerët flisnin pér talentin e tij. Ose pér të qenë më e singertë në fillim e tërhoqën më shumë flokët e bukur gështenjë dhe gjasimi me një artist-kinemaje. Po s'dinte të thoshte në i pëlqenin skicat e tij. Kishte kohë që ishte e zemëruar me veten dhe s'duhej të përziente Bardhin. E aq më tepër që mezi kishte filluar të kuptione nga piktura. Vetë ishte përpjekur shumë që të kuptione, sepse Bardhi s'kishte mundur ta fuste në botën e vet të frymëzimit dhe të penelit. Ajo kishte mbetur gjithnjë jashtë punës së tij, duke luajtur rolin e një figuranteje. Madalena nuk e dinte ç'mendonte Bardhi kur fillonte një punim qoftë edhe të thjeshtë. Ai s'bisedonte kurrë me të pér qëllimet e tij, megjithëse vitin e parë të martesës asaj i ishte dashur të qëndronte me orë të tëra mbërthyer në një karrigë të shtëpisë së tyre mbushur me aromën e luleve, sepse Bardhi punonte portretin e saj pér ekspozitën. «Ky portret do të ekspozohet, të gjithë do ta shikojnë të mahnitur, gruan më të bukur, përsosmërinë moderne, gruan time ideale». Kaq kishte thënë Bardhi atëhere.

Madalena lëvizi nga vendi. Mbështeti bërrylin

mbi një libër të trashë që kishte dalë ato ditë. Ajo e merrte me vete në rrerë, po për të lexuar nuk lexonte asnë rrjesht. S'mund të përqëndrohej.

Një copë letër rrëshqiti nga libri. Gati e pat harrua shkrimin e Mrikës, shoqës së klasës.

«E dashun Madalenë!

Për shumë kohë nuk pata rast me të shkrue. Ajo që më ndodhi m'u duk e re, e papritun, e bukur e më rrëmbeu menjihërë. U dashunova Madalenë, dhe tash jam martue me atë mësuesin, që të fola aq shumë verën e kalueme. Jemi në kampin e punëtorëve. Të pres!»

Madalenën e kishte tërhequr gjithnjë natyra e myllur dhe ëndërronjëse e Mrikës! Ato rrinin në një bangë. E quanin veten «shoqe të ngushta», me gjithëse Madalena në thellësi mendonte për të «naive», «fanatike», sidomos me dëshirën e saj për të mësuar malësorët e vegjël. Po fundi edhe ajo vetë ishte malësore! Madalena e dinte, që nuk do ta shpinte deri në fund shkollën. Gjithnjë e kishte vështirë të mësonte prandaj e zemëronte këmbëngulja e Mrikës për të mësuar, serioziteti me të cilin ajo përpinte çdo fjalë, çdo rrjesht libri. Ju kujtua bloku i saj me kapakë të kuq. Vjershat që shkruante për plepat shushuronjës të oborrit të shkollës, për mësuesin plak të matematikës, pikërisht në atë kohë kur ajo mezi i shtynte këmbët për në shkollë. Kjo ndodhi kur në apartamentin përballë saj u vendos piktori. Ajo ndiqte nga taraca e shtëpisë të gjitha lëvizjet e tij. Ai ishte aq i bukur. Dhe ajo donte ta mahniste me çdo kusht me hiret e veta këtë njeri. Dëgjonte si e etur çdo gjë që thoshte Çilja, fqinja e Bardhit. Çilja ishte një nga ato gratë e shumta, që qepë te nëna e Madalenës. Madalenës i interesonte të dëgjonte çdo gjë mbi Bardhin. Çilja e

ngrinte në qielj Bardhin. Nëna e Madalenës psherët tinte. Thoshte «Lum kush do ta ketë atë fat». Sigurisht ajo mendonte pér vajzat e veta, sidomos pér Dhuratën, që ishte më e madhja. Madalena e dinte. Ai mund të kishte shumë të njohura. Po Madalena kishte një farë instinkti se do ta bënte pér vete Bardhin.

— C'mendon? — e pyeti Bardhi.

Madalena u shkund si nga një èndërr. Pa me çudi Bardhin aq afër saj.

— Pér Mrikën; — i tha ajo e hutuar, pa e pasur mendjen aty. — Pér dobësinë e Mrikës. E çuditshme, sa shumë i do fëmijët. Dhe sot në mëngjez vetëm pér ta më fliste.

— Të gjitha gratë i duan fëmijët.

Po vërtet edhe Madalena dëshironte të kishte një fëmijë. U bënë disa vjet që ishte martuar dhe fëmijë s'kishte ende.

— Shiko, po vjen Luiza!

Të djelën është shumë zor të dallosh njerëzit në plazh. Dielli, ujët, deti qeshin, sikur duan të shoqërojnë klithmat e hareshme të lumit të njerëzve, që rrjedh nga të gjitha drejtimet. Trenat, autobuzët e çdo ore vërshojnë pa u ndaluar. Të duket se s'ka të shteruar ky lumë. Tirana e zhuritur nga dielli sulet drejt detit.

Ata e prisin që në mëngjez shoqen e Bardhit, Luizën dhe burrin e saj. Luiza me Petron kishin një dhomë në qoshen tjetër të plazhit. Kjo nuk i pengonte të takoheshin çdo ditë. Luiza shikonte rreth e rrotull me një buzëqeshje të lehtë që i shkonte aq shumë fytyrës së saj të zeshkët. Ajo ecte ngadalë sikur ishte në përgjim të kaltërisisë, të mërmëritjes së valëve dhe të jetës plot zhurmë e bujë.

— Më në fund erdhe!... Kemi dy orë që të presim — tha Bardhi, që u ngrit duke shkundur rërën dhe i zgjati dorën Luizës. Luiza shikoi me vërejtje skicat e Bardhit dhe rrudhi ballin.

— Më falni, përcolla Petron, — tha ajo pa i hequr sytë nga ata.

— Ku?

— E thirrën shokët e ekspeditës. Duket kanë zbuluar ndonjë të re. A thua do ta gjejnë vërtet atë metal aq të çmuar?.. Bardhi. Po ti, nuk u mërzite së piktuari Madalenën? — tha ajo papritur.

## II

Luiza rrotullonte ende në dorë telegramin e Petros. «Ëndërra jonë u realizua. Të puth...» Bardhi e lexoi rëshqitas dhe ndezi një cigare.

Në fillim kur u martua me Bardhin Madalena i druhej Luizës. Nuk i pëlqente kur kritikonte Bardhin për «formalizëm». Në të vërtetë ajo nuk e kishte të quartë brendinë e kësaj fjale dhe e ndjente veten ngush-të para sigurisë së Luizës që punonte në ndërmarrjen e saj dhe udhëhiqte repartin e pikturës.

— Nesër do të nisem edhe unë. E marr me mend se ç'ndodh atje. Vjet kur mora lejen krijuese isha me ekspeditën e Petros. Atëhere filluam kërkimin e këtij metali. Dhe mësova aq shumë, sa s'do t'i harroj gjithë jetën. Shokët e Petros ishin rrëmbyer nga dëshira për të gjetur këtë metal, që do të ketë vlerë të jash-tëzakonshme. Jashtë filloi të ftohtë dhe breronte pa pushim një shi i imët. Po brenda, në çadrën e ekspeditës, kishte aq dëshirë për jetën, aq optimizëm dhe gjësim sa të dukej e pamundur që ajo të fshihej aq bujarisht prapa një çadre të hirtë, që e rrihte era dhe dridhej nga lagështia. Dëshira, lufta, këmbëngulja, dëshpërimi, dyshimet dhe prapë besimi, besimi që i kishte frymëzuar të gjithë, më rrëmbeu edhe mua. Zemërat e pastra dhe gjithë dritë e gjejnë gjuhën e përbashkët. Unë rrija në mes të tyre. Ndjeja që s'ki-sha bërë asgjë. Nuk dija, a vlente diçka kompozimi im «Gjeologët»? Do dëshiroja që gjeologët e pëlhurës si-

me të mund të flisnin, të qanin, të qeshnin. Atje zbulova diçka të rëndësishme.

— Vërtet?...

— Pasioni për punën i lidh njerëzit.

— Paske zbuluar një gjë të madhe, Luizë!

— Ti nuk e merr me mend botën e tyre, Bardh!

Ti ke nevojë të shkundesh ca. Dhe duhet të të shkundë Madalena!

Madalena shikonte flokët e praruar të Luizës, pastaj nënqeshjen e lehtë ironike mbi cepat e buzëve të Bardhit.

— Luizë! Këtë mprehtësi lëre për në ndonjë mbledhje. Ti ke qenë gjithnjë e zonja në këtë fushë. Edhe artikujt që boton dëshmojnë për këtë. Po është mirë mos t'ia prishësh mendjen Madalenës time, sepse ajo është një vajzë e urtë.

— Ne në ndërmarrjen tonë kemi vajza dhe gra të talentuara, guximtare. Madalena jeton midis tyre, Bardh Kamberi.

— Luizë, ti më mirë lufto për një art realist...

— Ne kemi krijuar një atmosferë të tillë, që çdo njeriu i vjen keq kur një ditë i shkon kot.

Madalenën e përpinte mënyra bindëse e të folurit dhe shprehjet e qarta të Luizës.

Sigurisht, Madalena nuk donte ta mbysnin mendimet. Ajo kishte qëndruar gjithnjë larg tyre dhe ishte e kënaqur. Por ja padashur kohët e fundit e sulmonte një ciklon i furishëm mendimesh.

Një jetë të tërë Luiza me Bardhin ishin shokë. Para disa javësh Luiza hapi një ekspozitë personale në klubin e artistëve dhe të shkrimtarëve. Madalena nuk mund të thotë që ishte futur thellë në kuptimin e pikaturës, po ajo ishte magjepsur nga kompozimi «Gjeologët», thuajse i gjallë. I pëlqeu edhe portreti i Mrikës. Luiza e takoi një ditë verën e kaluar Mrikën në shtëpinë e saj dhe iu lut ta pozonte. Madalena imbeti e mbërthyer një copë herë para atij portreti. I dukej

sikur i fliste, sikur e thërriste nga larg të ngjiteshin fluturim në botën e ndritur të betejave. Kur e kishte bërë Luiza gjithë këtë punë? Ajo punonte në ndërmarrje njësoj si të tjerët. Ajo sigurisht flinte shumë pak. Sigurisht ia vidhеt gjumit kohën, ndryshe si mund të bënte një punë të dyfishtë, të trefishtë, sepse ajo ishte dhe nënë me dy fëmijë të rritur.

— Disa nga kolegët tanë u nxituan në dhënen e punimeve për ekspositën kombëtare — tha Luiza e menduar.

— Pse? — ia priti Bardhi.

— Sepse, artisti duhet të jetë thellësisht i bindur që s'mund t'i lëvizë asnjë qime veprës së tij, pastaj t'iu ua servirë të tjerëve. Nuk mjafton të hedhësh në letër «disa bojra» të forta «as të vrash pas së bukurës».

Madalena e ndiqte me një frymë këtë bisedë.

Bardhi ndezi cigaren.

«Do të fshehë tronditjen prapa tymit. Përse ishte tronditur Bardhi? mendonte ajo. Punimet e tij në ekspozitë u pëlqyen. Kështu kishte thënë vetë. Apo ndofta se Luiza kishte të drejtë? Po unë e di. Kur rrëmbehen ata në bisedat e profesionit duhet të tërhiqem dhe të hesht. Duhet vetëm të hesht... Këtu kri-johet midis nesh një zonë e pakapërcyeshme. Dhe gëzimi për të mbushur shtëpinë me lule të çdo lloji, për të vënë në dhomën e Bardhit një perde najloni, lumturia për të veshur pallton e bardhë, janë fare qesharake. Po ja që Bardhi vetëm këtë kujdes ka për mua. Po në fund të fundit edhe unë kam mësuar diçka».

— O vërtet, — Bardhi i drejtohet Luizës. — Më pate premtuar të më gjeje një katallog për një dhomë pune moderne. Gruas time i kishte shkrepur para ca kohësh në kokë të më bëjë një dhuratë të tillë. Edhe mua më pëlqente kjo ide. Ndërsa tashti sikur s'ndihet fare. Besoj se do ta mbash fjalën, apo jo Madalenë?

«Ja përsëri Bardhi!»

— Madalena i ka marrë gjithnjë seriozisht punët e saj! tha Luiza. Edhe në ndërmarrje Madalena punon seriozisht. Kam besim, që ajo do të bëhet një mjeshtre e argjëdit. Bere gabim ti Bardh që nuk erdhe. Mua më pëlqeu kumtesa e mjeshtrit të repartit të Madalenës në sesionin shkencor. Puna e argjendarit është e lashtë dhe ata kanë nxjerrë nga duart e tyre vepra të vërteta arti. Ndërmarrja jonë është e lidhur me tregun e jashtëm. Duart e shkathta të shoqeve të Madalenës e kthejnë fijen e argjendit në ar të kulluar. Ti e di Bardhi. Ne kemi me se të krenohemi, kemi fituar edhe çmime në panaire ndërkontaktare. Ky art i trashëguar brez pas brezi i pasuruar me motive të reja, është një art thjesht shqiptar dhe frut i një pune dhe talenti kolektiv.

— Luizë, ti duhej të punoje më mirë në ndonjë revistë si gazetare, — tha Bardhi.

— Të kujtohet Madalenë, sa bukur foli Suzana, brigadierja e juaj? Ndonjë ditë do të flasë edhe Madalena dhe ti Bardh Kamberi do të mbetesh me gojë hal-pur.

— Madalena ime është një kanarinë që këndon bukur në kafazin e saj të artë. Ajo mjaftohet ta adhurojnë si një perëndi të lashtë. Ajo nuk ka krahë të fluturojë aq larg, sepse do të bëhej një idhull i huaj dhe i pakuptueshëm për mua. Kurse Madalena nuk do të më shqetësojë asnjëherë. Është një grua ideale!

Luiza e kishte shok Bardhin, prandaj e dinte shumë mirë përse u martua pikërisht me Madalenën dhe jo me një shoqen e saj pikture të talentuar, megjithse kishte disa vjet që dashuroheshin. Ai e donte shumë qetësinë, vëmendjen, adhurimin dhe përuljen e gruas para tij, si përpara një gjeniu. Ai kishte pasur gjithnjë frikë nga gratë me personalitet. «Gruaja është grua nuk është as shoku, as kolegu. Ajo ka tjetër detyrë,

tjetër funksion» përsëriste shpesh Bardhi kur ishin në fakultet. Madalena heshtte, po në të vërtetë ishte e zemëruar me veten dhe me Bardhin. Zemërimi dhe pakënaqësia po i merrnin frymën.

— Shiko... paska ardhur edhe Mrika — thirri Luiza.

Në pistë po ngjitej një çift i ri dhe një grup kampistësh të gjëzuar.

— Qenka martuar? — pyeti Luiza e habitur.

— Po.

— Vërtet?! E takove ti?... Pse s'më ke thënë gjë Madalenë?

— Nuk e dija. Sot e mora vesh.

— Me cilin është martuar?..

— Me një mësues, shokun e saj.

— Ajo ka qenë nga të parat që prishi fejesën që në djep... dhe erdhi në konviktin e shkollës suaj — tha Luiza duke e ndjekur me sy. Duhej të ishte një vajzë e urtë, që kurrë s'mund ta besoje se do të luftonte me këmbëngulje pér diçka — vazhdoi ajo. Gjatë kohës që i bëja portretin më fliste pér një shoqen tuaj që pérleshej fytas me të, sepse Mrika donte ta bindte me çdo kusht që s'kishte punë më të mrekullueshme në botë, se sa të mësoje fëmijët e malësisë, si Ndrec Ndure Gjoka. Ndërsa ajo i thoshte Mrikës: «ke fat se je vajzë e bukur, mund të mbetesh në Tiranë». Përse duhet të shkosh pikërisht atje ku ke vuajtur aq shumë? Ku grattë i shesin si kafshët? Mrika nxehet dhe përgjegjej «nuk kam ndër mend të bëj tregëti me veten time...» A nuk mjaftoi që më shitën një herë prindët e mij të varfër?... Qëllimi i jetës sime është të luftoj që edhe dhjetra vajza si unë të shpëtojnë nga kanuni...» Duke dëgjuar Mrikën që më fliste, unë i jepja gjallëri syve të saj. A ka diçka që të mund të thotë këtë ide tek ai portret.

— Po. Luizë. Ai bile ka edhe më shumë — tha ajo e menduar.

...Kur e filloi jetën në shtëpinë e saj të re e të bukur Madalena i mendonte gjérat fare thjeshtë. Atëhere pandehte që s'mund të gjeje qoshe tjetër më të qetë, mbushur me aromën e të gjitha luleve. Nuk i shkonte ndër mend të pyeste, a e kuptonte vërtet burrin e saj? A e njihte jetën e tij? Atëhere i pëlqeu më shumë tingulli i fjalës piktor, se sa brendia e saj. Po jeta nuk mbetet në vend. Ajo filloi të kërkonte të lodhej dhe të gjente medoemos domethënien e ngjarjeve. Ndërsa Bardhi mbeti po ai. Përse pra ishte kaq e zemëruar me veten dhe me Bardhin. Madalena? Ndofta për shkak të atyre gjimnazisteve që punojnë në një repart me të! Ato janë vajza fare të reja, po sa ndryshe e filluan jetën nga Madalena.

Ato s'kënaqen kurrë me atë që arrijnë. I kritikojnë mjeshtrat për ngadalësi dhe mungesë vrulli e fantazie. Pastaj punojnë pa u kursyer dhe marrin lloj-lloj inisiativash të guximshme. Pa mbaruar mirë tur-nin, rrinë nëpër bangat e shkollës profesionale, që është hapur në ndërmarrje dhe mbajnë shënim ç'ju mësojnë pikërisht ata mjeshtra të zotë, që patën kritikuar pa frikë. Dhe nxjerrin çdo ditë nga duart e tyre punë më të hollë e të kualifikuar. Sikur të mos mjaf-tojë kjo, marrin pjesë në grupin artistik, pregetiten të zenë vendin e parë në dekadën e majit. Pastaj ulen përpara mjeshtërve dhe japin provim për të fituar kategorinë. Dhe dashurojnë. Edhe dashurinë e kuptojnë krejt ndryshe. Një dashuri të vërtetë, të barabartë. Djemtë i respektojnë më parë se t'i dashurojnë.

Madalenën e kishte rrëmbyer ky vrull, megjithse dukej si e hutuar dhe e huaj? Nganjëherë pandehte se s'do mund të shkrihej kurrë plotësisht me këtë mënyrë jetese gjithë zhurmë, mbledhje, fletërrufera, luftë të përditëshme për të merituar emërin e thjeshtë «punëtore e dalluar».

Madalena s'do që t'u ketë cmirë të tjerëve. Po

një ndjenjë e zymtë, që ngjan me leshterikët e gjelbër e të lagur, i ka mbërthyer shpirtin. Midis saj dhe Bardhit është hapur një hendek i thellë! Si? Pse? Ajo ende nuk di si ta shpjegojë.

Përpinqet ta largojë këtë mendim duke parë hapsirën, duke përgjuar zhurmën e lehtë të valëve, që përplaset mbi breg. Qyteti me drizëzat që i janë ngritur kodrës si yje të panumërt, të duket sikur është kredhur në errësirë deri në brez dhe mijëra xixëllona e grisin këtë errësirë e vijnë deri në valëzat e vogla lozonjare, që lëpijnë bregun. Fari, herë i zjarrtë e herë i gjelbërt përshëndet horizontin e largët.

— Madalena, kërcejmë? — e pyeti Bardhi.

Ajo u ngrit. Mrikën e kishte fare pranë. Buzëqeshën. Po Madalena kércente si e përhumbur. Asaj iu rrotulluan të gjitha, valëzat e vogla kryeneçe, drizat dhe kërcimtarët që tërhiqnin këmbët zvarrë mbi pistën e mbushur me grimca rëre. Lëvizja monotone e hapave zh... zh... zh... zh... i gërvishte veshët.

### III

— Madalena, harrova të tregoj diçka. E merr me mend ç'është?

Ajo ktheu kokën nga dritarja. Dritat e bregut u shuan. Lëvizi cohën e rëndë me viaj. Pastaj perden e hollë të hotelit. Nga larg vinte llapashitja e valëve. Ajo vështronte me vëmendje fytyrën e pashme të Bardhit, që sapo e kishte fshikur dielli. Ngriti supet.

— Jo...

Ai nxorri një palë ruaza shumë të shkëlqyera ngjyrë vjollce.

— Ah! — tha ajo, po nuk iu hodh më në qafë. As nuk tha duke u përkëdhelur si bënte gjithnjë: «Faleminderit, faleminderit i dashur». U drodh, sidomos

kur kujtoi sa e mahnisnin këto gjëra dikur. Bile as që u afraa t'i marrë në dorë.

Papritur i lindi një dëshirë e papërmbajtur të largohej nga dhoma e këtij hoteli, që i dukej e ftohtë dhe armiqësore. Kishte nevojë më në fund të ishte vetëm. Vetëm me mendimin e saj të mbytur. Për të harruar revoltën që i zjente ndaj vetes tha pa pritur:

— A e di anekdotën e xhirafës Bardh?

— Jo!

— Vërtet nuk e di? Në një park zoologjik...

— Shiko grua, mos e zgjat përrallën se më zë gjumi.

— Kafshët qeshnin me të madhe. Vetëm xhirafa shikonte nga lart me indiferencë. Po të nesërmen ajo ngriti me të qeshurën e saj gjithë parkun. Kafshët nuk u çuditën vetëm thanë: «Paska shkuar gjer në xhirafa».

— Kush ta tregoi?

— Mrika...

— Ajo malësorja shumë të bie në qafë! E humb kohën kot me të! Ç'të përrallisi sot gjithë mbasditen? Mos të foli për emancipimin? Për kanunin dhe heroizmat pér të flakur tej zakonet e prapështa dhe prapanike? Mos ke nevojë edhe ti Madalenë të emancipohesh?...

— Tha vetëm që është e lumtur dhe se lufta e saj dhe e të shoqit kishte dhënë frytet e para... Shumë vajza vazhduan shkollën dhe të tjera shkuuan nëpër kurse kualifikimi. Jeta ka filluar të ndriçojë edhe në kullën e tyre. Dhe ata luftojnë së bashku...

— Ti e di. Nuk i dua gratë kur janë «tepér të zgjuara». Ki kujdes grua!

— Pse?

— Më velin, sepse janë të përcipta. Punë grash. A ke dëgjuar ndonjë herë. E di që s'mund të jenë kurrë të plota në atë që thonë. Se gjithnjë u mungon diçka. Gruaja mund të jetë e përsosur vetëm në kultin e seksit të saj. Përse kërkon privilegj tjetër, kur bukuria adhurohet. Bukuria e saj ka frymëzuar dhe frymëzon artistët...

— Vërtet Bardh? Vetëm për këtë është e zonja një grua? Po sikur të mos jetë e bukur dhe të bëhet «burim frymëzimi» ç'do të thoshe ti? — pyeti Madalena duke parë jashtë sfondin e zi të detit.

— S'ka mundësi. Gra të tilla që merren me filozofi ose moral si Luiza dhe që bëhen heroina e emancipimit si Mrika, e humbin butësinë dhe delikatesën femërore. Ato më shumë të trembin se sa të frymëzojnë.

— Vërtet?

Ishte e kotë të diskutonte me Bardhin. As që ishte e zonja t'i kundërvihet ironisë së tij dhe nuk kishte diskutuar kurrë. Kishte vetëm një lutje. Ta linte të qetë. Deshte të ishte vetëm. Të zgjidhë mendimet që i vërshonin pareshtur!

Madalenën nuk e zuri gjumi. Një copë herë u rrotullua në dhomë. Pastaj zbriti në holl. Një frikë e madhe i ndrydhëte zemrën. S'kishte dalë ndonjëherë në jetën e saj kaq vonë, vetëm. Por në dhomë ishte e pamundur të qëndronte. I zihej fryma. Nuk e dinte përsë e ndjente veten të fyter, të poshtëruar. Asnjeri nuk i kishte thënë gjë. Bardhi, si gjithnjë, i përkëdheli sedrën duke e quajtur «grua ideale», dhe pikërisht këto fjalë që e mahnisnin dikur, tashti e fyenin. Përse nuk përpinqej të kuptonte shpirtin e saj Bardhi? Përse ishtejeta e tyre kaq e zbehtë dhe artificiale?» A thua nuk i shkonte ndonjëherë ndër mend Bardh Kamberit se edhe ajo ishte njeri i kohës së tij! Se ajo jetonte me Luizën, Luiza që flet gjithë kohën me pasion për punën e saj dhe të Petros. Bardhi thoshte që Petroja është një satrap xheloz dhe Luiza vuan shumë... Po kjo s'ishte e vërtetë. Jeta e tyre ishte e lidhur me një miqësi të fortë! Ata nuk i lidhët forma, por brendia e jetës. Edhe në ndërmarrje, në repartin e Madalenës çdo ditë bëhej një jetë e gjallë. Një jetë krejt tjetër. E vërtetë, e ashpër, plot kontradikta, po e vërtetë... Kjo e vërtetë luftëtare arriti deri në thellësi

të bjeshkëve te Mrika. Dhe a ishte e mundur të mos çqetësonte Madalena Kamberin?

Po Bardhi përse nuk dëshironte të shihte asgjë! Mos kujtonte se ajo kishte mbetur si dikur, një fëmijë i mahnitur që rrinte gjithë ditën në ballkon për të parë Bardhin? Po ajo nuk mund të mbetej gjithë jetën si peshqit e bukur dekorativë në akuarium!

Në holl Madalena qëndroi një copë herë ulur në kolltukët e kashtës. Përse nuk kuptohej ajo me Bardhin? Ai ishte dhjetë vjet më i madh se ajo dhe, artist. Po ja që e zuri gjumi menjëherë, asgjë s'e shqetësonte. Filloi të gërhasë! Sa e zemëronte Madalenën ajo fytyrë e kënaqur dhe e velur! Ndofta sepse Bardhi nguli këmbë që ajo të mbetet «një grua ideale, të jetojë vetëm për të dhe për asnjeri tjetër!» Po jetë a tyre endej krejt e veçantë dhe e huaj për njëritjetrin... Ai nuk i bisedonte me atë kurrë planet dhe shqetësimet e tij. Edhe ajo sigurisht heshtte për jetën e saj të brendshme.

Portieri i çuditur dhe i përgjumur ngriti kokën. Ajo e kapi menjëherë vështrimin e tij pyetës. Shpejtoi hapin. Ekte zbathur në rërën e lagur. Më në fund ishte vetëm. Donte të qortonte vetveten pa i fshehur dhe pa i zbukuruar asgjë. Merrte frymë thellë. E dinte. Në këtë ngjarje të jashtëzakonshme të jetës së saj kishte dalë për të gjykuar Madalenën e dikurshme, gruan e urtë të Bardh Kamberit.

Dritat e hotelit dhe të vilave u shuan njëra pas tjetrës. Gjumi nanurisej nga dallgët dhe era që vinte nga horizonti pafund.

Ajo ecte ngadalë duke u lëkundur. E shikonte pa mëshirë Madalenën ideale dhe të përsosur. E rrëmbente dhe e flakte duke ia përplasur shpatullat në rërë.

Qëndroi një copë herë, pastaj eci. Desh të mbësh-tetët diku. Hypi në urën pranë zyrës së varkëtarëve. Dhjetra lundra të vogla ngjanin si peshq të flakur andej-këndej. Hapat e saj kërcisin mbi dërrasat e

urës. Shtrëngoi trikon e leshtë pas trupit. Puhiza ishte e lehtë dhe e lagësht. U ul në krye të urës. Zgjati dorën mbi guaskat që kishin harruar fëmijët. Deri në muzg aty ishte një çapë e jakë e quditshme e shoqëruar nga klithmat gazmore të fëmijëve që zinin peshq. Ç'heshtje e trishtuar! Ajo ktheu kokën nga kabinat. «Secili ka një jetë të tijën. Një botëzë të vogël të mistershme, fare të panjohur nga të tjerët». Këtë Bardhi e ka në majë të gjuhës. Po ja që të gjithë kanë edhe një botë të tërë dhe të vetme që i bashkon!

Madalena flakte në det guaskat. Një zhurmë e lehtë. Një notë e vetme e hollë, e dridhshme... pastaj ato humbisnin në thellësi të ujrade...

«A je e lumtur tani Zonja Madalenë? Ti i arrite të gjitha ato, që ishe e sigurtë se do t'i arrije, sepse ti ishte e re, Madalenë, shumë e bukur, dhe s'kishe dashuruar asnjëherë burrë tjetër».

«Po mos është qëllimi i jetës së një gruaje vetëm të gjejë një burrë?

«Vërtet, a do të them se kush je? Mos u zemëro, e vërteta është pakëz e hidhur.

A e di ç'ke bërë?

Vetë je zvarrisur para Bardh Kamberit. Ke qenë e sigurtë se do të pëlqente. E pse jo? Do të të them ende? Jo? Mirëpo unë do të të them sidoqoftë. Ti vetë e fillove jetën si një skllave e mjerë dhe e përulur. Dhe nuk të ardhka mirë që Bardhi të trajton ashtu siç ke dashur!»

— Oh! — klithi ajo, duke u dredhur nga lagështira. Qenë shumë e rreptë në të gjykuarit e Madalenës! E shikonte veten të mundur dhe pëshpëriste me gjysmë zëri gadi për të qarë:

«Po unë e dashurova Bardhin. E dashurova».

Po mjaftoni vetëm kjo Madalenë Kamberi? «Ty nuk të lidhët asgjë me të». Dhe gjatë gjithë kohës ti ke qenë thjesht gruaja e Bardhit, më beso Madalenë.

Ti s'ke qenë as shoqja as mikja e tij dhe asgjë tjetër veç një copë grua!

Madalena nuk u çudit aspak kur Bardhi i zemëruar dhe i çakërdisur e mbërtheu aq fort për bërryli sa i theri.

— Do të ftohesh grua... Është lagështirë, — tha ai tepër i sjellshëm.

Ajo e shikoi me ligësi veten e gjunjëzuar dhe mendohej të kapte ato që thoshte dora e Bardhit e mbërthyer në bërryl.

«Nuk ta fal këtë marrëzi! Të bredhësh vetëm në mes të natës? Ç'do të thonë të tjerët?»

Ajo ngriti kokën. E pa drejt në sy. Deshte t'i thosh te diçka Bardhit. Po çfarë? A është fajtor vetëm ai? Jo. Fajtore ishte edhe ajo, që e filloi jetën me aq mendjelehtësi! Po në fund të fundit njerëzit rriten. Vetëm tashti ajo e kuptonte domethënien e shprehjes «gruaja ideale» të Bardh Kamberit. Vetëm tashti.

Madalena dëshironë që t'ia përplaste zemërimin e saj Bardhit. Që ata të ndesheshin ballë për ballë dhe të barabartë. Po duket ai nuk e konsideroi të denjë për t'i thënë diçka. Ai nuk e tha atë që mendonte.

Ajo ngriti kokën.

Bardhi ia shtrëngonte ende krahun dhe e tërhiqte. Te dera e hollit i tha me zë të lartë që ta dëgjonte portieri:

— «Më prit këtu, sa të shkoj të marr xhaketën dhe dalim së bashku shëtitje».

Madalena u kthye me vrull. Vështrimi i qelqtë, i akullt i Bardhit sikur deshte ta mpinte. Po ajo s'kish te më frikë t'ia përplaste revoltën e saj. E dinte që s'ka për të qenë më kurrë «gruaja e urtë dhe ideale». Kish te marrë fund dhe qetësia olimpike e Bardh Kamberit.

## KAPANONI 4<sup>a</sup>

Bora u zgjua e trondit, qull në djersë. Mori frymë e lehtesuar. E shikonte shpesh në èndërr Shkurtën. S'ishin ndarë ndonjëherë në jetë e tyre. Bora shtrëngonte dhëmbët dhe ndrydhte mallin për të. Çikat e malësisë duhet të jenë gjithnjë trimëresha të forta.

Bora zgjati dorën, ndeshi batanijen e ashpër të Rundës, u ngrit përgjysmë, lëvizi perden dhe u rrëqeth nga të ftohit.

Qielli ishte qartësuar. Yjet ndrisnin si në bjeshkë. Retë zemërake dyndeshin me një vrap të harbuar.

Kapanoni 4<sup>a</sup> flinte në qetësi të thellë.

Gjatë gjithë javës kishte rënë shi. Traseja ishte mbytur në baltë. Vullnetarët dilnin pa gdhirë, megjithëse asnjëri s'i dërgonte në trase; ata përlesheshin me shiun, me llucën si të ishte një armik i betuar dhe i rrezikshëm. Pastaj ktheheshin të lodhur gjithë baltë nëpër kapanone. Me t'u çlodhur pak, vraponin në sallën e kulturës e kërcenin gjithë mbrëmjen.

Edhe për pak ditë turni do të mbaronte. Po sa e larmishme kishte qenëjeta në këto dy muaj! Në të vërtetë s'kishin të gjithë nga dy muaj. Shumica qenë të ardhur rishtaz. Bora quhej «vullnetare e vjetër». Bile më e vjetër se nëna e saj, Rudina. Ajo erdhi në fillim të turnit me shoqen e vet të fëminisë, Shkurte Palin.

Kur kapanonin 4<sup>a</sup> e zinte gjumi, çikat e Dukagji-

nit, që flinin në katin e poshtëm të krevateve prej dërrase, bisedonin me zë të ulët.

Bora:

— Më ka marrë malli pér Rudinën. Ç'ka ban atje vetëm?

Shkurta:

— *Kur paske kenë nji cucë aq e vocërr sa me të marrë malli pér locen, ma mirë të rrige nën xhubletën e saj.*

Bora:

— A e mban mend motër, sa e zorshme ka kenë pér mue?

Shkurta:

— Po. Atë ditë kur fole në mbledhjen e rinisë, kishe frikë!

Vërtet. Atë mbrëmje gushti ato kthehezin të dyja nëpër udhët plot dredha të Pecajt të tyre. Borën e brente dyshimi. Sa herë që kthehej nga kullota në kullë gjente një gjendje të nderë. Nga njëra anë Rudina e vrejtur dhe e zemëruar. Nga ana tjetër baca plak, gruaja e tij dhe axhë Gjoni, me fytyra të egërsuara dhe plot kërcënëm, sikur donin të zhduknin nga faqja e dheut Rudinën e fortë e të rreptë e Borën e vogël e të brishtë. Dukeshin që sapo ishin ndarë nga një grindje e ashpër. Për të nxjerrë zemërimin i suleshin Borës. E detyronin të shpallte se «e dashuronte» të fejuarin e saj, që s'e kishte parë asnjëherë.

Për të shpëtar nga të rrahirat që përsëriteshin çdo ditë, pér të shpëtar nga dora e fuqishme e axhë Gjonit dhe Preng Gjondedës, që e mbanin të mbërthyer pér gryke, Bora thirri në ndihmë Shkurte Palin dhe shokët e organizatës së rinisë. Ata vendosën: Bora të mos përthyhej. Xhaxhanë e saj Gjon Gjondedën, që ishte ende i ri, ta thërrisin në mbledhjen e organizatës pér t'i kërkuar llogari.

C'do të ndodhë pas kësaj në kullë? mendonte Bora atë mbrëmje. Ajo ishte e sigurtë se diçka do të ndodhë medoemos.

Shkurta e ndjente shqetësimin e Borës. Po tashmë lufta ishte shpallur. Lufta donte luftëtarë të zot e të guximshëm. Po edhe më të zotët e më guximtarët ndjejnë shqetësim nga beteja e parë.

— Përse ngushtohesh, he burrneshë? Na kena armë të fortë!

— Po moj Shkurte motra, po edhe njaj plaku jem i tërbuem ka do armë, të vjetra vërtet, po që si hjek doret.

— Në kullë asht Rudina.

— Rudina? Njeriu ma i mbramë që pyetet atje! Në fillim ka me këcye «nanë madhja». E mban mend kur i shhim në shkollë? S'gjejshim brimë ku me u futë prej saj! S'mujke me na pa me libër në dorë! Mandej ka me më zdapit axhë Gjoni që e ka kryet ma të fortë se të mushkës.

— Po na i jena dorëzue Partisë dhe askush s'guxon me na prekë, lum motra. A ndieve? Askush.

E ku ta dinin çikat e Pecajt çdo të ndodhët më vonë?

Ecnin pranë e pranë. Gjithë rrugës s'folën më. Shkurta i kërkoi dorën në errësirë dhe ia shtrëngoi.

Netët e gushtit nér male janë të qarta. Yjet shkëlqejnë fare pranë. Të duket se mjafton të zgjasësh dorën dhe do t'i prekësh.

Borën e trimëronte ai shtrëngim dore, që fliste më shumë se të gjitha fjalët. Bora edhe sot e ndjente shtrëngimin e dorës prandaj u ngrit me vrik. S'donte të mendonte më për Shkurtën. Sa herë e kujtonte i mbledhëj një lëmsh në fyt dhe i vinte për të qarë. Po ajo e dinte, Shkurtës s'i kishin pëlqye kurrë lotët. Sa vajzë e fortë! Sa zemër të pastër e të ndjeshme kishte!

Ishte e çuditshme! Çdo gjë do ta besonte Bora, veç që s'do të shihte edhe një herë motrën e saj të dashur, ja, këtë s'mund ta besonte. S'mund ta besonte në asnje mënyrë!

Bora iu afrua Rudinës. E fshiku frymëmarrja e saj

e lehtë. Nëna flinte me buzë të hapura. Rrudhat e ballit i qenë tendosur. Rrezet e venitura të hënës paksa regëtinin mbi flokët e shpërndarë nëpër jastëk me një vezullim të lehtë ngjyrë hëne që e tregonte shumë më të re Rudinën. Gadi s'mund të besoje që ishte nëna e Borës. Bora s'mbante mend t'i kishte folur ndonjëherë me përkëdhelje Rudina. Vetëm natën, kur në kullë të gjithë flinin, dora e butë dhe ledhatare e nënës i lëmonte flokët. Në ato çaste Bora donte të hapte sytë, po nga frika se mos nëna nuk e zgjaste më dorën në errësirë, në vend që t'i hapte, i shtrëngonte më fort.

Bora i mbuloi me kujdes supet e Rudinës dhe filloj të vishej. Donte të dilte e para nga kapanoni 4<sup>a</sup>.

Pa mbaruar mirë së veshuri, brofi në këmbë Rudina dhe pas saj komandantja e brigadës.

— Si ke nje nanë loce! — i pëshpëriti Bora.

Rudina tundi vetëm kokën dhe largoi perden e drifatës për të vërejtur motin.

— Kenka ba xham, — tha.

U ngritën vajzat e katit të sipërm të kapanonit 4<sup>a</sup>. Si të merrnin një urdhër të vetëm, u veshën shpejt e shpejt, pa rrëmujën e zakonshme.

Donte edhe shumë kohë të binte boria e mëngjezit.

Komandantja, një vajzë zeshkane e thatë dhe e shkathët, ende në një këmishë të hollë, iu afrua Rudinës.

— Filloi mbledhja e shtabit, — qeshi Bora.

Po Rudina s'ja vuri veshin. Bashkë me komandan-ten caktuan vendet që do punonin ato ditë forcat e kompanive. Caktuan vullnetarët që do të niseshin për eskursion nga brigada e tyre. Menduan kush do ti zë-vendësonëtë në trase që brigada «Mehmet Shpendi» të mos turpërohej dhe të humbiste flamurin.

Në kapanonin 4<sup>a</sup> nisi ritmi i etshëm i mëngjezit.

Vajzat shkundnin krevatet. I rregullonin. Hidh-nin peshqiret në qafë dhe laheshin nën dritën e yjeve. Kur ktheheshin nëpër udhët e sektorit, shkëmbenin pëershëndetjet me vullnetarët e kapanoneve të tjera.

Komandantja me zë pak të ngjirur, i rrjeshtoi vajzat e kapanonit 4<sup>a</sup> pér gjimnastikën e mëngjezit.

Kapanoni 4<sup>a</sup> duhej të ishte shembull.

Në mugëtirën e acartë të nëntorit filloi dita e punës në qytezën e Dushkut.

Rudina dhe komandantja u nisën në ballë të brigadës «Mehmet Shpendi». Ecnin me hapin e lehtë e të shpejtë të malësores. Dëgjoheshin fragmente bisedash, këngësh, të qeshurash.

Të ftohtët e nëntorit të fshikullonte deri në palcë. Era të priste si me brisk.

Që larg, në mugëtirë, shquhej balli i lapidarit të Shkurte Pal Vatës.

\* \* \*

Rudina e mbante mend që të vogël çikën, qysh kur lozë me fëmijët e saj në një lëndinë të blertë në qoshe të oborrit të tyre.

Edhe në lodrat fëminore, edhe në shkollë, Shkurta me Borën s'u ndanë asnjëherë.

Shkolla ishte larg. Çikat hidhnin çantat prej lecke në shpinë dhe, si ata trumcakët e vegjël nisin fluturimin.

Rudina i ndiqte që lart nga kulla me sy. Kur ato humbisnin e s'dukeshin më, ajo e ndjente veten të vettmar, të humbur. Ishte mësuar prej kohësh të ndrydhëtë mendimet e ndjenjat. Shkonte pér dru në pyll, merrje gjithë ditën me punët më të rënda, po vëtmia s'i ndahej. Është e trishtueshme vëtmia në mes të njerëzve.

Në kullë e ndiqnin kudo sytë e ftohtë dhe të rrepertë të të shqotit. Vështrimi armiqësor e ziliqar i shemrës. Përse?

Preng Gjondeda ishte martuar katër herë. Gratë e para i vdiqën dhe i lanë vetëm vajza. Gruaja e tretë s'lindi fëmijë. Po Preng Gjondeda, burri më i fortë i fisit donte patjetër një mashkull në kullën e vet. Një

mashkull që të përtërinte fisin. Të gjithë burrat, me përjashtim të një nipi, që e rriste ai në kullë, ishin korur nga plumbi i gjaksit.

Dhe sado e çuditshme që të duket, pikërisht gruaja e tretë qe s'lindte fëmijë e gjeti Rudinën jetime te ca kushërinj të largët. Ajo vetë e martoi me burrin e vet, kur Rudina s'ishte as katërmëbhjetë vjeç, më e vogël nga të gjitha çikat që Preng Gjodedës i kishin lënë dy gratë e para.

Rudina nuk e dinte sa ishte blerë. Po vajzat e kullaës i shisnin gjithnjë shtrenjtë. Sa herë që ndonjëra nga ato të mjera, të torturuara nga njerka dhe nga kannuni, nisej në udhën e largët me një duvak të kuq, hiper mbi kalë, Rudina e ndiqte me sy derisa humbiste dhe i merrej fryma nga hidhërimi! Kështu do ta pësonte edhe vajza e saj e vogël. Ç'të thuash më për këto vite të jetës së Rudinës. Vitet i ngjanin njëri-tjetrit, të gjatë, të trishtuar, gjithë ankth. Rudina kishte frikë që po i rritej vajza. Vite me radhë u mblodh pikë-pikë helmi në zemrën e saj, që e mpit Rudinën e re dhe të fortë.

Po sikur edhe Sokol Gjondeda të bashkohej me babanë dhe me xhaxhanë e vet Gjonin, për fatin e së motrës? Çdo të bënte Rudina? Të humbte djalin e saj të vetëm?

Preng Gjondeda, megjithëse plak i moçëm, ishte një malësor i mbajtur, i fortë dhe i njobur si pushkëtar i zoti. Fjala e tij s'bëhej dysh jo në kullë, po as në fis e në gjini.

Bora u rrit papritur dhe allishverishin e kishte lidhur Prenga me fshehtësi të madhe.

Në ato çaste Rudina donte të kishte pranë djalin e vet, Sokolin, po ai ishte ushtar. Edhe ato që shkruante ai, Rudina s'guxonte t'i dëgjonte para të tjerëve. Fjalët e djalit ajo i merrte vesh e fundit. Ato ishin i vettimi ngushëllim se as Borës s'donte t'ia tregonte luftën që i zjente në shpirt. Sa nevojë kishte atëhere Rudina

të mbështetet e shpatullat e fuqishme të Sokol Gjondedës e të merrte forcë. Të merrte një vendim. Ajo s'donte ta linte Borën të martohej në këtë mënyrë me një burrë të ve dhe me fëmijë, vetëm e vetëm se ishte në gjendje të paguante «shtrenjtë». Si ta shpëtonte vajzën? Të arratisej me të nga kulla? Pushka e Preng Gjondedës do ta gjente kudo që të ishte! Po ajo s'kish-te frikë. S'donte t'uva linte Borën!

Sikur Rudina të mos kishte bërë një jetë aq të zyrtë e të vëtmuar pér më shumë se njëzet vjet, ndof-ta do të gjente mbështetje në brigadën ku punonte te shoqet e saj kooperativiste.

Të rinxjtë e Pecajt dhe të gjithë Dukagjinit qenë më të shpejtë se Rudina. Ato i shpallën të prishura fjesat e të miturve.

Po në familjen e Gjondedajve asnjeri s'deshi të dëgjonte: Ata bënин sikur s'dinin gjë. Sikur kjo s'ju përkiste fare. Në kullë filloi zemërimi, krisi sherri.

Bora i shkroi të vëllait, Sokol Gjondedës. Rudinës sikur iu lehtësua ankthi kur filluan të sulmojnë kullën letrat e të birit.

Preng Gjondeda e donte me kokë djalin e vet, po për letrat dhe për porositë e Sokolit dhe fatin e Borës, ai e bënte veshin shurdh. Këtu ishte zot Preng Gjondeda, burri i lashtë i fisit. Këtu s'mund të përzihet asnjeri tjetër.

Atë mbrëmje gushti, kur Shkurta dhe Bora vinin nga mbledhja e rinisë, Preng Gjondeda me të nipin turfullonin dhe zjenin nga marazi. S'u doli gjë as mendimi që të detyronin Borën të shpallte se «e dashuronte» të fejuarin.

Rudina priste gjithë kohën e tendosur se mos i vris-nin çikën. Këtë gjë ata s'do ta bënин kurrë, pa kaluar mbi trupin e Rudinës. Ajo qe matur kaq herë t'ja nxirr-te nga duart Gjonit, Borën, kur e rrihte. Por ligji i rreptë i kullës e ndalonte. Ajo s'e kishte këtë të drejtë. Po kësaj radhe ajo kishte vendosur fort me vete,

që Borën s'do t'ua linte më në dorë. Si do ta shpëtonte? As vetë s'e kishte të qartë! Ndofta duhej kërkuar ndihma e organizatës së Partisë? Mirëpo edhe Rudina kishte kusuret e veta: ajo nuk donte që kulla e Preng Gjondedës, e përmendur për pushkë e pértrimëri të merrej nëpër gojë! Po çfarë të bënte tjetër?

Po më në fund një ditë Rudinë Gjondeda foli me zë të ashpër:

— Çikat i dhanë fjalën Partisë! A do të guxosh të ngrihesh kundër Partisë Preng Gjondeda?!

Kështu filloi lufta e Rudinës.

\* \* \*

Karrocat mezi ngarkoheshin dhe rëndonin nga dheu i lagur; vullnetarët ngjiteshin me shpejtësi nëpër skarpatë. Hipnin nëpër ura. Gérmonin dheun dhe pastronin gropat e ujit.

Rudina mbushte karrocën e së bijës.

Bora, duke dredhuar, dukej sikur fluturonte. Pas saj shkonin varg karrocat e vajzave të kapanonit 4<sup>a</sup>. Nëna s'ngopej së pari atë rini të gjallë që vraponte përpara. Vullnetarët donin të fitonin ditët e humbura nga shirat.

Vajzat e kapanonit 4<sup>a</sup> punonin pranë lapidarit të Shkurtës, që zakonisht ishte i rrëthuar me lule të freskëta që vinin nga të gjitha anët e vendit.

Rudinën e tërhiqte shumë edhe pamja e fushave dhe shtëpive myzeqare. Fshatrat ishin krejt ndryshe nga malësia e tyre. Shtëpi të reja, të lehta pranë njëratjetrës. Pullazet e kuqërrëmtë, ballkonet plot lule e hardhi i jepnin fushës një pamje gazmore. Asgjékundi s'dukej qoftë edhe hija e një kullë. Rudinës nuk i ndahej përfytyrimi i kullës. Ai i Preng Gjondedës, i ndjenjës së përbuzjes dhe i neverisë që kishte pasur gjithmonë pér të. Vëtëm një grua, që ka jetuar gjithë jetën me një burrë, që nuk e ka dashur kurrë, mund ta kup-

tojë ndjenjën e rëndë dhe poshtëruese që batiste Rudinën. Dhe ky njeri ishte babai i fëmijëve! Dhe fëmijët e donin! E q'mund të dinë fëmijët?

Po a mund ta duronte më Rudina Preng Gjondedën? A mund të duronte xhelozinë e verbër të gruas së tij të tretë? Ajo vetë e kishte martuar Rudinën. Megjithatë e urrente aq shumë sa në çdo rast sillej me të si me një të huaj, me një të shitur që ishte sjellë në shtëpi vetëm e vetëm për të lindur fëmijë. Vajzat dhe gratë te Gjondedajt s'kishin asnje vlerë. Prenga kujdejsej vetëm për djalin, Sokolin dhe donte me çdo kusht ta mbante të lidhur pas vetes. I fliste për martesë, për camërdhokët, që do të mbushnin kullën dhe do të përtërinin fisin.

Në ushtri djali u bë shofer! Pleqtë e kullës së Gjondedajve u shqetësuan. Shoferi s'mund të rronte më në kullë dhe të rriste camërdhokët e Gjondedajve. Mos vallë edhe për këtë fajtore ishte Rudina?! Ajo ishte shumë më e re se ata, ajo do të mund të jetonte kudo që të ishte Sokoli. Rudina ishte rreziku, prandaj atë e ndiqte kudo armiqësia e pleqve Gjondedaj.

E si mund të kthehej Rudina përsëri dhe të jetonte si më parë? Kur ishte në kullë edhe e kuptonte edhe s'e kuptonte sa i thellë ishte hendeku midis saj dhe pleqve të Gjondedajve. Po tashti ajo e kishte të qartë! Që kur ishte krijuar koperativa e bashkuar pleqtë ishin mbyllur në vetëvete. Rudina, Bora dhe Gjoni si krahët më të rinj dhe të fortë të kullës punonin gjithë ditën. Bora në kullotë. Rudina dhe Gjoni nëpër brigada.

Këto mendonte Rudina duke ndjekur me sy të lbyrur nga dielli vullnetarët tek punonin dhe gruan me aparat të hedhur krahëve. Gruaja me aparat u ul e shkujdesur pranë Rudinës. Filloi bisedën me xha Demirin, një vullnetar që kishte ardhur ditët e fundit. Në të vërtetë ai s'ishte aq plak, sa ta quanin «xha Demir», por, në një qytezë si Dushku, ku mosha e

banorëve arrinte deri te shtatëmbëdhjetat ishte e leh-të të dukesh si «xhaxho».

Xha Demiri as që shqetësohej për këtë. Rrinte buzë trasesë bashkë me vajzën e vet, pasi ishte lodhur duke mbajtur traversa. Herë pas here fshinte djersët me një shami të vjetër e të zhubbrosur.

— Mua nuk më zinte gjumi, moj bijë, — iu drejtua ai gazetares. — I kishin lexuar ato që shkruanin nëpër gazetat. Më dukej se dikush më thërriste: E, ç'po bën ti, partizan i vjetër? Shkurte Vata mos ishte vetëm çupë e Palit nga Dukagjini? Jo...

Rudina instinktivisht zgjati dorën, shtrëngoi Borën për supesh. Edhe Borës i iku gjaku nga fytyra. Shumë rrallë mallëngjehej Rudina, po kur dëgjonte të flitej për Shkurtën, ishte njësoj si të dëgjonte për çikën e vet, Borën.

... «Paçka se Menkulasi ynë është buzë kufirit në jugë dhe Pecaj i Palit larg në veri, — vazhdonte xha Demiri. — Unë vendosá. Do të shkoj thashë. Do të shkoj bashkë me këtë vajzën time që është moshatare e Shkurte Palit...»

Vajzat e kapanonit 4<sup>a</sup> rrëmbezin çdo fjalë. Ato ndiqnin me bisht të syrit blokun e shënimave dhe stilolapsin që shkruante aq shpejt të gazetares me aparat. Sa e çuditshme u dukej ajo grua, sidomos kur shkrepente herë pas here aparatin, sikur bënte diçka krejt të zakonshme!

Rudina hahej me mendimet e veta: Edhe ajo kish-te vendosur të vinte në hekurudhë menjëherë, sa po varrosën Shkurtën. Sapo Pali dhe Katrina Vata thanë që do niseshin për të zëvendësuar Shkurtën në heku-rudhë.

— Edhe unë, — kishte thënë ajo në kuvend — do të shkoj të zavendësoj Shkurten. Shkurta ka kenë çika jeme.

Shokëve të brigadës ku punonte Rudina u shkël-

qyen sytë nga gëzimi. Të tjerët që s'ia patën dëgjuar kurrë zérin, e vështruan me habi.

Në kullë ra heshtja. Armiqësia u bë më e thellë dhe më e fortë, po asnjeri s'guxoi ta kundërshtonte Rudinën.

— Nuk i thashë gjë njeriu në fshat se do të nisem, veç plakës sime, — vazhdonte komunisti nga Menkulasi... Po ku e mori vesh gjithë fshati? C'të shoh? Po më përcillnin një dyqind kooperativistë. Gjatë kohës që u lija lamtumirën bashkëfshatarëve të mi mendoja: Ja, tamam si në kohën e luftës.

— Po edhe ndërtimi i socializmit luftë është, apo jo? — pyeti ai gazetaren.

\* \* \*

Ato ditë në udhën e qytezës së Dushkut s'ishte e çuditshme të kalonte një ushtar.

Në agimet e ftohta të nëntorit atje zbrisnin me dhjetëra ushtarë, qindra e mijëra vizitorë, duke ecur kilometra e kilometra në këmbë.

Qyteza ngrihej rrëzë kodrinave të buta myzeqare me kapanone katrore prej pupuliti.

Vizitorët hynin në dhomën muze të Shkurtes, një dhomë e thjeshtë, ku ishin ekspozuar trikoja ngjyrë bari që vishtë ajo, librat që lexonte, shenjat e sulmueses e dhjetëra letra, dhurata, portrete bile edhe nga duart më të pasaprovara të fëmijëve të shkollave.

Vizitorët kërkonin babanë e Shkurtes.

Pal Vata, me një palë rroba doku, me një xhup bojë blu, i thatë dhe i drejtë si të gjithë malësorët, i takonte vizitorët te dera e sektorit, në dhomën muze, pranë lapidarit. Duke mposhtur dhëmbjen ai u fliste për Shkurtën e vet. Pastaj heshtte.

Ushtari e dëgjoi Palin pa i ngritur sytë. S'donte ta shqetësonte, as t'i jepte të njojur, as t'i ndërpriste fjalën.

Kishte hyrë në qytezë bashkë me një grup vizitorësh. Pasi u larguan ata, ushtari me një trastë hedhur

krahëve filloi të kërkojë numrat e kapanoneve. Ekte ngadalë, i menduar dhe me hapa të mëdhënëj. E kishte tronditur tregimi i thjeshtë i Palit që fliste mbi takimin e tij me të bijën në spital. Ushtarin e mallëngjeu qëndresa, vendosmëria dhe besimi i vajzës që ishte rritur bashkë me të dhe me motrën e tij, Borën. Dikur ata shkonin të tre në kullotë. Ai i binte fyellit, ndërsa çikat këndonin ende këngë miturake.

Këto mendonte ushtari, ndërsa ecte me hapa të mëdha nëpër oborrin e zhveshur ku loznin voleiboll një grup të rejas.

Ushtarin e shqetësonte takimi i afërt me motrën dhe me nënën.

Bora i shkruante: «asht zor me e njoftë Rudinën tonë, aq fort ka ndryshue...» Po ai prapëseprapë s'mund ta merrte me mend.

Ushtari e gjeti kapanonin 4a. Trokiti dhe hapi derën.

Në fillim iu duk më i errët e më i ulët se kapanonet e ushtrisë. Vajzat rrinin nëpër krevatet e tyre. Disa qëndisnin. Të tjerat qepnin funde e bluza prej basme. Disa lexonin gazeten ose shkruanin letra mbi valixhet e drunjta, duke kafshuar bishtin e lapsit, të menduara, si përpara një provimi.

Ushtari kërkoi mos gjente nënën ose motrën. Sigurisht ishte më lehtë të dalloje nënën, se ajo, sidomosoftë, s'mund ta kishte hequr xhubletën. Po edhe Bo-ra do të shquhej qoftë edhe në njëqind vajza, për shkak të gërs hetit të saj shumë të verdhë.

Ushtari kërkonte me sy, i mbështetur te dera e kapanonit me trastën e hedhur në sup, kur befas një vajzë e gjatë me flokë të prerë shkurt si djalë ju hodh në qafë.

— Lum motra, sa mirë e ke ba! Ke për ta gëzue Rudinën! — tha Bora duke e tërhequr vëllanë për dore në rruginën e ngushtë midis shtretërve të kapanonit 4a. Ajo ecte përpara si në shtëpinë e vet. Ai pas. U ngjitën në katin e sipërm të krevateve prej druri. U ulën buzë shtratit, të rrethuar nga cuçat e Pecajt.

— Kjo asht Katrina Vata, kjo Vitorja, kjo Mri Kola dhe kjo Sugarja, — tha Bora.

— A nuk po mujke me na njoft, Sokol Gjonda! — e shpotiti Mri Kola.

— Kenkeni rritë për çudë.

Çikat kukurisën. Pastaj ulën kokën të turpëruara.

Ushtari hapi trastën. Nxori portokaj, mandarina. Vajzat i morën duke u skuqur lehtë, e falënderuan me buzë në gaz.

Bora rrinte në gjunjë pranë vëllait. I lëmonte kop-sat e uniformës. Herë pas here fliste e ngazëllyer duke picëruar sytë.

— Ku asht Rudina? — s'iua durua Sokolit.

— Ashtë ba e madhe, — qeshi Sugarja duke thar-tuar fytyrën nga portokalli.

— Në mbledhjen e shtabit të sektorit, — u përgjegj motra.

— Nesër kena me marrë flamurin, kena me ba mbasdite vallzimi, dhe kena me pa teatër, — përsë-riti Sugarja e vogël, duke fshirë duart që i kullonin lëng.

— Ç'ka asht teatri? A ke pa ndonjiherë? — pyeti me ndrojtje Vitorja.

— Nganjiherë luejmë edhe na vetë! — tha Sokoli.

— ...!

— Këtu kanë me luejt artistë të vërtetë nga Tiranë, — ia priti Bora me zërin e saj të kumbueshëm. As ajo s'kishte parë ndonjëherë teatër, prandaj mezi e priste të nesërmen.

— Po he, na kallëzoni si ja keni çue? — pyeti ushtari.

— Bukur fort. Kena mësue do gjana që s'do muj-shim me i nxanë në Pecaj për tanë jetën, — tha Mri Kola.

— Edhe detin e kena pa. Ashtë aq i madh sa mos me ta marrë mendja, — u hodh Sugarja.

Ushtari qeshi, duke kundruar me kërshëri Suga-ren kuqalashe.

Ishte aq e imët, aq e vocërr, sa të dukej e çuditshme të fliste për detin.

Bora e përmalluar s'ia ndante sytë vëllait: «Sa kenke burrnue, Sokol vëllai, sa hije të paska rroba e ushtarit». Po ajo e ktheu kokën mënjanë, se e kuptoi që s'i kishte hije ta kundronte të vëllanë në bebe të syrit. Në fund të fundit ushtarët, as që kanë nevojë që motrat t'ju kacavaren në qafë.

Sugarja nxori bluzën, e vuri para shoqeve dhe filloj të provojë shenjat e «S»ve mbi të.

Shoqet bënë buzën në gaz. Ushtari queshte nën hundë.

— Sa bukur, sikur të ishin njikështu, — tha ajo.

Me keqardhje i largoi me një të lëvizur të gish-tit dy prej tyre.

— Vetëm këto janë të miat, — tha përsëri duke tundur kokën. Ëndrra e Sugares së vogël ishte të kthehej në Pecaj me katër «S».

— Po ti mos u mërzit, hej burrneshë. Herën tjetër kur të vijsh ke me u kthye njikështu, si ta don zemra, — ia priti Mria.

Sugarja mezi e mbajti të qeshurën. Mria kishte prerë flokët atë ditë dhe dukej si një çikë tjetër.

Ushtari ndiqte i vëmendshëm vajzat e Pecajt. Mjaftonte të dëgjoje sa lirisht flisnin, sa gjëzim buron-te në sytë e tyre që të kuptoje se edhe Pecaj i tyre i largët ishte vënë në radhët e luftës, madje ishte vënë në ballë.

Vitorja, që deri atëhere vetëm dëgjonte, filloj të tregonte:

«Ishim duke punuar me Shkurtën në trase...»

Çikat dëgjonin për të qindtën herë këtë ngjarje. I jetuan vetë të gjitha çastet e saj. Ndërsa tashti, duke ndjekur tregimin bashkë me Sokol Gjondedën, ka-përdinin lotët sikur ta dëgjonin për herë të parë.

Borën s'e zinte vendi.

«Jo. Jo. S'mundet me kenë e vërtetë, — përsëris-te ajo. — Gjithnji kam shpresë se do ta ndesh Shkur-

ten nëpër udhët e sektorit tue luejt bashkë me vajzat e tjera, tue qeshë në mbramjen e vallëzimit, tue punue me shoqet në trase».

Sokoli me çikat e kapanonit 4<sup>a</sup> zbritën në katin e poshtëm.

Kapanoni 4a ishte si të gjithë kapanonet e tjera. Po me ato krevate prej dërrasash dy katëshe, po me atë rrugicën e ngushtë, po me ato batanije ngjyrë hiri. Po ky kapanon kishte edhe diçka të veçantë. Në rrjetështin e fundit, në katin e poshtëm, në njërin ndër ato krevate të thjeshtë prej dërrasash kishte fjetur Shkurta e Pecajt. Ai krevat ishte ashtu si e pat rregulluar çika me duart e veta, para se të nisej në trase. E ashtu do të mbetej. Me një kurorë lulesh të freskëta. Me një fotografi të prerë nga një gazetë.

Sokoli mbeti një copë herë i menduar para krevatit, derisa Bora e tërroqi për dore dhe dolën në oboरrin e pjerrët, ku kishte gjallëri.

\* \* \*

— E fortë ka kenë beteja, Sokol. Edhe tash kur e kujtoj m'bulojnë djersët e ftohta, — tha Bora.

— Kur lexoja letrat që më çoje, gati-gati s'besoj-she se munde të çoje krye kundër bacës!

— Janë krejt të pa sy.

— Edhe na kena kenë fajtorë. I gjëlltitshim të tana pa u mendue ma gjatë.

— Megjithatë unë vetëm s'kisha për të fitue asnjiherë, — pëshpëriti vajza me zë të dredhur. — Po s'patën çka me i ba Shkurte Palit dhe organizatës së Rinisë.

— Dhe Rudinës?

— Po. Duhet me ditë se Rudina ka qëndrue si burrneshë.

— Nga letrat gjithë zemrim që m'conte axhë Gjoni e kuptoja luftën e nanës, — tha Sokoli.

Ecën një copë herë pa folur.

Para disa kohësh Sokol Gjondeda, as që mund ta kuptonte jetën ndryshe. Çdo gjë në kullë i dukej e natyrshme. Baba plak i tregonte ngjarje trimërie. I mësonte këngët që këndoheshin në malësi për Gjondedajt e lashtë. Baba ishte vërtet një burrë fisi. Pastaj «nanë locja», kështu quante gruan e tretë të Prengës, ishte e ashpër dhe e egër me të gjithë, vetëm më Sokolin, jo. E llastonte pa masë. Sokoli bile ishte i kënaqur që kishte dy nëna. Ai e donte edhe Rudinën e re, po sigurisht e tërhiqtë më shumë baca që i kaliste burrinë. Që kur ishte i vogël, ai i tregoi si ta mbante pushkën në sup dhe të shtinte drejt në shenjë. Preng Gjondeda donte t'ja linte trashëgim të birit famën si pushkëtarë më i zoti i krahinës. Dhe Sokoli u bë qitës i mbaruar!

Ndërsa motrat e mëdha, ishin shumë të pakuptueshme për Sokol Gjondedën. E përsë qanin aq shumë kur i martonin? Kur e pyeti bacën për këtë ai u përgjegj:

— Gratë i kanë flokët e gjatë e mend e shkurtëna.

Kështu u rrit Sokol Gjondeda në kullën e vet.

Po tashti ai i kuptonte edhe shkaqet që Preng Gjondeda kishte dy gra, edhe jetën e mjerë e pa gëzime të Rudinës. Bile ai s'guxonte ta quante Rudinën «locja eme». Edhe kjo i qe mohuar nënës. Tashti ai e ndjente veten fajtor ndaj nënës. Kjo ia ndrydhë zemrën dhe e turbullonte për takimin e afërt me të.

Bora e shkundi Sokolin për krahu.

— Ja ku po vjen Rudina!

Me fundin mbi pantallonat e aksionit dhe me një shami mbi gërshtat e verdhë, ajo shquhej që nga larg në mes të aksionisteve nga trupi i saj i gjatë dhe i drejtë.

Sokolit s'po i durohej më:

— Rudinë! — thirri.

Ajo ktheu kokën dhe mbeti një hop si e nemitur.

— Sokol Gjondeda! — klithi ajo me zë të thekshëm dhe e rroku djalin.

— Rudinë, paske veshë pantallona e po më duke si nuse e re! — tha Sokoli.

Rudina qeshi me gjithë zemër.

— He nanë loce! Kam tesh sa kohë e s'po mundem me të takue. Ç'ka ka ndodhë kështu?

Rudina u step. «Nanë loce?» Sokol Gjondeda nuk e pat thirrë kurrë kështu. Një hije si një re e zezë, që fshihet nga qielli, pastroi ballin e saj.

Sokoli e vuri re. Nëna foli:

— Ka kenë e gjatë kjo mbledhje. Kur asht puna me u dhanë flamurin brigadave duhet me kenë i drejtë. Erdhi fundi. Do kthehem!

Bora tha:

— Mue më vjen keq që po e lamë hekurudhën. Rudinën e përshkuat mornica.

Përse, vetëm Borës po i vinte keq? Po asaj?...

— Mue më pëlqijeta në hekurudhë — vazhdoi Bora. Kur isha në Pecaj as e merrsha me mend si mundet me kenë!

— Shumë gjana nuk i merrshim me mend, — tha i vëllai. — Njiherë mësuesi na pat folë, në klasë për udhën e hekurt, — foli Bora. Ne me Shkurtën shikojshim si vishej mali me borë. Më thanë të drejtën nuk muishe me besue. Në nji udhë aq të ngushtë prej hekuri do të fluturonte nji alamet makine, sa ajo që na kallxojke mësuesi në nji fotografi!

— Bota paska kenë shumë ma e madhe se sa e kena mendue na prej kullës tonë. A po jo loce? — vërejti Sokoli.

— Po bir! — u përgjegj ajo pak e mallëngjyer. A përnjimend e ke mësue aq bukur me nga makinën si shkrueje në letër?

— Qysh kur kam kenë i vogël, gjithnjë kam dash-të me u ba shofer. Po në kullë as që muishe me thanë ndonji fjälë.

— Ejani, — tha Rudina. S'due me dëgjue ma për kullën. Kam ç'ka me ju tregue!

Ata u futën në dhomën e komandantes së sektorit. Një dhomë e madhe prej dërrase, të cilën ia kishin liruar një gurëskalitësi nga bregu i ligenit të Pogradecit, sepse donin që edhe qyteza e Dushkut t'i bënte një dhuratë të bukur Pal Vatës.

Gurëskalitësi nuk kishte studjuar në asnjë shkollë arti, po gjithë jetën kishte lëmuar gurin. E lëmonte me mjeshtëri, i jepte aq gjallëri dhe jetë figurës që krijonte, sa ishte e pamundur mos ta quaje skulptor të mbaruar.

Kur hyri Rudina me fëmijët në dhomë, gurskalitësi daltonte gurin e lëmuar e të bardhë me një punë të përqëndruar e të qetë.

Përshëndeti Rudinën dhe i zgjati ushtarit dorën muskuloze.

Rudina dhe fëmijët mbetën nji copë herë duke ndjekur lëvizjet e daltës me kureshtje. Para Sokolit, ishte portreti i gurtë i shoqes së fëminisë. Atij iu kujtua kur luanin njëherë «lojën e nuses dhe të dhëndrrit!» Shkurta rrinte nën një rrobë si duvak. Ai bashkë me fëmijët e tjerë ishin krushqit. Nuses i tundeshin supat nga të qarët nën duvak. Kështu bënин gjithë vajzat e fshatit kur martoheshin. Ai shkoi dhe i ngriti rroben, se kujtoi që ajo po qante vërtet dhe pa atë fytyrë të dashur me sy të ndritur me një buzëqeshje të lehtë... ja, tamam si ky portret i bardhë, i lëmuar, i gurtë.

— Shoqja Rudinë — tha gurëskalitësi, — më thuaj të vërtetën. A i ngjan cikës së Dukagjinit?

— Po, — tha Rudina. Asht krejt si me kenë e gjallë.

Bora iu afrua me drojtje portretit. Zgjati duart drejt mermerit të bardhë. Ndjeu të rënqethura dhe pati të ftohtë, sepse mermeri ishte vetëvetiu i ftohtë.

\* \* \*

Vajzat e kapanonit 4<sup>a</sup> u pregetitën për mbrëmjen e fundit.

Hekurosën pantallonat stolisën gjokset me «S»-të, dhe u krehën para pasqyrave të vogla që ia mbanin njëra-tjetrës në rrugicën e ngushtë midis dy krevatëve.

Rudina nxori kostumin. Ndërsa vishej e shtrëngohet me rrobën e saj të zakonshme, e përshkoi një e dredhur sikur në ato rroba të ishte mbledhur gjithë akulli e trishtimi i viteve të mugëta.

Vajzat dolën para derës së kapanonit 4<sup>a</sup>. Prisnin të mbaronin shoqet. Bënte ftohtë, po të rinjtë dhe të rejat s'donin t'ja dinin. Këndonin, flisnin me zë të lartë, luanin me top ose dëgjonin spikerin që jepte nga qendra e zërit rezultatet e skuadrave fituese. Oborri i pjerrët i qytezës ishte gjithë vrull, rini, jetë të shqetësuar. Po të vije re mirë, me gëzimin përzuhej edhe një hije e lehtë trishtimi. Aksionistet, të lidhura për dore, vinin rrotull nëpër sektor grupe-grupe.

E në ç'vend tjetër veçse në këto qyteza të bardha buzë trasesë, ku njerëzit zgjoheshin më parë se dielli, do të lindnin miqësitë e singerta dhe dhimbjet e ndarjes?

Vullnetarët prisnin. Në rrugën e trasesë u duk në fillim xhipsi i shtabit të hekurudhës, pastaj vërvshan gazetarët dhe fotoreporterët me aparate. Më në fund aktorët. Ata zbritën të shkujdesur. Vullnetarët i ndiqnin lëvizjet e artistëve nga Tiranë.

Aktorët hynë të parët në skenë dhe humbën prapa perdes.

Në sallën e kulturës s'kishe nga të lëvizje. Nëpër stolat e gjatë prej dërrasash u ulën njëra pas tjetrës vajzat e kapanonit 4<sup>a</sup>. Gjithë fjalë e zhurmë, duke ngacmuar njëri-tjetrin, u ulën pranë tyre studentët e shkencave të natyrës, që punuan një javë me vajzat e kapanonit 4<sup>a</sup>. Megjithëse vajzat e Pecajt u ulën pak

si mënjanë, fotoreporterët me aparate blic i gjetën dhe filluan t'i fotografonin.

Rudina dukej e hutuar nën atë petk që i derdhej për trup. Ajo s'kishte qenë asnjëherë në jetën e saj në një sallë me kaq njerëz të ndryshëm.

— Loce, — i tha Sokoli. — C'ka ke ngri në atë petk si me kenë shatorja e njatij gurskalitësit?

Rudina mblodhi supet.

— Bukur e kishte punue, — vazhdoi ai. — Na kena me e vue në sallën e madhe të shtëpisë së kulturës, që po e ngrenë tash në Pecaj.

Bora hetonte vëllanë me habi. «Ku po don me dali, o Sokol Gjondeda!»

— Pastaj kena me shkue shpesh me Borën e kena me këcye.

Rudina tundi kokën me keqardhje e me qortim sikur deshi të thoshte: vërtet, bir?

— A nuk po më beson, Rudinë?

— Po, lum nana.

Sokoli heshti një copë herë, sikur deshi të lexonte deri në fund mendimet, shqetësimin, dyshimet e Rudinës. Ajo herë dukej e gjëzuar dhe herë mbyllej në vëtëvete! Kishte një fytyrë të pastër e të sinqertë, sa mund të lexoje si në një libër të hapur gjithë luftën dhe përpjekjet e saj.

— Edhe unë kam me ju diftue diçka, — tha ajo pas pak. — Bora edhe unë do të nisemi në një kurs të organizatës së gruas. Nuk e di përsë kanë vendos në Pecaj me na çue na!

— A përnjimend, nanë loce! — i thirri Bora duke përplasur shuplakat.

— Ngadalë, moj marroce!

— C'ka kena me mësue?

— Shumë gjana. Kena shumë nevojë me mësue, — tha Rudina.

— Mirë por, — e mori fjalën Sokoli. — Kur të

kthehemë të tre në Pecaj do të ndërtojmë një shtëpi të re, me dritare të mëdha, me dhoma të bukura plot drithë. Bota ka me na u duk shumë ma e madhe se nga frengjitet e kullës. Si thue Rudinë?

Kishte ardhë ai çast që mund të fliste hapur me të birin.

Po ajo s'foli. Si t'ja u shpjegonte fëmijëve revoltën e saj? Ajo s'do të kthehej më kurrë në atë jetën e mjerë të një robi të bindur dhe të heshtur. Edhe deri tashti s'kishte jetuar kurrë pér vete! Po ndërsa më parë mendonte vetëm pér Sokolin dhe pér Borën, sot mendonte pér dhjetëra e dhjetëra vajza e gra, që mund të kishin pasur fatin e saj! Ajo do të luftonte gjithë jetën që të mos përsëritez edhe një herë drama e jetës së saj!

— Sa bukur, nanë loce! — thirri Bora dhe kjo thirrje sikur e shkundi Rudinën nga mendimet.

— Unë do të punoj në koperativë si shofer ose si traktorist. Ç'ka të ketë ma tepër nevojë. Bashkë do të punojmë e bashkë do të gëzohemi, — tha Sokoli.

Rudina s'fliste. Po ai ia lexonte në sy mendimet që i dyndeshin. Asaj i vinte edhe mirë, edhe keq. Mos e humbi djali gjithë burrërinë? Mos filloi të bëhet një llafazan si plakat kur shkojnë në burim të mbushin ujë? Nëna s'donte që Sokol Gjondeda të bëhej i quillët e hokatar. Po nga ana tjetër ndjente një nevojë të brendshme, të dëgjonte këtë zë të dashur, të ngrohtë e miqësor. Kishte nevojë të qëmallej me fytyrën e gëzuar të të birit. Donte të merrte pjesë e tëra në ëndrrat e tij.

— Ke me mësue shkrim e këndim, se nuk asht nji punë aq e randë!

— Bir, mos më turpno. A nuk e sheh se jam thinjë krejt?

— Ti je ende e re. Në Pecaj ka me u ngrit shkolla e natës. Kena me shkue të tre. Dhe druej se po na e kalon, nanë loce.

Borës çdo gjë i dukej e bukur. Fjala e komandan-

tit të hekurudhës kur dorëzonte flamurët; duartrokitjet edhe brohoritë e pandërprera; hijet që lëviznin prapa perdes; pastaj muzika... dhe çiftet që filluan të vallëzojnë.

Bora s'do ta harrojë kurrë atë mbrëmje të jashtë-zakonshme.

— Po ti, moj pikaloshe, — e ngacmoi Sokoli të motrën. — Ç'ka je habitë ashtu?

— Kenke ba llafazan atje në ushtri, mor bir, — i tha nëna.

— Hajde këcejmë, motër.

Bora u step.

— Po nuk di Sokol, vëllai! — mërmëriti.

— E kur ke pasë me dijtë? Tash po mësojmë. Dhe ti Rudinë banu gadi, se s'je kah pshton pa këcye sonte me Sokol Gjondedën.

Nënës i mbahej fryma. Sa kishte ëndërruar që të mund të fliste një herë lirshëm me të birin.

Ajo i ndiqte fëmijët me sytë e veshur nga lotët.

Borën e shikonin gjithashtu të gjitha vajzat e kabanonit 4a. Ajo i kishte sytë larushë si të Rudinës, flokët të verdhë, trupin të hollë e të brishtë si një mësh-tekëz e re. Vallëzonte plot ngurrim me sytë në tokë, thua se tërë vëmendja e saj ishte përqëndruar te opin-gat që kishte veshur.

— Mos u tut motër, — i foli i vëllai me zë të ulët.

Bora druhej. Skuqej. Herë pas here humbiste nga sytë e nënës në mes të çifteve të tjera që vallëzonin.

Tek kërcente, dëgjonte me sy gjysmë të myllur të vëllanë që i fliste:

— Prit edhe pak. Kemi për të pasë dritë elektrike. Do të blejmë radio. Në sallën e kulturës, atje ku do të vëmë portretin prej mermeri të Shkurtes, do të kemi patjetër edhe një televizor. A e di ti Borë ç'janë televizorët?

Para perdes ishin radhitur një grup aksionistësh. Nga larg dëgjohej kënga:

«*Jo, ti nuk ke vdekur, do jetosh gjithmonë*».

Zëri i bukur gjithë ndjenjë dhe melodioz i Vaçë Zelës sundonte sallën...

Bëhej apeli. Komandantja paraqiti forcën. Tha: Mungon vetëm Shkurte Pali.

Por pas pak u dëgjua një zë:

— Këtu jam, këtu!

Në sallë filluan të lëviznin. Një aktore e veshur si aksioniste, po ngjitej në skenë. Ajo u kthye nga spektatorët. I hodhi një vështrim vullnetarëve, dhe tha:

— Unë jam Shkurte Pali. Historia ime është e thjeshtë. Ju shokë, që më dëgjoni, më njihni shumë mirë. Kam punuar këtu midis jush. Do t'ju tregoj jetën time:

Perdja lëvizi. Sipari u hap.

...Një shtëpi e vogël me një pullaz të pjerrët për t'i qëndruar dëborës së dimrit.

Një malësore e gjatë, e thyer në moshë, me një vështrim shqiponje.

Një burrë i veshur me xhup dhe me mustaqe të verdha.

Një djalë i vogël që bisedonte e bënte shaka me malësoren.

Një vajzë, e veshur me rrobat e malësores.

Bora e trondit tur nxori një zë: Ah!

Edhe Rudina po e ndiqte e përmalluar malësoren e re, që i ngjante aq shumë Shkurtës:

Borës i rrihte zemra me rrëmbim.

As dëgjonte e as shihte se ç'bëhej më tej. Ndiqte e përqëndruar lëvizjet e vajzës malësore me emrin Shkurtë Pali.

«Ja, kjo është ajo... A s'kam thanë që kam me e ndeshë një ditë në udhët e sektorit ose në sallën e kulturës? Sa më pat marrë malli!» mendonte Bora.

Aktorja Shkurte iu afrua malësores së gjatë e të fortë dhe i foli me një zë të kumbueshëm e të thekshëm:

«Nanë»

Bora u mbajt pas stolit që të mos thërriste.

Rudina dhe Sokoli shkëmbyen nga një vështrim.

Ngjyrat e fytyrës së Borës ndryshonin vazhdimishit. Një herë përflakej e ndizej si prush, papritur zverdhej menjëherë. Ndërsa duart s'i zinin vend.

Para syve të vullnetarëve kalonin ngjarje të njo-hura.

Gati-gati po përsëritez edhe një herëjeta e tyre.

Bora u ngrit në këmbë. Meqenëse i pengonte të tjerët, dikush e tërhoqi dhe e uli.

Skena e fundit.

Aktorja Shkurte e plagosur në spital.

Përsëri kumbon nga manjetofoni zëri i ngrohtë dhe i apasionuar i Vaçe Zelës:

«*Jo, ti nuk ke vdekur, do jetosh gjithmonë*»

Bora ngrihet në mënyrë të pavetëdishme dhe sulet në skenë.

Salla e ndjek e shtangun. Vetëm zemra e nënës e ndjen ç'ka ndër mend të bëjë tashti Bora. Ajo zgjat duart, e përqafon fort aktoren Shkurtë. E gjithë salla ngrihet në këmbë në heshtje të plotë. Bora pëshpërit me zë tē ulët po që e dëgjojnë tē gjithë.

— Shkurtë, motra jeme, e dija se ti s'ke dekë. Se ti, s'mundesh kurrë me dekë.

## TRYEZA E LËNDËS

	Faqe
Cila është komuniste .....	3
Tregim për ty .....	14
Qielli i kthjellët .....	26
Një njeri .....	59
Fustani najlon .....	66
Mirmëngjez! .....	83
Përbuzje .....	91
Mësuesi .....	115
Shqetësimi i një gruaje .....	120
Kapanoni 4a .....	136

50962

ALBUMI E SHIETË  
DITËVOLLA